



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT

6866/4
Nr. ___ Prot.

Tiranë, më 28.10.2025

URDHËR

Nr. 553, datë 28.10.2025

PËR

MIRATIMIN E KURRIKULËS BËRTHAMË PËR ARSIMIN FILLOR

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, të shkronjës “c” të pikës 2 të nenit 45 të ligjit nr. 69, datë 21.06.2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të shkronjës “dh” dhe “e”, të pikës 5, të kreut III, të vendimit nr. 98, datë 27.02.2019 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar” dhe të urdhrit nr. 497, datë 29.09.2025 “Për delegimin e kompetencave dhe caktimin e detyrave të zëvendësministrit të Arsimit, znj. Orjana Osmani”,


URDHËROJ:

1. Miratimin e kurrikulës bërthamë për arsimin fillor (e përditësuar), bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
 2. Kurrikula bërthamë për arsimin fillor (e përditësuar) fillon zbatimin si vijon :
 - a) Për klasën e parë në vitin shkollor 2026-2027;
 - b) Për klasën e dytë në vitin shkollor 2027-2028;
 - c) Për klasën e tretë në vitin shkollor 2028-2029;
 - d) Për klasën e katërt dhe të pestë në vitin shkollor 2029-2030.
 3. Kurrikula e mëparshme shfuqizohet sipas fillimit të zbatimit të kurrikulës bërthamë për arsimin fillor (e përditësuar) në klasat e sipërcituara.
 4. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit, Drejtorja e Përgjithshme e Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar, Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar, zyrat vendore të arsimit parauniversitar dhe institucionet arsimore parauniversitare.
- Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSMINISTRI

ORJANA OSMANI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

KURRIKULA BËRTHAMË

(E përditësuar)

Arsimi Fillor

2025



PËRMBAJTJA

1. SHKURTIME.....	2
2. HYRJE	4
3. VEÇORITË E ARSIMIT FILLOR (KLASAT I - V)	5
4. ARRITJET QË PRITEN NGA NXËNIA	6
5. KUPTIMI PËR KOMPETENCËN	8
5.1. RENDITJA E NJOHURIVE, E AFTËSIVE DHE E QËNDRIMEVE	12
5.2. LIDHJA E KOMPETENCAVE LËNDORE ME KOMPETENCAT KYÇ.....	14
6. REZULTATI I TË NXËNIT DHE ARRITJA E NXËNËSIT	18
6.1. LIDHJA E KOMPETENCËS ME REZULTATIN E TË NXËNIT DHE ARRITJEN	18
6.2. LIDHJET E DYFISHTA DHE TË TREFISHTA	20
7. MATJA E ARRITJES (ASSESSMENT) DHE VLERËSIMI (EVALUATION)	22
8. KOMPETENCAT KYÇ.....	25
8.1. KOMPETENCA E KOMUNIKIMIT NË GJUHËN AMTARE	25
8.2. KOMPETENCA E KOMUNIKIMIT NË GJUHË TË TJERA	27
8.3. KOMPETENCAT PËR MATEMATIKËN, SHKENCËN, TEKNOLOGJINË E INXHINIERINË	29
8.4. KOMPETENCA DIGJITALE	33
8.5. KOMPETENCA PERSONALE, SHOQËRORE DHE E TË NXËNIT	35
8.6. KOMPETENCA E QYTETARISË	37
8.7. KOMPETENCA E SIPËRMARRJES	39
8.8. KOMPETENCA PËR VETËDIJEN DHE SHPREHJEN KULTURORE	41
9. FUSHAT KURRIKULARE DHE LËNDËT PËRKATËSE	43
9.1. FUSHA KURRIKULARE “GJUHËT DHE KOMUNIKIMI”	44
9.2 LËNDA “GJUHË SHQIPE”	45

KURRIKULA BËRTHAMË E ARSIMIT FILLOR (E PËRDITËSUAR)

9.3. LËNDA “GJUHË ANGLEZE”	48
9.4. FUSHA KURRIKULARE “MATEMATIKË”	51
9.5. FUSHA KURRIKULARE “SHKENCAT E NATYRËS”	57
9.6. FUSHA KURRIKULARE “SHKENCAT SHOQËRORE”	62
9.6.1. LËNDA “QYTETARI”	63
9.6.2. LËNDA “HISTORI”	67
9.7. FUSHA KURRIKULARE “ARTE”	71
9.8. FUSHA KURRIKULARE “EDUKIMI FIZIK, SPORTI DHE SHËNDETI”	74
9.9. FUSHA KURRIKULARE “TEKNOLOGJI DHE TIK”	77
9.9.1. LËNDA “AFTËSIM TEKNOLOGJIK PRAKTIK”	78
9.9. 2 LËNDA “TEKNOLOGJIA E INFORMACIONIT DHE E KOMUNIKIMIT (TIK)”	81
10. METODOLOGJITË E TË MËSUARIT DHE TË NXËNIES	86
11. MATERIALE DHE BURIME MËSIMORE	89
12. TEMAT NDËRKURRIKULARE	92
13. KURRIKULA NË BAZË SHKOLLE	93
14. LËNDËT MËSIMORE QË INTEGROJNË FUSHAT KURRIKULARE	95
15. PROGRAMI LËNDOR	96
16. PLANI MËSIMOR: KOHA MËSIMORE PËR FUSHAT KURRIKULARE DHE LËNDËT	98
17. VLERËSIMI I ARRITJEVE TË NXËNËSIT	99
18. FJALORI TERMINOLOGJIK	103
REFERENCA	110

Prodhim i ASCAP, 2025

www.ascap.edu.al

Copyright ©, ASCAP

1. SHKURTIME

APU	-	Arsimi parauniversitar
AF	-	Arsimi fillor
AMU	-	Arsimi i mesëm i ulët
AML	-	Arsimi i mesëm i lartë
ASCAP	-	Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar
KBAF	-	Kurrikula bërthamë e arsimit fillor
RN	-	Rezultati i të nxënit/nxënies
SMIP	-	Sistemi i Menaxhimit të Informacionit Parauniversitar
STEM	-	Shkencë, teknologji, inxhinieri dhe matematikë
TIK	-	Teknologjia e informacionit dhe e komunikimit
VANAF	-	Vlerësimi i arritjeve të nxënësve të arsimit fillor
2D	-	Dypërmasor
3D	-	Trepërmasor

2. HYRJE

Dokumenti “Kurrikula bërthamë e arsimit fillor” (e përditësuar⁽¹⁾) - konkretizon për këtë nivel arsimor idetë e dokumentit “Korniza Kurrikulare e Arsimit Parauniversitar të Republikës së Shqipërisë”.

Në dokumentin “Kurrikula bërthamë e arsimit fillor” (në vijim, KBAF) shtjellohen:

- ❖ Veçoritë e arsimit fillor (AF) dhe pritshmëritë nga nxënia, pas përfundimit të nivelit.
- ❖ Kuptimi për kompetencën, rezultatin e të nxënit dhe arritjet e nxënësit.
- ❖ Matja e arritjes së nxënësit (*assessment*) dhe vlerësimi i saj (*evaluation*).
- ❖ Kompetencat kyç.
- ❖ Fushat kurrikulare dhe lëndët përkatëse.
- ❖ Metodologjitë e të mësuarit dhe të nxënies.
- ❖ Struktura e programit lëndor.
- ❖ Plani mësimor i arsimit fillor.
- ❖ Vlerësimi i arritjeve të nxënësve.

KBAF-ja orienton zhvillimin dhe zbatimin e dokumenteve kurrikulare, si programet lëndore dhe udhëzuesit kurrikularë, dhe u shërben:

- ❖ Hartuesve të dokumenteve kurrikulare për zbatimin e përcaktimeve dhe të kriterëve që duhen zbatuar.
- ❖ Hartuesve të testeve për të përcaktuar filozofinë e ndërtimit të testit në provime.
- ❖ Mësuesve për planifikimin / realizimin e veprimtarive në klasë dhe jashtë saj.
- ❖ Nxënësve për të ndërtuar njohuri të reja dhe kompetenca, që të përballin sfidat e jetës në shoqërinë demokratike.
- ❖ Prindërve që të njohin çka pritët të arrijnë fëmijët dhe kriteret e vlerësimit të tyre.

KBAF-ja thekson formimin e nxënësve kompetentë. Dokumenti përcakton arsimin që duhet t’u sigurohet nxënësve. Si i tillë, ai ndihmon pjesëmarrjen aktive të nxënësve në procesin mësimor në funksion të zhvillimit të mendimit kritik si bazë kryesore për ndërtimin dhe përdorimin prej tyre të njohurive të reja dhe të kompetencave.

⁽¹⁾ Nevoja për përditësimin e dokumentacionit kurrikular është argumentuar në “Korniza Kurrikulare e Arsimit Parauniversitar të Republikës së Shqipërisë – 2024”

Kurrikula e përditësuar e arsimit parauniversitar ka zëvendësuar 7 kompetencat kyçe ekzistuese me **8 kompetenca kyçe**⁽²⁾. Ndryshimi është reflektuar në KBAF dhe ritheksohet ideja sipas të cilës gjithë sa shtjellohet në AF, në kontekstin e kurrikulës që bazohet në kompetenca, t'i shërbejë nxënësit për fazat e mëtejshme të shkollimit.

3. VEÇORITË E ARSIMIT FILLOR (KLASAT I - V)

Arsimi fillor (klasat I-V) ka disa veçori të rëndësishme që ndihmojnë zhvillimin intelektual, emocional dhe social të fëmijëve. Këto veçori fokusohen në ndihmën e fëmijëve për të zhvilluar kompetenca të rëndësishme për jetën, si dhe për t'i përgatitur për nivelet më të avancuara të arsimit. Disa nga veçoritë kryesore të AF-së janë:

Metodat mësimore janë të orientuara në mësimin aktiv dhe praktik, ku fëmijët angazhohen në aktivitete krijuese dhe lojëra edukative që ndihmojnë në zhvillimin e imagjinatës dhe të aftësive të tjera konjitive. AF-ja përfshin shumë punë në grupe, ku nxënësit punojnë bashkë për të zgjidhur probleme, çka ndihmon në zhvillimin e aftësive të komunikimit dhe të bashkëpunimit.

Fëmijët mësojnë edhe rreth ndjenjave, respektit për të tjerët, dhe si të zhvillojnë aftësitë e duhura sociale për të komunikuar dhe bashkëpunuar me shokët e klasës. Arsimi fillor është një mundësi e shkëlqyer për të mësuar fëmijët për vlerat e përgjegjësisë, respektit, ndihmës ndaj të tjerëve dhe disiplinës. Shumë shkolla përfshijnë veprimtari që ndihmojnë në zhvillimin e karakterit dhe të vetëdijes sociale. Pjesë e AF-së janë veprimtaritë artistike, si piktura, muzika dhe teatri, që nxisin fëmijët të shprehin idetë dhe ndjenjat e tyre në mënyra krijuese dhe origjinale.

Shkollat fillore krijojnë mjedise mësimi që respektojnë dhe përfshijnë dallimet e fëmijëve, si ato kulturore, sociale dhe të aftësive mësimore, duke përdorur metoda të përshtatura për çdo nxënës. Me avancimin e teknologjisë, nxënësit fillojnë të njohin dhe të përdorin mjete digjitale për mësim, duke përfshirë përdorimin e kompjuterëve dhe të pajisjeve të tjera elektronike për të ndihmuar mësimin dhe kërkimin e informacionit.

⁽²⁾ *Key competences for lifelong learning*

<https://op.europa.eu/en/publication-detail/-/publication/297a33c8-a1f3-11e9-9d01-01aa75ed71a1/language-en>

KBAF është e përqendruar në zhvillimin e kompetencave të nxënësve, duke i ndihmuar ata të aftësohen të mendojnë në mënyrë kritike, të zgjidhin probleme dhe të bashkëveprojnë me efektivitet. Këto veçori janë të rëndësishme për të siguruar një mësim të ekuilibruar dhe të plotë, që nxit zhvillimin e gjithanshëm të fëmijëve në vitet e AF-së.

4. ARRITJET QË PRITEN NGA NXËNIA

Me qasjet e duhura arsimore, me mbështetjen e mësuesve dhe të prindërve dhe me mjedisin mësimor që nxit zhvillimin e njohurive, aftësive e qëndrimeve:

NXËNËSI, PASI PËRFUNDON KLASËN III:

- dëshiron të mësojë, pëlqen mësimin, mund të mësojë vetëm dhe me të tjerët;
- respekton familjen, klasën dhe shkollën e tij; është i sjellshëm, mban premtimet; nuk ofendon apo ngacmon askënd; dëgjon dhe respekton bashkëmoshatarët;
- mund të ndajë kohën midis studimit, argëtimit, detyrave të shtëpisë dhe pushimit;
- njeh kombësinë e tij dhe e respekton atë;
- respekton vendlindjen dhe atdheun, njeh simbolet kombëtare dhe i respekton ata;
- mund të mendojë kur përballet me detyrën dhe kupton veprimet që kryen;
- mund të përgatitë një plan të thjeshtë dhe ta ndjekë atë;
- mund të gjejë dhe të kuptojë informacionin që përmban një tekst (përfshirë të dhënat, termat, personazhet, veprimtaritë, kohën dhe vendin) dhe ta prezantojë;
- llogarit, përdor mjete të përshtatshme dhe njësi matëse, kur zgjidh detyra të përshtatshme për moshën;
- kupton dhe mbron natyrën; mund të vëzhgojë me qëllim, të vërejë dhe të përshkruajë dallimet e ngjashmëritë;
- mund të krahasojë objekte dhe dukuri, të grupojë në bazë të karakteristikave dhe të lexojë një tabelë, diagram ose hartë;
- përdor programet kompjuterike më të thjeshta dhe pajisjet teknike ose teknologjike që përdoren në shtëpi dhe/ose në shkollë;
- vëren dhe vlerëson të bukurën dhe krijimtarinë; kënaqet me aftësitë krijuese;
- kujdeset për pamjen, shëndetin dhe përpiqet të jetë i shëndetshëm;
- shmang situata të rrezikshme dhe thërret për ndihmë në një situatë të rrezikshme, fillon të mësojë të lundrojë në mënyrë të sigurt në internet;
- di me kë të kontaktojë, kur ndesh probleme, dhe kërkon ndihmë kur ka nevojë.

NXËNËSI, PASI PËRFUNDON KLASËN V:

- vlerëson marrëdhëniet njerëzore, kupton rolin si anëtar i familjes dhe i grupeve të ndryshme; i përmbahet fjalës së dhënë, besohet dhe përgjigjet për veprimet që kryen;
- është në gjendje të përmbushë detyrat mësimore (me ndihmën e mësuesit dhe të prindit), mund të përdorë teknika të nxënies së përshtatshme për moshën (përfshirë teknikat e punës me shokun dhe në grup);
- vlerëson kombësinë dhe kulturën e tij dhe kulturat e tjera, trajton njerëzit pa paragjykitje, njeh dallimet të njerëzve dhe kupton nevojën e kompromiseve;
- di të planifikojë dhe të vlerësojë veprimtaritë e tij, të zgjedhë dhe të zbatojë çka duhet për të arritur rezultatin, pranon gabimin dhe korrigjon sjelljet e gabuara;
- di të shprehë, të arsyetojë dhe të mbrojë mendimin e tij;
- mund të dëgjojë dhe të lexojë tekste të përshtatshme për moshën, krijon tekste me gojë/shkrim të sakta gjuhësisht, të përshtatshme për moshën dhe të lidhura me situatën e komunikimit, si dhe të kuptojë atë për të cilën flet dikush;
- përdor të paktën një gjuhë të huaj në situata të komunikimit që kërkojnë shkëmbim të thjeshtë informacioni për tema të njohura të jetës së përditshme;
- ka zhvilluar aftësi llogaritëse dhe matëse, di të justifikojë plotësimin e detyrave në fusha të ndryshme të jetës me ndihmën e udhëzimeve që i jepen;
- vlerëson mënyrën e jetesës, di të bëjë pyetje me natyrë shkencore dhe të marrë informacione përkatëse, di të sillet dhe interesohet për natyrën dhe studimin e saj;
- përdor për komunikim internetin dhe kryen punë të thjeshta me kompjuter;
- mund të gjejë përgjigje për pyetjet, të marrë informacionin e nevojshëm nga burime të ndryshme, ta interpretojë, ta përdorë dhe ta transmetojë atë;
- dallon faktin nga opinioni;
- ndihet qytetar i vendit të tij dhe zbaton normat e jetës së përbashkët;
- vlerëson krijimin artistik dhe mund të shprehet, duke përdorur mjete artistike;
- vlerëson mënyrën e shëndetshme të jetesës dhe veprimtaritë sportive;
- njeh faktorët që dëmtojnë shëndetin dhe shmang rreziqet e substancave të varësisë;
- identifikon informacionin e besueshëm, shmang përmbajtjet e papërshtatshme dhe mbron privatësinë e tij online.
- komunikon në mënyrë të përshtatshme në mjedise virtuale, duke respektuar të tjerët dhe duke përdorur një gjuhë të përshtatshme.

5. KUPTIMI PËR KOMPETENCËN

Kuptimi i kompetencës në arsimin bashkëkohor tejkalon zotërimin e **njohurive** dhe përfshin **aftësitë** për t'i përdorur këto njohuri në situata mësimore dhe/ose jetësore. Në kontekstin arsimor, **kompetenca kuptohet si kapacitet/zotësi vetjake që kombinon njohuri, aftësi dhe qëndrime dhe i mundëson personit të trajtojë dhe të zgjidhë saktë situatat jetësore.**

Përkufizimi thekson natyrën komplekse, kontekstuale dhe dinamike të kompetencës, duke përfshirë jo vetëm zotërimin e njohurive, të aftësive dhe të qëndrimeve që evoluojnë vazhdimisht, por edhe zbatimin e tyre në kontekste reale. Gjithashtu, përkufizimi thekson idenë se kompetencat janë attribute që nxënësi i ndërton dhe i përsos vetë gjatë procesit mësimor dhe në veprimtaritë jetësore. Si të tilla, kompetencat ndërtohen dhe përdoren nga nxënësit për t'iu përgjigjur situatave arsimore ose jetësore. Njëherazi, përkufizimi përputhet me teoritë arsimore bashkëkohore që i shohin kompetencat si tërësi kapacitetesh të ndërlidhura dhe të rëndësishme.

Shembulli i një kompetence kyç është **komunikimi në gjuhën amtare**. Komunikimi përfshin **aftësinë** për të shprehur idetë (**njohuritë**) qartë, me shkrim dhe me gojë. P.sh., një nxënës 11-vjeçar mund ta shprehë në mënyrë efektive përvojën e tij në një ese ose gjatë një prezantimi para shokëve të klasës. Ky lloj komunikimi i suksesshëm zhvillon besimin për të ndërvepruar me të tjerët (**qëndrimi**).

Lidhja midis njohurive, aftësive dhe qëndrimeve është thelbësore në AF, pasi ndikon zhvillimin e plotë të nxënësve.

Njohuritë përbëhen nga informacioni, konceptet dhe faktet që nxënësit mësojnë përmes edukimit. Ato formojnë bazën për të kuptuar lëndë dhe tema të ndryshme.

Shembull: *Ciklet jetësore të kafshëve.*

Aftësitë janë kapacitete që mundësojnë zbatimin e saktë të njohurisë në situata mësimore dhe/ose të botës reale. Ato zhvillohen përmes ushtrimit, praktikës dhe përvojës. Aftësitë në KBAF kuptohen si “**mjete**” që lejojnë të përdoret ajo që nxënësi njih, për t'i bërë gjërat. Ato kombinojnë **njohurinë** (atë që nxënësi di) me **proceset** (si ta përdorë njohurinë) për të arritur një qëllim (**arritja**).

Shembull: *Përdorimi i fakteve të mbledhjes për të llogaritur kostot e disa artikujve.*

Qëndrimet, si mentaliteti ose prirjet, ndikojnë mënyrën se si nxënësit i qasen mësimi dhe ndërveprojnë me të tjerët. Ato materializohen varësisht vlerave, besimeve dhe ndjenjave që ka përjetuar apo ka mishëruar nxënësi.

Shembull: *Të jesh kureshtar dhe të këmbëngulësh kur përballesh me probleme sfiduese.*

Lidhja dhe integrimi

Njohuria si themel për aftësitë: Fillimisht, nxënësit ndërtojnë koncepte dhe njohin fakte (njohuria). Ky proces themelor u mundëson atyre të zhvillojnë aftësitë përkatëse. P.sh., njohja e fakteve të shumëzimit është thelbësore, përpara se një nxënës të mund t'i zbatojë ato nëpërmjet aftësive për të zgjidhur probleme.

Aftësia si zbatim i njohurive: Aftësitë shprehen përmes ndërtimit dhe përdorimit të njohurive. Duke praktikuar dhe duke zbatuar atë që njohin, nxënësit rritin aftësitë e tyre. Në kontekstin e lëndës së matematikës, përdorimi i fakteve të tabelës së shumëzimit për zgjidhjen e problemeve, demonstroi zbatimin praktik të njohurive.

Qëndrime që nxisin zbatimin e njohurive dhe aftësive: Qëndrimet ndikojnë në mënyrën se si përfshihen nxënësit dhe si zbatojnë njohuritë dhe aftësitë e tyre. Një qëndrim pozitiv ndaj të nxënit mund t'i motivojë nxënësit të praktikojnë aftësitë e tyre me më shumë zell dhe të kapërcejnë pengesat. P.sh., një nxënës që beson se mund të përmirësojë aftësitë e tij matematikore përmes përpjekjeve dhe praktikës, arrin rezultate më të mira.

Në përmbledhje, lidhja ndërmjet përbërësve është reciprokisht përforcuese. *Njohuritë* ofrojnë bazën për zhvillimin e aftësive, *aftësitë* mundësojnë zbatimin praktik të njohurive dhe *qëndrimet* ndikojnë mënyrën se si nxënësit përfshihen me të dyja. Ky integrim siguron që nxënësit jo vetëm të kuptojnë konceptet, por edhe t'i zbatojnë ata dhe t'i qasen të nxënit me një mentalitet pozitiv. Në kurrikulën tonë, kompetencat shërbejnë si bazë për përzgjedhjen e përmbajtjeve mësimore dhe për vlerësimin e rezultatit të nxënies së nxënësve.

Llojet e kompetencave

Çdo kompetencë integron dhe aktivizon njohuri, aftësi dhe qëndrime të caktuara (**përbërës** këta të kompetencave kyç ose specifike). Nxënësit do të ndërtojnë dhe do të zbatojnë dy lloje kompetencash:

KURRIKULA BËRTHAMË E ARSIMIT FILLOR (E PËRDITËSUAR)

- **Kompetenca kyç (ndërdisciplinore):** Kapaciteti i nxënësit që përfshin njohuri thelbësore, aftësi të nevojshme dhe qëndrime të caktuara, të nevojshme në mësim dhe në jetë. Këto kompetenca ndërtohen dhe zhvillohen nga nxënësi duke trajtuar situatat dhe sfidat që ofrohen nga lëndë të ndryshme dhe kanë karakter ndërdisciplinor.
- **Kompetenca specifike:** Kapaciteti i nxënësit që integron një grup të veçantë njohurish, aftësish dhe qëndrimesh të cilat pritet që nxënësi t'i zhvillojë dhe t'i zbatojë, fillimisht brenda një fushe ose lënde të caktuar (p.sh., shkrimi në gjuhën amtare, përdorimi i procedurave shkencore etj.).

Ndërtimi dhe zbatimi i kompetencave: Në programet lëndore do të përshkruhen përbërësit e çdo kompetence kyç dhe specifike që do të ndërtohen dhe do të zbatohen nga nxënësit gjatë trajtimit dhe zgjidhjes së situatave, në mësim ose jashtë tij. P.sh., kur nxënësi ndërton dhe përsos aftësitë për të analizuar, për të sintetizuar dhe për të krahasuar në kontekstin e një kompetence, ato janë investim për kompetencat e tjera.

Roli i mësuesit: Kompetencat nuk u mësohen nxënësve nga mësuesi, por ndërtohen dhe demonstrohen nga nxënësit, të udhëhequr nga mësuesi.

Kuptimi dhe roli i kompetencës në kurrikul burojnë nga teoritë arsimore bashkëkohore që i shohin kompetencat të rëndësishme për arsimimin e nxënësve.

ILUSTRIM 1: Përbërësit që integron nxënësi për ndërtimin e konceptit “Numrit 1”

Njohuri	Aftësi	Qëndrime
<i>Nxënësi ndihmohet të trajtojë situata që të ndërtojë njohuri për:</i> ▪ numrin 1 si tregues i sasisë së grupeve; ▪ paraqitjen me simbolin (“1”) ose me fjalën (“një”); ▪ paraqitjen në kontekste të ndryshme (p.sh.: një mollë, një orë) etj.	<i>Nxënësi ndihmohet të trajtojë situata që të shkathtësohet:</i> • të numërojë objekte dhe të kuptojë se “një” i përgjigjet një gjëje të vetme; • të përputhë numrin 1 me një grup që ka një gjë; • ta shkruajë numrin 1 dhe ta njohë kur e sheh të shkruar.	<i>Nxënësi ndihmohet të trajtojë situata që të zhvillojë:</i> - kuriozitetin dhe interesin për numrat dhe numërimin; - besimin që fitohet nëpërmjet praktikës së përsëritjes dhe përforcimit pozitiv.

ILUSTRIM 2: Qasje që ndihmon nxënësit të integrojnë përbërësit e kompetencës

Fillimi i mësimi – Nxitja e kureshtjes dhe përgatitja për njohurinë e re

Qëllimi: Të nxiten nxënësit të shfaqin kureshtjen për të mësuar rreth numrit 1 dhe të fillojnë të identifikojnë një lidhje të përbashkët të grupeve me nga një element.

Veprimtaria: Fillojeni me një bisedë të shkurtër, me pyetje të thjeshta për t'i bërë nxënësit të mendojnë rreth objekteve me nga një element, si p.sh., thoni “një mollë” ose “një libër” dhe nxitini nxënësit të thonë objekte të ngjashme.

Shqyrtimi praktik: Fillon ndërtimi i konceptit “numri 1”

Qëllimi: Nxënësit ndihmohen të ndërtojnë *konceptin e numrit “një”*, duke krijuar bazën për paraqitjen e *simbolit 1* dhe të fjalës “një.”

Veprimtaria: Organizoni veprimtari ku nxënësit të grupojnë objekte reale (p.sh., lapsa, libra) në grupe me nga një element. Jepuni objekte dhe kërkojuni t'i organizojnë në grupe të vogla me nga një objekt për grup.

Reflektimi: Më pas, drejtojuni nxënësve pyetje që i ndihmojnë të analizojnë grupet dhe të kuptojnë të përbashkëtën, duke theksuar se *secili grup ka vetëm një element*.

Prezantojmë simbolin “1” dhe fjalën “një” – Ndërtimi i aftësive të reja

Qëllimi: Nxënësit fillojnë të identifikojnë dhe të përdorin simbolin dhe fjalën për të prezantuar konceptin e numrit “1” në kontekste të ndryshme.

Veprimtaria: Pas diskutimit për grupet me nga një element, paraqitni simbolin “1” dhe fjalën “një”. Shpjegoni që çdo grup me një element përfaqësohet nga ky simbol dhe nga kjo fjalë. Shkruajini ata në tabelë dhe praktikojeni me nxënësit, duke i nxitur të thonë dhe të shkruajnë simbolin dhe fjalën për objekte të ndryshme (p.sh., 1 mollë, një vizore).

Zhvillimi i aftësive për krahasim dhe përgjithësim

Qëllimi: Nxënësit aftësohen të veçojnë dhe të përgjithësojnë karakteristikat e përbashkëta të grupeve, duke ndërtuar aftësitë për analizë dhe sintetizim.

Veprimtaria: Paraqitni situata problemore ku nxënësit të krahasojnë grupe të ndryshme *me nga një element* dhe të veçojnë karakteristikat e përbashkëta. Për shembull, jepuni nxënësve grupe me një mollë, një vizore dhe një laps dhe kërkojuni të krahasojnë këto grupe duke analizuar ngjashmëritë e tyre në aspektin e numrit.

Reflektimi: Pyesni “Çfarë kanë të përbashkët këto grupe?” dhe ndihmojini nxënësit të përgjithësojnë që numri është gjithmonë “1”, pavarësisht formës apo ngjyrës së objektit.

Zgjidhje e situatave problemore dhe nxitja e këmbënguljes

Qëllimi: Përmes ushtrimeve, nxënësit ndërtojnë besimin për të zgjidhur probleme, duke përforcuar njohurinë për numrin 1 dhe duke kultivuar këmbënguljen.

Veprimtaria: Paraqitni situata të thjeshta ku nxënësit të përdorin konceptin e numrit 1 për të zgjidhur probleme. P.sh., mund t'i pyesni: “Nëse kam një mollë dhe e vendos atë në një grup, sa objekte ka në grup?”

Mbyllja dhe reflektimi

Qëllimi: Kjo mbyllje i ndihmon nxënësit të reflektojnë mbi mësimin dhe të përforcojnë qëndrimet pozitive si kureshtja dhe këmbëngulja.

Veprimtaria: Përfundoni orën duke diskutuar për konceptin që kanë mësuar dhe për rëndësinë e tij. Nxitni nxënësit të ndajnë mes tyre atë që kanë kuptuar për numrin 1 dhe përvoja që u ka pëlqyer gjatë orës.

Reflektimi: Kjo mbyllje i ndihmon nxënësit të reflektojnë mbi mësimin dhe të përforcojnë qëndrimet pozitive si kureshtja dhe këmbëngulja.

Rasti ilustron idenë se si mësuesi mund t'i ndihmojë nxënësit të **ndërtojnë njohuri** të reja, **të praktikojnë aftësi** dhe **të kultivojnë qëndrime** përmes veprimeve në situata mësimore të strukturuar.

5.1. RENDITJA E NJOHURIVE, E AFTËSIVE DHE E QËNDRIMEVE

Në procesin e ndërtimit të kompetencave nga nxënësit pranohet kjo renditje:


Njohuria – Është themeli për çdo kompetencë. Ajo përfshin koncepte, ide, fakte dhe teori etj., që formojnë bazën e të mësuarit. Nxënësit kanë nevojë për njohuri, që të kuptojnë se çfarë po bëjnë dhe pse vlen ajo që po bëjnë.

Aftësia – Pasi të kenë ndërtuar njohuritë e nevojshme, nxënësit mund të zhvillojnë aftësitë. Këto janë kapacitete vetjake që sigurojnë zbatimin praktik të njohurive.

Qëndrimi – Jetësohet varësisht vlerave, besimeve dhe ndjenjave që ka përjetuar apo ka mishëruar nxënësi. Një qëndrim pozitiv ndihmon nxënësit të integrojnë më thellë njohuritë e aftësitë dhe t'i përdorin në mënyrë më efektive, në kontekste të ndryshme.

Në praktikë, është e zakonshme që përbërësit të ndërtohen/të përdoren njëkohësisht. Për shembull, shpesh, mësuesit komentojnë që në fillim të orës qëndrime pozitive ndaj mësimin për të krijuar një atmosferë mbështetëse, edhe kur përqendrohen te zhvillimi i njohurive dhe aftësive.

ILUSTRIM 3: Struktura e procesit që e ndihmon nxënësin të komunikojë në gjuhën amtare



⁽³⁾Informacioni i plotë për "përbërësit" e kompetencave kyç dhe specifike gjendet në seksionet në vijim.

Struktura e mësipërme tregon linjën se si mund të ndihmohen nxënësit të komunikojnë saktë në gjuhën amtare. Ajo përmban elementet kryesore që janë në funksion të këtij qëllimi dhe lidh në mënyrë logjike rezultatet e të nxënit, përbërësit e kompetencave specifike dhe veprimtaritë mësimore. Elementet që e bëjnë strukturën koherente dhe të saktë, janë:

Lidhja e rezultateve të nxënies me kompetencën – Rezultatet e nxënies janë përshkruar qartë dhe janë orientuar nga kompetenca e komunikimit në gjuhën amtare, duke u përqendruar në përbërësit e kësaj kompetence.

Përbërësit e kompetencave specifike – Struktura përfshin ndërtimin e njohurive, të aftësive dhe të qëndrimeve si përbërës të kompetencave të cilët korrespondojnë drejtpërdrejt me situatat gjuhësore që trajton nxënësi. Kjo përputhet me parimin që kompetencat ndërtohen nga nxënësi përmes zhvillimit të situatave gjuhësore.

Fokusi te nxënësi dhe mësuesi – Roli i mësuesit është i qartë: ai orienton nxënësit të arrijnë RN, duke ofruar situata gjuhësore. Struktura lejon që nxënësit të jenë aktivë në proces, duke trajtuar situata që zhvillojnë aftësitë e dëgjimit, të folurit, të lexuarit dhe të shkruarit.

5.2. LIDHJA E KOMPETENCAVE LËNDORE ME KOMPETENCAT KYÇ

Ndërlidhja mes kompetencave (specifike dhe kyç) është proces i rëndësishëm për të siguruar që nxënësit të zhvillojnë një gamë të gjerë njohurish dhe aftësish.

Shembull 1: Ndotja e ujit është një problem jetik. Ajo mund të shërbejë si pikënisje për një projekt mësimor. Nxënësit kërkojnë informacione, analizojnë të dhënat, propozojnë zgjidhje dhe komunikojnë rezultatet e tyre, duke lidhur kompetencat **specifike** të shkencave të natyrës ((hulumtimi dhe zgjidhja e problemeve) dhe fuqizojnë kompetencat **kyç** (komunikimi dhe aftësitë për të mësuar gjatë gjithë jetës).

Shembull 2: Puna në projekte bashkëpunuese me ndihmën e mjeteve digjitale u mundëson nxënësve të kërkojnë informacione, të krijojnë përmbajtje dhe të komunikojnë me të tjerët. Përmes këtij procesi, ata zhvillojnë **kompetenca specifike** të TIK-ut (krijimi dhe menaxhimi i përmbajtjeve digjitale) dhe **kompetenca kyç**, si përdorimi i teknologjisë dhe ndërveprimi në mjediset digjitale.

ILUSTRIM 4. Përbërësit e kompetencave gjuhësore dhe digjitale ndikojnë njëri-tjetrin

Njohuri	Aftësi	Qëndrime
❖ Kuptimi i sistemeve: Të dyja kompetencat kërkojnë që nxënësi të njohë dhe të kuptojë sistemet. E para kërkon që nxënësi të njohë dhe të përdorë gramatikën, fjalorin dhe sintaksën, ndërsa e dyta kërkon njohjen dhe kuptimin e sistemeve operative, të programeve dhe të mjeteve digjitale. ❖ Kodimi dhe sintaksa: Për të ndërtuar kompetencën digjitale, nxënësi duhet ndihmuar të njohë gjuhët e kodimit që kanë rregulla sintaksore të ngjashme me ato të gjuhëve natyrore. Kuptimi i rregullave nga nxënësit është thelbësor për programimin kompjuterik dhe komunikimin efektiv gjuhësor. ❖ Konteksti kulturor: Qoftë kompetenca gjuhësore, ashtu dhe ajo digjitale, kërkojnë që nxënësi të njohë kontekstet kulturore. E para përfshin kuptimin e nuancave kulturore në komunikim, ndërsa e dyta ndërtohet prej tij kur kupton se si faktorët kulturorë mund të ndikojnë në ndërveprimet dhe përmbajtjet digjitale.	❖ Komunikimi: Të dyja kompetencat kërkojnë që nxënësi të zhvillojë aftësi komunikimi. Kompetenca gjuhësore zhvillon komunikimin verbal dhe me shkrim, ndërsa kompetenca digjitale zhvillon komunikimin përmes platformave të ndryshme, si: <i>e-mail</i>-i, mediat sociale, mjetet e bashkëpunimit në internet etj. ❖ Zgjidhja e problemeve: Të dyja kompetencat, që të zhvillohen nga nxënësi, kërkojnë që ai të ndihmohet të zgjidhë probleme. Kompetenca gjuhësore kërkon interpretimin dhe zgjidhjen e sfidave gjuhësore, si p.sh., gjetjen e fjalëve të duhura për të shprehur idetë. Kompetenca digjitale kërkon zgjidhjen nga nxënësi të problemeve teknike, përdorimin e procedurave digjitale të punës dhe teknologjitë e reja. ❖ Të menduarit kritik: Të dyja kompetencat, që të ndërtohen nga nxënësi, kërkojnë që ai të aftësohet të mendojë. Kompetenca gjuhësore kërkon që nxënësi të ndihmohet të analizojë, të vlerësojë, të gjykojë dhe të argumentojë për të nxjerrë përfundime nga tekstet. Kompetenca digjitale përfshin vlerësimin kritik të përmbajtjes digjitale, analizën dhe vendimet bazuar në të dhëna. ❖ Krijimi: Të dyja kompetencat ndërtohen, kur nxënësi krijon. Kompetenca gjuhësore kërkon përdorimin krijues të gjuhës për të shprehur ide, emocione dhe histori. Kompetenca digjitale e aftëson nxënësin nëpërmjet përdorimit krijues prej tij të mjeteve digjitale, krijimit të përmbajtjeve multimediale dhe risive në zgjidhjet digjitale.	❖ Kurioziteti: Të dyja kompetencat kërkojnë që nxënësi të ndihmohet të zhvillojë kureshtjen. Kompetenca gjuhësore e zhvillon kur nxënësit i ofrohen situata që nxitin kuriozitetin rreth gjuhëve, kulturave dhe stileve të ndryshme të komunikimit. Kompetenca digjitale zhvillon kuriozitetin për teknologjitë, tendencat dhe zgjidhjet novatore digjitale. ❖ Përshtatja: Të dyja kompetencat kërkojnë që nxënësi t'i përshtatë arritjet. Nxënësi përshtat gjuhën sipas audiencave të ndryshme që dëgjojnë ose lexojnë. Me kompetencën digjitale, ai bën përshtatje të softuerëve të rinj, platformave dhe mjediseve digjitale sipas konteksteve dhe nevojave. ❖ Respektimi i etikës: Të dyja kompetencat përfitojnë nga respekti i etikës prej nxënësit. Kompetencën gjuhësore nxënësi e ndërton dhe e zhvillon duke respektuar konsideratat etike në komunikim, si respektimi i privatësisë dhe shmangia e plagjiaturës. Kompetenca digjitale përsoset, kur nxënësi respekton etikën duke ruajtur privatësinë e të dhënave dhe sigurinë kibernetike. ❖ Këmbëngulja: Të dyja kompetencat zhvillohen, nëse nxënësi ndihmohet dhe shpërblehet kur këmbëngul. Mësimi i gjuhës dhe zhvillimi i aftësive digjitale përfshijnë sfida dhe pengesa që kërkojnë nga nxënësi të këmbëngulë për të përsëritur veprime apo sjellje të ndryshme.

Njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet e përbërësve të kompetencave ndërtohen dhe ndërveprojnë reciprokisht në kontekste të ndryshme mësimore. Ky ndërveprim ndihmon nxënësin të komunikojë, të zgjidhë probleme, të krijojë dhe të ndërgjegjësohet për botën gjithnjë e më shumë të ndërlidhur dhe të drejtuar nga teknologjia digjitale.

ILUSTRIMI 5: Lidhja e përbërësve të kompetencave me proceset mendore dhe me shtjellimin metodik

LËNDA : Dituri natyre, klasa e 5-të

TEMA: Ciklet jetësore të insekteve dhe të amfibëve

Për të realizuar një mësim efikas dhe të strukturuar, fillimisht duhen identifikuar:

- a) njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet** që duhet të ndërtojë nxënësi,
- b) proceset mendore** që ai duhet të aktivizojë.

1. Përbërësit e kompetencave

- **Njohuria:** Nxënësi mëson për fazat e ndryshme të ciklit jetësor të insekteve (vezë, larvë, pupë, i rritur) dhe të amfibëve (vezë, larvë/pupë, i rritur).
- **Aftësia:** Nxënësi identifikon dhe përshkruan fazat e ciklit jetësor të insekteve dhe të amfibëve dhe krahason ndryshimet midis tyre.
- **Qëndrimi:** Nxënësi zhvillon qëndrim vlerësues ndaj natyrës dhe cikleve të jetës së organizmave.

2. Proceset mendore të nxënësit

- **Analiza:** Nxënësi analizon (zbërthen) fazat e ndryshme të ciklit jetësor dhe identifikon karakteristikat kryesore të secilës fazë.
- **Krahasimi:** Nxënësi krahason ciklin jetësor të insekteve me ciklin e amfibëve dhe aftësohet të vërë re ndryshimet dhe ngjashmëritë.
- **Abstragon:** Nxënësi aftësohet të veçojë rëndësinë e cikleve jetësore për ekosistemet dhe biodiversitetin.

3. Shtjellimi metodik

Hyrja:

- **Aktiviteti fillestar:** Mësuesi prezanton temën dhe shpjegon rëndësinë e njohjes së cikleve jetësore të organizmave për të kuptuar më mirë natyrën dhe biodiversitetin.

KURRIKULA BËRTHAMË E ARSIMIT FILLOR (E PËRDITËSUAR)

- **Qëllimi i mësimit:** Mësuesi shpjegon qëllimin dhe çfarë pritet nga nxënësit (p.sh., identifikimi dhe përshkrimi i fazave të ciklit jetësor të insekteve dhe të amfibëve).

Pjesa kryesore:

- **Prezantimi i materialeve:** Mësuesi prezanton materialet pamore (p.sh., postera, video, diagrame) që tregojnë ciklet jetësore të insekteve dhe të amfibëve.
- **Diskutimi Fillestar:** Nxënësit ndajnë njohuritë e tyre paraprake për insektet dhe amfibët dhe për ciklet e tyre jetësore.

Udhëzime për analizën: Mësuesi udhëzon nxënësit të analizojnë fazat e ciklit jetësor duke përdorur pyetje, si:

- ❖ Cilat janë fazat kryesore të ciklit jetësor të një insekti?
- ❖ Cilat janë fazat kryesore të ciklit jetësor të një amfibi?
- ❖ Çfarë ndryshimesh / ngjashmëri ka mes ciklit të insekteve dhe atij të amfibëve?

Aktiviteti i krahasimit: Nxënësit punojnë në grupe për të krahasuar ciklin jetësor të insekteve me atë të amfibëve, duke përdorur një tabelë krahasimi.

Fazat e ciklit jetësor	Insektet (p.sh., flutura)	Amfibët (p.sh., bretkosa)
Vezë	Veza	Veza
Larvë	Larva	Pupa (larvë me bisht)
Pupë	Pupa	---
I rritur	Flutura	Bretkosa

Mbyllja:

Prezantimi dhe diskutimi: Grupet prezantojnë rezultatet e krahasimit të tyre dhe diskutojnë për gjetjet. Nxënësit diskutojnë mbi rëndësinë e fazave të ndryshme për mbijetesën dhe zhvillimin e organizmave.

Reflektimi: Nxënësit shkruajnë një reflektim të shkurtër mbi atë që kanë mësuar nga ciklet jetësore të insekteve dhe të amfibëve dhe si mund t'i përdorin këto njohuri për të mbrojtur mjedisin.

4. Përmbledhja

Në këtë shembull, proceset mendore të analizës, të krahasimit dhe të vlerësimit janë lidhur ngushtë me njohuritë për fazat e ciklit jetësor, aftësinë për të identifikuar dhe

krahasuar fazat dhe qëndrimin respektues ndaj natyrës. Shtjellimi metodik mbështet këto procese dhe ndihmon nxënësit të ndërtojnë dhe të zbatojnë kompetencat e tyre në studimin e cikleve jetësore të organizmave.

6. REZULTATI I TË NXËNIT DHE ARRITJA E NXËNËSIT

Rezultati i të nxënit (në vijim, RN) është një deklaratë që përshkruan atë që një nxënës pritet të dijë, të kuptojë dhe të jetë në gjendje të bëjë, pas një periudhe të caktuar mësimore. RN-të përshkruajnë njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet që nxënësit duhet të fitojnë dhe të demonstrojnë.

Në thelb, RN-të ofrojnë udhërrëfyesin për mësuesin, duke siguruar që procesi i të nxënit të lëvizë drejt rezultatit të nxënies specifike të dëshiruar. Duke njohur RN-të, mësuesit mund të planifikojnë mësimet, në mënyrë që nxënësit të përqendrohen në zhvillimin e njohurive, të aftësive dhe të qëndrimeve specifike. Me RN-të që mund të maten, mësuesit mund të vlerësojnë në mënyrë objektive dhe të drejtë përparimin dhe arritjet e nxënësve.

Arritjet e nxënësit njësohen me performancën reale të nxënësit dhe tregojnë nivelin e zotërimit të njohurive, të aftësive dhe të qëndrimeve të fituara prej tij. Ato materializohen në produkte konkrete dhe artefaktet që nxënësi prodhon gjatë procesit mësimor dhe/ose jashtë tij. Arritjet pasqyrojnë **nivelin e përmbushjes së RN-ve** nëpërmjet produkteve të realizuara nga nxënësi, si: dokumente të shkruara, projekte, vepra krijuese dhe rezultate të testimeve etj. Arritjet shërbejnë për të dokumentuar suksesin e nxënësit dhe për të treguar se si i ka zbatuar njohuritë, aftësitë e ndërtuara dhe qëndrimet e mishëruara.

RN-të orientojnë ndërtimin e kompetencave. Arritjet pasqyrojnë nivelin e zotërimit të tyre. Duke lidhur RN-të me arritjet, kuptohet rruga për ndërtimin dhe demonstrimin e kompetencave nga nxënësit.

6.1. LIDHJA E KOMPETENCËS ME REZULTATIN E TË NXËNIT DHE ARRITJEN

Kompetenca

Përkufizimi: Kapaciteti që kombinon njohuri, aftësi dhe qëndrime, të cilët nxënësi i ndërton dhe i zbaton për të përballuar situata të ndryshme. Kompetencat **nuk mund të perceptohen drejtpërdrejt** nga personat e tjerë.

Përbërësit: Njohuri, aftësi dhe qëndrime.

Roli: Ndhmon nxënësit të zbatojnë njohuritë dhe aftësitë në situata reale.

Rezultati i të nxënit

Përkufizimi: RN është një deklaratë që përshkruan qartë atë që pritët të dijë, të kuptojë ose të jetë në gjendje të bëjë nxënësi pas përfundimit të një mësimi specifik ose veprimtarie edukative. **RN-të janë të perceptueshme dhe të matshme.**

Përbërësit: Objektiva të mësimi që duhet të arrijë nxënësi.

Roli: Udhërrëfyes për të mësuarit dhe vlerësimin e përparimit të nxënësit.

Arritja e nxënësit

Përkufizimi: Arritja e nxënësit shpreh nivelin e performancës që nxënësi arrin në një fushë të caktuar të studimit. Ajo tregon se sa mirë (në çfarë niveli) i ka zotëruar nxënësi njohuritë dhe aftësitë e kërkuara.

Përbërësit: Artefaktet dhe produktet e siguruar nga nxënësi.

Roli: Ndhmon në dokumentimin dhe demonstrimin e suksesit të nxënësit.

Përmbledhje

- ❖ **Kompetencat** demonstrojnë kapacitetet e nxënësit për të ndërtuar dhe zbatuar njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet në situata jetësore. Ato ndihmojnë nxënësit të zbatojnë në praktikë atë që kanë mësuar.
- ❖ **Rezultati i të nxënit** është deklarata që përshkruan objektivat specifike për mësuesin dhe nxënësit. RN-të ofrojnë udhërrëfyes për mësimin dhe për vlerësimin e përparimit të nxënësit.
- ❖ **Arritja** shpreh nivelin e performancës së nxënësit në një fushë të caktuar dhe materializohet në forma konkrete, si: projekte, vepra krijuese dhe rezultate të testeve. Arritjet demonstrojnë suksesin e nxënësit dhe nivelin e përmbushjes së RN-ve.

Rëndësia e lidhjeve

Përfshirja e këtij seksioni në dokumentin “Kurrikula bërthamë e arsimit fillor” do të ndihmojë në qartësimin e kërkesave të mësimi dhe të nxënit, duke siguruar që hartuesit e programeve, specialistët dhe mësuesit të kenë një udhërrëfyes të qartë dhe të strukturuar për të mbështetur përparimin dhe suksesin e nxënësve.

6.2. LIDHJET E DYFISHTA DHE TË TREFISHTA

Kompetenca dhe rezultati i të nxënit

- Kompetencat integrojnë aftësi, njohuri dhe qëndrime që nxënësi i ndërton gjatë procesit mësimor dhe jashtë tij.
- RN-të përcaktojnë gjithë sa nxënësi duhet të arrijë dhe i mundësojnë mësuesit të ndihmojë nxënësit të zhvillojnë kompetencat.

Kompetenca dhe arritja e nxënësit

- Kompetencat kombinon njohuri, aftësi dhe qëndrime të cilat nxënësi i ndërton dhe i zbaton për të përballuar situata të ndryshme.
- Arritjet e nxënësit dëshmojnë se sa mirë janë zhvilluar dhe zbatuar kompetencat. Për të vlerësuar arritjet e nxënësit, mësuesit matin dhe vlerësojnë produktet e të nxënit që tregojnë nivelin e zotërimit të kompetencave nga ana e nxënësit.

Rezultati i të nxënit dhe arritja e nxënësit

- **Rezultatet e të nxënit** janë objektivat specifike që nxënësi pritët të arrijë pas një periudhe mësimore. Ato përcaktojnë çfarë duhet të njohë, të kuptojë dhe të bëjë ai në fund të një teme, një kapitulli ose një programi mësimor.
- **Arritjet e nxënësve** tregojnë në çfarë mase i ka jetësuar rezultatet e të nxënit nxënësi. Ato lejojnë të matet dhe vlerësohet niveli i demonstrimit të njohurive, aftësive dhe qëndrimeve nga nxënësi.

Lidhja midis kompetencave, RN-ve dhe arritjeve

- Kompetencat e zotëruara përfaqësojnë nivelin më të lartë të nxënies dhe integrojnë njohuri, aftësi specifike dhe qëndrime të caktuara.
- Rezultatet e të nxënit janë “gurët ndërtues” të kompetencës, sepse përcaktojnë pikat e referimit që duhet të arrihen për ta përvetësuar atë.
- Arritjet e nxënësve tregojnë në çfarë mase nxënësit po u japin formë këtyre “gurëve” dhe po përparojnë drejt zhvillimit të kompetencave të dëshiruara.

Qartësimi i këtyre lidhjeve ndihmon mësuesit dhe hartuesit e programeve të kuptojnë më mirë lidhjet ndërmjet kompetencave, rezultateve të nxënies dhe arritjeve të nxënësve. Kjo do të sigurojë që procesi mësimor të jetë i strukturuar dhe i orientuar drejt zhvillimit të plotë të kompetencave nga nxënësit.

6.3. ARRITJET E NXËNËSIT SI TREGUES I INTEGRIMIT TË PËRBËRËSVE

Arritja e një kompetence nga nxënësi është proces gradual. Përbërësit që ajo integron, ndërveprojnë dhe plotësojnë njëri-tjetrin me kalimin e kohës. Edhe pse fillojmë të shohim shenja të zotërimit nga nxënësi të një kompetence pas një ose disa temave mësimore, është e rëndësishme të kuptojmë se zhvillimi i plotë i saj kërkon kohë dhe praktikë të vazhdueshme. Ashtu si bima kërkon kohë për t'u rritur dhe për t'u forcuar, edhe kompetencat kanë nevojë për një mjedis të mirë që të lulëzojnë.

Proces i ndërlidhjes së njohurive, aftësive dhe qëndrimeve është çelësi për të siguruar që nxënësit të zbatojnë atë çka kanë mësuar në situata të ndryshme të jetës së përditshme. Arritjet e nxënësit nuk janë të izoluara, por tregojnë se si elementet e veçanta (njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet) punojnë së bashku për të zhvilluar kompetenca që zbatohen kudo, duke siguruar një bazë solide për mësimin dhe nxënien cilësore.

Zhvillimi i kompetencave nga nxënësit është qëllimi kyç i arsimit të sotëm. Duke kuptuar se si njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet ndërveprojnë dhe ndikojnë njëra-tjetrën, mësuesit mund të krijojnë mjedise mësimi që nxisin nxënësit të bëhen mendimtarë kritikë, zgjidhës efektivë të problemeve dhe komunikues të shkëlqyer.

Përmes vlerësimit të vazhdueshëm dhe të shumanshëm të arritjeve të nxënësve, mësuesit mund të monitorojnë progresin e tyre dhe të investohen që të gjithë ata të kenë mundësi të realizojnë potencialin e tyre të plotë.

Në këtë kontekst, integrimi i përbërësve të kompetencave mund të vlerësohet përmes:

- **Performimit të nxënësit në detyra komplekse** – detyra që kërkojnë zbatimin praktik nga nxënësi të njohurive, aftësive dhe të qëndrimeve të fituara prej tij.
- **Zgjidhjes së problemeve reale** – nxënësi demonstroi aftësinë për të analizuar dhe për të zgjidhur sfida nga jeta e përditshme.
- **Komunikimit efektiv** – përdorimi i gjuhës dhe i mjeteve tradicionale ose digjitale për të shprehur ide, për të ndarë njohuri dhe për të bashkëpunuar me të tjerët.
- **Aftësisë për të reflektuar dhe përmirësuar arritjet** – nxënësi është në gjendje të vlerësojë punën e tij dhe të ndërmarrë hapa për përmirësim të mëtejshëm.

7. MATJA E ARRITJES (ASSESSMENT) DHE VLERËSIMI (EVALUATION)⁽⁴⁾

Matja (Assessment): Kuptohet si procesi i mbledhjes së të dhënave / provave përmes metodave të ndryshme për njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet e fituara nga nxënësit. Qëllimi është të informohet mësuesi për vendime mbi përparimin dhe arritjet e nxënësit.

Vlerësimi (Evaluation): Kuptohet si procesi që realizohet pas mbledhjes së të dhënave përmes matjes dhe i lejon mësuesit t'i interpretojë të dhënat **për gjykuar mbi arritjet**.

Tabela e niveleve të arritjes

NIVELI	PËRSHKRIMI I ARRITJES SË NXËNËSIT
Niveli 5	- <i>Demonstrim shumë i mirë:</i> Mendon në mënyrë kritike dhe zgjidh probleme me krijimtari dhe i pavarur.
Niveli 4	- <i>Demonstrim i mirë:</i> Siguron arritje të qëndrueshme nëpërmjet zbatimit të koncepteve dhe ideve që ka ndërtuar.
Niveli 3	- <i>Demonstrim i kënaqshëm:</i> Ka nevojë për ndihmë që t'i zbatojë saktë njohuritë dhe aftësitë e kërkuara.
Niveli 2	- <i>Demonstrim i mjaftueshëm:</i> I duhet mbështetja për të zbatuar njohuritë dhe aftësitë e duhura.
Niveli 1	- <i>Demonstrim i pamjaftueshëm:</i> Kërkohet ndërhyrje intensive për përmirësimin e arritjeve.

ILUSTRIM 6: VLERËSIMI I ARRITJES SË NXËNËSIT

TEMA: Riformulimi i një teksti letrar përmes shtjellimit të një përralle.

Objektivi: Të vlerësohen aftësitë e nxënësve për të kuptuar tekstin letrar, për të identifikuar elementet kryesore të tij dhe për t'i riformuluar ata me një gjuhë të thjeshtë dhe të përshtatshme për moshat e tyre.

Materialet:

Një përrallë klasike (p.sh., “Katër muzikantët”)

Fletë pune me udhëzime të qarta dhe me hapësira për shkrim

⁽⁴⁾ Në AF, nxënësit ndihmohen nga mësuesit dhe prindërit të njohin dhe të demonstrojnë çka përcaktojnë RN-të e shtjelluara në programet lëndore. Ato konsiderohen “inpute” për kompetencat kyç dhe ato specifike në rrugëtimin arsimor të nxënësve. **Nivelet e demonstrimit të kompetencave nga nxënësit do të vlerësohen në përfundimin e arsimit të mesëm të ulët (AMU).**

Udhëzimet:

Mësuesi lexon me zë të lartë përrallën, duke sqaruar fjalët e panjohura dhe nxit diskutime rreth ngjarjeve dhe personazheve.

Identifikimi i elementeve kryesore:

Nxënësit, në grupe të vogla, diskutojnë dhe shkruajnë në fletën e punës:

- Cilat janë personazhet kryesore?
- Çfarë ndodh në fillim të përrallës?
- Cili është konflikti kryesor?
- Si zgjidhet konflikti?
- Cili është mësimi që nxjerrim nga kjo përrallë?

Riformulimi i përrallës:

Çdo grup do të zgjedhë një personazh dhe do të riformulojë përrallën nga perspektiva e atij personazhi. Ata duhet:

- Të përdorin një gjuhë të thjeshtë dhe të qartë, të përshtatshme për një fëmijë 10-vjeçar.
- Të shtojnë detaje të reja për ta bërë historinë më interesante.
- Të ndryshojnë fundin e përrallës, nëse dëshirojnë.

Prezantimi:

Çdo grup do të prezantojë versionin e tij të përrallës për klasën.

Vlerësimi:

Kriteret e vlerësimit të arritjeve të nxënësve:

- *Përdorimi i një fjalori të pasur dhe të përshtatshëm për moshën.*
- *Organizimi i ideve në mënyrë logjike.*
- *Përdorimi i një zëri tërheqës dhe interesant në prezantim.*
- *Përdorimi i mjeteve pamore për të ilustruar historinë (nëse është e mundur).*

Bazuar në tabelën e niveleve, po paraqesim shembuj të vlerësimeve:

Nxënësi A: Nivel 5 - Demonstrim “Shumë i mirë”

Nxënësi A ka krijuar një version krejtësisht origjinal të përrallës, duke ruajtur elementet kryesore të historisë, por duke i dhënë një kthesë unike dhe të papritur. Përdorimi i

gjuhës është i pasur dhe krijues, duke ngjallur një atmosferë magjike dhe interesante. Prezantimi ishte i shkëlqyer, me përdorim plot efekt të mjeteve pamore dhe me një zë bindës. Nxënësi ka demonstruar kuptim të thellë të temës dhe aftësi për të menduar në mënyrë kritike dhe krijuese.

Nxënësi B: Nivel 4 – Demonstrim “I mirë”

Nxënësi B ka riformuluar përrallën duke ruajtur qartë elementet kryesore të historisë dhe duke shtuar disa detaje krijuese që e bëjnë atë më tërheqëse. Gjuha e përdorur është e përshtatshme për moshën, e pasur dhe e qartë, me disa gabime të vogla që nuk pengojnë kuptueshmërinë. Organizimi i ideve është logjik, megjithëse mund të përmirësohet më tej në strukturën e tekstit. Prezantimi ishte i mirë, duke përdorur një zë të këndshëm dhe tërheqës, por përdorimi i mjeteve pamore ishte i kufizuar ose mungonte. Nxënësi ka treguar kuptim të mirë të temës dhe aftësi solide për të menduar në mënyrë krijuese dhe për të përcjellë mesazhin kryesor të përrallës.

Nxënësi C: Nivel 3 - Demonstrim “I kënaqshëm”

Nxënësi C ka riformuluar përrallën në mënyrë të mirë, duke ruajtur elementet kryesore të historisë. Gjuha e përdorur është e thjeshtë dhe e qartë, por ka disa vështirësi në organizimin e ideve në mënyrë logjike. Prezantimi ishte i mirë, por mund të ishte më i strukturuar. Nxënësi ka treguar kuptim të mirë të tekstit, por ka nevojë për më shumë praktikë në zhvillimin e aftësive të shkrimit.

Nxënësi D: Nivel 2 - Demonstrim “I mjaftueshëm”

Nxënësi D ka vështirësi në riformulimin e përrallës, duke u mbështetur shumë në versionin origjinal. Gjuha e përdorur është e thjeshtë dhe ka disa gabime gramatikore. Prezantimi ishte i shkurtër dhe pak i hollësishëm. Nxënësi ka nevojë për më shumë mbështetje për të kuptuar më mirë strukturën e një përralle dhe për të zhvilluar aftësitë e shkrimit.

Nxënësi E: Nivel 1 - Demonstrim “I pamjaftueshëm”

Nxënësi E ka vështirësi në kuptimin e detyrës dhe të punojë në grup. Riformulimi i përrallës ishte shumë i shkurtër dhe nuk përmbante hollësi të mjaftueshme. Gjuha e përdorur është e thjeshtë dhe ka shumë gabime gramatikore. Prezantimi ishte i shkurtër dhe i paorganizuar. Nxënësi ka nevojë për ndihmë të konsiderueshme për të përmirësuar të gjitha aspektet e kësaj detyre.

Pasqyrimi në regjistrin e shkollës

Pas demonstrimit nga secili nxënës, mësuesi vlerëson arritjen e cila, sipas rastit, shënohet në regjistrin elektronik. Në regjistër, mësuesi - me kodet që përdoren për nxënësit e klasave I dhe III, ose notat për nxënësit e klasat IV dhe V - tregon nëse nxënësi demonstroi kënaqshëm, është në proces përvetësimi apo nuk ka arritur ta demonstrojë RN-në në nivelin e dëshiruar.

8. KOMPETENCAT KYÇ

Për plotësimin e qëllimeve të përcaktuara në ligj dhe të shtjelluara në Kornizën Kurrikulare të Arsimit Parauniversitar të Republikës së Shqipërisë, kurrikula e AF-së krijon kushte dhe mundësi që nxënësit të ndërtojnë dhe të zbatojnë hap pas hapi përbërësit e 8 kompetencave kyç:

1. Kompetenca e komunikimit në gjuhën amtare.
2. Kompetenca e komunikimit në gjuhë të ndryshme.
3. Kompetenca matematike dhe kompetenca në shkencë, teknologji dhe inxhinieri.
4. Kompetenca digjitale.
5. Kompetenca personale, shoqërore dhe e të mësuarit për të nxënë.
6. Kompetenca e qytetarisë.
7. Kompetenca e sipërmarrjes.
8. Kompetenca e vetëdijes dhe e shprehjes kulturore.

8.1. Kompetenca e komunikimit në gjuhën amtare

Kjo kompetencë kuptohet si kapaciteti i nxënësit për të aktivizuar njohuri, aftësi dhe qëndrime që i ndërton në shkollë ose jashtë saj, për të identifikuar, kuptuar, shprehur, krijuar dhe interpretuar koncepte, ndjenja, fakte, opinione me gojë dhe/ose me shkrim, me materiale pamore, tinguj/audio dhe digjitale në disiplina dhe kontekste të ndryshme. Kompetenca aktivizon aftësitë për të komunikuar dhe për t'u lidhur me të tjerët në mënyrë të përshtatshme dhe krijuese.

Përvetësimi i gjuhës amtare, interpretimi dhe përdorimi i informacionit të shtypur ose virtual përbëjnë bazën për nxënien dhe formimin e mëtejshëm gjuhësor të nxënësit. Në varësi të kontekstit, kompetenca mund të zhvillohet në gjuhën amtare, në gjuhën e

shkollimit dhe/ose në gjuhën zyrtare. Mësimi duhet të jetë veçanërisht i strukturuar dhe i qartë. Kjo ka të bëjë me ndërtimin e kuptimit të gjuhës amtare, por duhet pasur parasysh edhe përshkallëzimi i rezultatit të nxënies.

Fëmijët që ndjekin AF-në janë të ndryshëm nga njëri-tjetri. Ata rriten dhe mësojnë në kontekste të ndryshme familjare dhe shkollore që ndikojnë fuqishëm të nxënies e gjuhës dhe ritmin e tij. Prandaj organizohen përsëritje të vazhdueshme të zbatimit të njohurive, aftësive dhe qëndrimeve të ndërtuara si dhe diferencohet të nxënies sipas rastit.

Është e rëndësishme, gjithashtu, të mbahen parasysh nevojat e veçanta arsimore të nxënësve të caktuar (nxënës të sapoardhur që nuk shqiptojnë saktë tinguj të caktuar, nxënës me aftësi të kufizuara, ata që kanë vështirësi në lexim, shkrim, drejtshqiptim etj.) që kërkojnë rregullime të përshtatshme pedagogjike.

RN-të në përfundimin e arsimit fillor

NIVELI 5 <i>“Demonstrim shumë i mirë i rezultatit të nxënies”</i> <i>Pa kërkuar përpikëri absolute në zotërimin e formave të komunikimit, presim që:</i>	
<i>Nxënësi, pasi përfundon klasën III:</i> ▪ lexon me zë një tekst, deri në 400-500 fjalë, me një temë që i përshtatet moshës; ▪ shkruan një tekst rreth 100-150 fjalë për një temë të caktuar; ▪ paraqet të paktën një mendim për një temë gjatë diskutimit në grup prej 3-5 minutash; ▪ shpreh mesazhin e një teksti të thjeshtë të lexuar, përmes njëres prej formave shprehëse, si: të folurit, shkrimit, vizatimit, dramatizimit, luajtjes me role, këngës apo vallëzimit; ▪ identifikon personazhet e një tregimi, drame, filmi, kënge apo loje që është e përshtatshme për moshën dhe performon me moshatarët rolin e njërit prej personazheve; ▪ shpreh me forma të ndryshme mjedisin natyror dhe të krijuar nga njeriu, me të cilin rrethohet, apo ndonjë ngjarje shoqërore dhe e prezanton atë para të tjerëve; ▪ shpreh, për rreth 5 minuta, përpara të tjerëve	<i>Nxënësi, pasi përfundon klasën V:</i> ▪ lexon saktë me zë një tekst të palexuar më parë; ▪ shkruan një tekst deri 150-250 fjalë e më shumë, për një temë të caktuar; ▪ dëgjon prezantimin e tjetrit dhe diskuton, duke ndërhyrë të paktën dy herë me pyetje, komente apo sqarime për temën e dhënë; ▪ shpreh emocionet që ka përjetuar gjatë shikimit të një filmi, dokumentari, leximit të një libri, interpretimi muzikor, ekspozite, recitimi apo dramatizimi me të folur, me shkrim, me vizatim, me mimikë, me lëvizje etj.; ▪ merr pjesë në një shfaqje artistike; ▪ identifikon personazhet kryesore të një tregimi, drame, filmi, kënge apo ndonjë ngjarjeje nga jeta, bën dallimin e tyre duke bërë një listë me vetitë që i pëlqejnë dhe që nuk i pëlqejnë tek ata, diskuton rreth tyre, performon rolin e njërit prej personazheve në bashkëveprim me moshatarë;

KURRIKULA BËRTHAMË E ARSIMIT FILLOR (E PËRDITËSUAR)

përjetimet që e kanë shoqëruar gjatë shikimit të një filmi, drame ose dokumentari, dëgjimit të një tregimi, shikimit apo një vallëzimi, dëgjimit apo të një kënge, melodie, në njërën nga format shprehëse.	prezanton një temë të caktuar para të tjerëve, në kohëzgjatje deri në 10-15 minuta, duke përdorur TIK-un, u përgjigjet pyetjeve të bëra nga të tjerët, pyet gjatë dhe pas prezantimit, për të vazhduar me kërkimin e të dhënave të tjera.
---	---

Përbërësit e kompetencës që duhen ndërtuar dhe zbatuar nga nxënësit

Njohuri	Aftësi	Qëndrime
<i>Nxënësi ndihmohet të trajtojë situata që të ndërtojë njohuri për:</i> - shkrimin dhe fjalorin; - shenjat e pikësimit; - rregullat e drejtshkrimit; - lloje të ndryshme fjalish; - kategoritë gramatikore kryesore të emrit, foljes, mbiemrit, përemrit; - lidhëzat dhe parafjalët; - sinonimet, antonimet, homonimet, fjalët e urta dhe shprehjet frazeologjike etj.	<i>Nxënësi ndihmohet të trajtojë situata që e aftësojnë:</i> - të lexojë dhe të kuptojë saktë tekste dhe përmbajtje; - të shkruajë qartë dhe saktë; - të përdorë gramatikën dhe drejtshkrimin; - të komunikojë qartë me gojë; - të përdorë fjalor të pasur dhe të përshtatshëm; - të dëgjojë me vëmendje dhe të kuptojë informacionin e dhënë nga të tjerët; - të paraqesë informacionin qartë dhe të strukturuar; - të flasë me siguri dhe qetësi para një auditori; - të bashkëpunojë dhe të ndërveprojë saktë me të tjerët; - të shfaqë empati dhe respekt gjatë komunikimit.	<i>Nxënësi ndihmohet të trajtojë situata që të zhvillojë:</i> - vëmendjen kur dëgjon, flet, lexon dhe shkruan; - prirjen për dialog konstruktiv; - bashkëveprimin me të tjerët; - ndikimin e gjuhës tek të tjerët; - përdorimin e gjuhës në mënyrën e duhur dhe shoqërisht të përgjegjshme; - leximin për kënaqësi dhe informacion.

8.2. Kompetenca e komunikimit në gjuhë të tjera

Kuptohet si kapaciteti/zotësia e nxënësit për të aktivizuar njohuri, aftësi e qëndrime që i ndërton në shkollë ose jashtë saj, për të përdorur gjuhë të ndryshme për komunikimin në mënyrë të përshtatshme. Përmes saj, nxënësi kupton, shpreh dhe interpreton konceptet, mendimet, ndjenjat, faktet, opinionet me gojë dhe me shkrim (dëgjon, flet, lexon dhe shkruan) në kontekste shoqërore dhe kulturore, sipas kërkesave ose nevojave të dikujt. Sipas rastit, ajo përfshin dhe zhvillimin e kompetencës së gjuhës amtare.

RN-të në përfundimin e arsimit fillor

NIVELI 5 “Demonstrim shumë i mirë i rezultatit të nxënies” <i>Pa kërkuar përpikëri absolute në zotërimin e formave të komunikimit, presim që:</i>	
Nxënësi, pasi përfundon klasën III: • kupton fjalë dhe fjali të shkurtra që lidhen me jetën e përditshme (nëse ato shqiptohen ngadalë dhe qartë); • përdor fjalë dhe shprehje që lidhen me të dhëna personale, situata/veprime konkrete; • shqipton saktë një numër fjalësh/shprehjesh të përdorura në jetën e përditshme; • kupton dhe zbaton udhëzime, përsëritje të përsëritura dhe të përdorura në klasë dhe jashtë saj; • kopjon fjalë dhe shprehje të shkurtra, të njohura paraprakisht; • mund të bëjë pyetjet bazë/të japë përgjigje të thjeshta rreth detajeve personale, objekteve dhe veprimeve kryesore që kryhen gjatë ditës; • shkruan një urim të shkurtër, shpreh një dëshirë, ose shkruan fjali të thjeshta për tema të njohura.	Nxënësi, pasi përfundon klasën V: • kupton dhe përdor fjalë dhe shprehje të përditshme, të zakonshme; • shqipton saktë fjalët dhe shprehjet që janë pjesë e fjalorit dhe përdorimit të përditshëm; • shprehet me fjali të thjeshta për veten, duke dhënë detaje të shkurtra; • shpreh me gojë dhe me shkrim fjali të thjeshta që i dëgjon në gjuhë të huaj nga mjetet auditive, audio-vizuale, apo nga mësuesi dhe pastaj i përkthen në gjuhën amtare; • kupton çfarë dëgjon nëse folësi flet ngadalë dhe i shpreh fjalët qartë; • përdor shprehje dhe fjali të thjeshta në situata të njohura; • bën pyetje të thjeshta dhe u përgjigjet pyetjeve të tilla; • realizon dialogë të shkurtër për veten, familjen, shkollën.

Përbërësit kryesorë të kompetencës që duhen ndërtuar dhe zbatuar nga nxënësit

Njohuri	Aftësi	Qëndrime
<i>Nxënësi ndihmohet të trajtojë situata që të ndërtojë njohuri për:</i> ▪ fjalë dhe shprehje të jetës së përditshme; ▪ çështje kryesore të një pjese të shkurtër; ▪ dialogë dhe mesazhe të thjeshta; ▪ fjali të thjeshta; ▪ një histori të shkurtër dhe të thjeshtë etj.	<i>Nxënësi ndihmohet të trajtojë situata që e aftësojnë:</i> • të dëgjojë gjuhën e folur në biseda, këngë dhe tregime; • të flasë në lojë me role, në biseda dhe prezantime; • të lexojë libra me figura, tregime të shkurtra dhe tekste të thjeshta; • të shkruajë letra, ditarë dhe ese të thjeshta; • të zgjerojë fjalorin me fjalë të reja, për të përforcuar	<i>Nxënësi ndihmohet të trajtojë situata që të zhvillojë:</i> - vlerësimin për larminë kulturore, interesin dhe kureshtjen për gjuhët e tjera; - respektin për gjuhën e çdo personi, përfshirë atë të pakicave kombëtare; - respektin për gjuhën zyrtare të një vendi si kuadër i përbashkët për të ndërvepruar.

	mësimin e fjalorit. të praktikojë dhe të prezantojë në veprimtari për të siguruar përparim të qëndrueshëm.	
--	---	--

8.3. Kompetencat për matematikën, shkencën, teknologjinë e inxhinierinë

a) Kompetenca për matematikën kuptohet si kapaciteti i nxënësit për të aktivizuar njohuri, aftësi dhe qëndrime që ndërton në shkollë ose jashtë saj, për të formuar dhe për të përdorur mendimin matematik në zgjidhjen e problemeve në situata të përditshme. Ndërtimi dhe aktivizimi i saj e lejon nxënësin të demonstrojë njohuritë për numërimin dhe njehsimin, duke theksuar procesin, veprimtarinë dhe vullnetin për të përdorur mendimin matematik (logjik, sasi dhe hapësinor) në mënyra të ndryshme, si dhe prezantimet simbolike përkatëse (formula, modele, konstruksione, grafikë dhe tabela).

Kompetenca i mundëson nxënësit të përvetësojë gjuhën matematike me të cilën:

- kupton sistemet numerike,
- llogarit dhe mat madhësitë,
- përdor simbole që “përkthejnë” vëzhgimin dhe hulumtimin e objekteve/dukurive reale.

RN-të në përfundimin e arsimit fillor

NIVELI 5 <i>“Demonstrim shumë i mirë i rezultatit të nxënies”</i> <i>Pa kërkuar përpikëri absolute në zotërimin përbërësve të kompetencës, presim që:</i>	
<i>Nxënësi, pasi përfundon klasën III:</i> - identifikon kërkesat e problemeve të thjeshta; - përdor fjalor fillestar të matematikës për t’u shprehur, kur trajton situata matematike; - përdor mjete dhe metoda gjatë matjeve të objekteve në klasë dhe në jetën e përditshme;	<i>Nxënësi, pasi përfundon klasën V:</i> - lexon, kupton dhe shpjegon tekstin matematik të përshtatshëm për moshën; - përcjell informacionin matematik me terma, shënime, simbole dhe kode përkatëse; - arsyeton në mënyrë induktive, kur trajton situata të thjeshta; - di se njohuritë dhe aftësitë matematike mund të përdoren në jetën e përditshme; - analizon të dhënat që rezultojnë nga vëzhgimet ose gjenden në një problemë dhe përdor strategji

KURRIKULA BËRTHAMË E ARSIMIT FILLOR (E PËRDITËSUAR)

• bën vrojtime dhe hetime që e ndihmojnë të kuptojë njohuri dhe të zhvillojë aftësitë matematike; • demonstroi konceptin e numërimit të figurave, vizatimeve dhe objekteve; • shpreh me mjete konkrete koncepte të thjeshta matematike; • lidh njohuritë matematike me situata të thjeshta nga jeta e përditshme; • përdor mjete të thjeshta për llogaritje dhe matje.	për të arritur një rezultat apo për të gjetur zgjidhje që më pas mund të shpjegohet, të verifikohet, të interpretohet; • formulon probleme të thjeshta që mund të zgjidhen; • vlerëson rëndësinë e matematikës; • di se detyrat mund të kenë zgjidhje të ndryshme; • përdor mjete të TIK-ut gjatë nxënies së matematikës.
--	---

Përbërësit e kompetencës që duhen ndërtuar dhe zbatuar nga nxënësit

Njohuri	Aftësi	Qëndrime
<i>Nxënësi ndihmohet të trajtojë situata që të ndërtojë njohuri për:</i> ▪ konceptet matematike; ▪ veprimet matematike; ▪ argumentimet me shkrim dhe me gojë bazuar në ilustrime dhe mjete konkrete; ▪ ngjashmëritë, ndryshimet, rregullsitë dhe marrëdhëniet sasiore ndërmjet dukurive; ▪ situatat problemore që lidhen me mjedisin rrethues; ▪ situatat matematike që paraqiten në mënyra të ndryshme; ▪ zgjidhjen e problemave matematike; ▪ teknologjitë që lehtësojnë zbatimet e matematikës.	<i>Nxënësi ndihmohet të trajtojë situata që e aftësojnë:</i> • të konceptojë, të gjykojë dhe të arsyetojë në mënyrë logjike, i vëmendshëm ndaj hollësive; • të identifikojë marrëdhëniet midis ideve; • të vlerësojë argumentet dhe të nxjerrë përfundime; • të zbërthejë informacionin në përbërës më të vegjël; • të nxjerrë përfundime bazuar në të dhënat; • të komunikojë idetë, argumentet dhe gjetjet; • të vizualizojë forma, dimensione dhe marrëdhënie sasiore dhe hapësimore. • të mësojë nëpërmjet lojërave.	<i>Nxënësi ndihmohet të trajtojë situata që të zhvillojë:</i> - kuriozitetin dhe mendjen e hapur për numrat dhe figurat; - vlerësimin për veten dhe për kritikën konstruktive në situata të thjeshta matematike; - pavarësinë në mendime dhe veprime; - besimin në përdorimin e teknologjisë digjitale për veprimet me numra; - vullnetin në arritjen e rezultateve; - respektin për përpjekjet vetjake dhe ato të grupit; - respektin për të vërtetën; - vullnetin për të kërkuar arsytet dhe për të vërtetuar vlerën e tyre.

b) Kompetenca për shkencën i referohet kapacitetit/zotësisë së nxënësit për të aktivizuar dhe për të përdorur tërësinë e njohurive, aftësive, qëndrimeve dhe metodologjinë që i

ndërton në shkollë ose jashtë saj, me të cilën shpjegohet bota natyrore, në mënyrë që të identifikohen pyetje dhe të nxirren përfundime të bazuara në prova.

c) Kompetencat në teknologji dhe inxhinieri janë kapacitete/zotësi me të cilat nxënësi zbaton njohuri dhe metodologji në përgjigje të dëshirave ose të nevojave njerëzore. Nëpërmjet këtyre kompetencave, ai kupton ndryshimet e shkaktuara nga veprimtaria njerëzore dhe përgjegjësinë e tij si qytetar.

Nxëniet e shkencës dhe e teknologjisë që në moshë të re është thelbësore për përgatitjen e nxënësve për jetën si qytetarë në një botë ku shkenca dhe teknologjia zënë vendin mbizotërues. Nxëniet në AF shërben për të ndihmuar nxënësit të ndërtojnë gradualisht njohuri, aftësi dhe qëndrime që kërkojnë kohë për t'u përvetësuar.

Nxëniet e shkencës dhe e teknologjisë në AF ofron mundësi që, në kontekste konkrete, nxënësi të ndërtojë dhe të përdorë koncepte shkencore dhe matematike. Fusha ofron një kornizë të përshtatshme për përvetësimin e elementeve fillestare të kulturës digjitale, thelbësore në shoqërinë e sotme dhe që përsosen gjatë rrugëtimit të mëtejshëm arsimor të nxënësit. Kompetencat që nxënësi ndërton përmes punës në grup, respektit të mendimeve të ndryshme që krijojnë emocione nga marrëdhëniet me natyrën apo nga ushtrimi i mendimit kritik, i shërbejnë tërthorazi edukimit shëndetësor, atij mediatik, ruajtjes së mjedisit dhe zhvillimit të qëndrueshëm, zhvillimit të aftësive psiko-sociale (emocionale, sociale dhe njohëse).

RN-të në përfundimin e arsimit fillor

NIVELI 5 <i>“Demonstrim shumë i mirë i rezultatit të nxënies”</i> <i>Pa kërkuar përpikëri absolute në zotërimin e përbërësve të kompetencës, presim që:</i>	
<i>Nxënësi, pasi përfundon klasën III:</i> • është i interesuar për natyrën dhe për dijet shkencore; • artikulon përvojat e ndërtuara, përshkruan thjesht dukuritë dhe vetitë e objekteve, përdor disa nga konceptet shkencore të mësuara;	<i>Nxënësi, pasi përfundon klasën V:</i> ▪ vëzhgon dhe përshkruan objekte natyrore ose të krijuara nga njeriu dhe shpjegon dukuritë natyrore duke përdorur terma, simbole dhe njësitë e mësuara shkencore; ▪ kupton tekste të thjeshta shkencore; përdor ose ndërton një model për të demonstruar kuptimin e proceseve dhe të sistemeve;

• nën drejtimin e mësuesit, bën vëzhgime të thjeshta dhe punë praktike, duke respektuar kërkesat e sigurisë; • nxjerr përfundimet dhe i paraqet ato; • vëren dhe i shpreh problemet që ndodhin rreth tij; • nën drejtimin e mësuesit, gjen informacion për shkencat natyrore, përdor mjetet e teknologjisë për mbledhjen e të dhënave për mësimin; • sillet në mënyrë të sigurt, ndjek një mënyrë jetese të shëndetshme, sillet me respekt ndaj qenieve të gjalla dhe ndaj nevojave të tyre.	▪ planifikon detyra praktike të thjeshta nën drejtimin e mësuesit, formulon pyetje kërkimore dhe kontrollon hipotezat, duke ndjekur rregulloret e sigurisë, zgjedh instrumente matëse të përshtatshme; analizon të dhënat, nxjerr përfundime dhe paraqet rezultatet e hulumtimit; ▪ vëren dhe formulon problemet që lidhen me jetën e përditshme dhe ofron zgjidhje për to, merr vendime të arsyetuara duke menduar në mënyrë kritike; ▪ kupton se dijet shkencore bazohen në prova dhe merren përmes kërkimit sistematik; ▪ njeh rëndësinë e shkencës dhe të teknologjisë dhe rreziqet që lidhen me zhvillimin e tyre; ▪ kupton domosdoshmërinë e dijes shkencore në jetën e përditshme dhe lidhjen e saj me zgjedhjet e ardhshme të karrierës, njeh profesionet që lidhen me shkencat natyrore dhe me teknologjinë në zonat e tyre; ▪ kupton marrëdhënien midis veprimtarisë njerëzore dhe mjedisit në vendin tonë dhe shpreh kujdes e respekt për të gjitha qeniet e gjalla; ▪ vlerëson biodiversitetin dhe zhvillimin e qëndrueshëm; ▪ ndjek problemet mjedisore si nisma qytetare.
--	--

Përbërësit e kompetencës që duhen ndërtuar dhe zbatuar nga nxënësit

Njohuri	Aftësi	Qëndrime
<i>Nxënësi ndihmohet të trajtojë situata që të fitojë njohuri për:</i> ▪ diversitetin, ciklet, sistemet, ndërveprimet, energjinë, shkallëzimin e matjes; ▪ identifikimin e problemeve dhe zgjidhjen e tyre; ▪ përdorimin e mjeteve, objekteve dhe procedurave shkencore;	<i>Nxënësi ndihmohet të trajtojë situata që e aftësojnë:</i> • të përdorë mjetet me të cilat mbledh të dhëna për të arritur në një përfundim të bazuar në prova; • të hetojë natyrën përmes eksperimenteve; • të zgjidhë probleme; • të komunikojë zgjidhje dhe arsyetimin që çuan në zgjidhje, në vendimin ose	<i>Nxënësi ndihmohet të trajtojë situata që të zhvillojë:</i> - respektin për të vërtetën; - këmbënguljen për të kërkuar arsyt; - gatishmërinë për të vlerësuar arsyetimet; - vlerësimin kritik dhe kureshtjen; - interesin për çështjet etike; - respektin për veten, familjen, komunitetin dhe çështjet globale.

▪ komunikimin me gjuhën dhe terminologjinë e shkencës; ▪ kontributin e shkencës dhe të teknologjisë për mirëqenien e njeriut dhe të shoqërisë; ▪ teknologjinë, produktet dhe proceset teknologjike; ▪ ndikimin e shkencës, teknologjisë, inxhinierisë dhe veprimtarisë njerëzore në botën natyrore; ▪ përparimet, kufizimet dhe rreziqet e zbatimeve të teknologjisë.	përfundimin e bazuar në prova.	- respektin për sigurinë dhe qëndrueshmërinë e përparimit shkencor dhe teknologjik.
---	---------------------------------------	--

8.4. Kompetenca digjitale

Kompetenca digjitale i referohet kapacitetit/zotësisë së nxënësit për të aktivizuar tërësinë e njohurive, të aftësive dhe të qëndrimeve të ndërtuara në shkollë ose jashtë saj, që të përdorë me siguri dhe përgjegjësi teknologjitë digjitale në mësim, në jetë dhe në ndërveprimet shoqërore; të komunikojë dhe të bashkëpunojë me të tjerët për të krijuar përmbajtje digjitale (përfshirë programimin); të jetë i sigurt (përfshirë shëndetin, cilësinë e jetës dhe dijet që lidhen me sigurinë kibernetike) dhe të zgjidhë probleme.

Zotërimi i kompetencës i krijon mundësi nxënësit të arrijë rezultatet e dëshiruara arsimore, të integrohet profesionalisht dhe të jetojë si qytetar në një shoqëri që evoluon vazhdimisht në aspektin teknologjik.

RN-të në përfundimin e arsimit fillor

NIVELI 5 <i>“Demonstrim shumë i mirë i rezultatit të nxënies”</i> <i>Pa kërkuar përpikëri absolute në zotërimin e përbërësve të kompetencës, presim që:</i>	
<i>Nxënësi, pasi përfundon klasën III:</i> - përdor kompjuterin, tabletën, smartfonin;	<i>Nxënësi, pasi përfundon klasën V:</i> • përshkruan si funksionon interneti, çfarë janë hardueri dhe softueri kompjuterik, jep shembuj të

KURRIKULA BËRTHAMË E ARSIMIT FILLOR (E PËRDITËSUAR)

- njeh veprimtaritë e kodimit duke përdorur platformat digjitale që ka mësuar; - përdor aplikacione edukative të krijuara për fëmijët; - bashkëpunon në internet; - është ndërgjegjësuar për sigurinë në internet.	përdorimit të sigurt të teknologjisë digjitale në shoqërinë e informacionit; • gjen një tekst, pamje, video, animacion të përshatshëm në internet dhe i referohet burimit; • krijon, formaton, ruan, riprodhon, si individualisht dhe në bashkëpunim, lloje të ndryshme të përmbajtjes digjitale (tekst, pamje, prezantim, video, animacion etj.) dhe i shpërndan ato, duke ndjekur praktikatat e mira dhe kërkesat e sigurisë digjitale; • përshkruan dhe shmang rreziqet që lidhen me përdorimin e mjeteve digjitale; • përshkruan shembuj të jetës reale të përdorimit të programeve për moshën në mjedise argëtuese dhe/ose me robotë edukativë; • përdor shërbimet online në përputhje me kërkesat e praktikës së mirë dhe të sigurisë digjitale, i drejtohet një prindi, mësuesi ose çdo institucioni që ofron ndihmë për ndihmë kur shfaqet ose dyshohet për një problem.
---	---

Përbërësit e kompetencës që duhen ndërtuar dhe zbatuar nga nxënësit

Njohuri	Aftësi	Qëndrime
<i>Nxënësi ndihmohet të trajtojë situata që të fitojë njohuri për:</i> ▪ rolin e mediave digjitale për të komunikuar dhe për të bashkëpunuar; ▪ organizimin dhe komunikimin për të mbledhur informacion dhe për të komunikuar me të tjerët (p. sh.: <i>e-mail</i>, internet, video-konferencë, <i>word-processor</i>, postera për një temë të caktuar); ▪ vetëdijen kulturore duke u angazhuar me nxënësit e kulturave të tjera nëpërmjet komunikimeve online;	<i>Nxënësi ndihmohet të trajtojë situata që e aftësojnë:</i> • të përdorë pajisje digjitale (kompjuter, tableta dhe smartfon etj.); • të përdorë mjete digjitale për të komunikuar (shkrimi i <i>e-mail</i>-eve, diskutime në internet), të kuptojë mirësjelljen digjitale dhe të krijojë projekte kodimi; • të kuptojë rëndësinë e praktikave të sigurisë kibernetike, si: krijimi i fjalëkalimeve, mbrojtja e informacionit personal dhe	<i>Nxënësi ndihmohet të trajtojë situata që të zhvillojë:</i> - kuriozitetin për të eksploruar teknologji të reja dhe për të zbuluar mjete të reja digjitale; - mendjen e hapur ndaj ndryshimeve teknologjike dhe mundësive që ofrojnë ato; - vetëbesimin kur përdor mjete digjitale; - besimin në aftësinë e tij për të përdorur teknologjinë në mënyrë efektive; - qasjet kritike ndaj informacionit digjital, duke mësuar të vlerësojë

▪ organizimin, mbledhjen dhe paraqitjen e të dhënave të gjetura nga burimet elektronike; ▪ identifikimin dhe përdorimin e të dhënave të sigurt dhe të përshtatura për moshën, nëpërmjet burimeve të ndryshme; ▪ përdorimin e sigurt të teknologjisë, duke u fokusuar në mbrojtjen e të dhënave vetjake; ▪ sjelljen e duhur dhe etike kur përdor teknologjinë si mjet komunikimi, shërbimi apo për krijimin e produktit.	praktikat e sjelljes së sigurt në internet; • të bashkëpunojë me të tjerët duke përdorur platforma dhe burime digjitale; • të kontrollojë burimin dhe përmbajtjen e një <i>e-mail</i>-i, përpara se të hapë një faqe ose të klikojë në një lidhje (<i>link</i>), që të shmangë mashtrimet dhe instalimet e viruseve (<i>phishing</i>) dhe të ruajë të dhënat. • të kuptojë të drejtat, përgjegjësitë dhe konsideratat etike për teknologjitë digjitale.	besueshmërinë e burimeve në internet; - përgjegjësinë në përdorimin e teknologjive, duke respektuar privatësinë në internet, sigurinë e të dhënave personale dhe etikën në veprimet online. - bashkëpunimin dhe komunikimin efektiv në internet, me theks punën ekipore, zgjidhjen e problemeve në grup dhe përdorimin e duhur të mjeteve të komunikimit digjital.
--	--	--

8.5. Kompetenca personale, shoqërore dhe e të nxënës

Kuptohet si kapaciteti/zotësia e nxënësit për të aktivizuar tërësinë e njohurive, të aftësive dhe të qëndrimeve që i ndërton në shkollë ose jashtë saj për të reflektuar për veten; për të menaxhuar në mënyrë efektive kohën dhe informacionin; për të punuar me të tjerët në mënyrë konstruktive; për të qenë i gatshëm të menaxhojë nxënien dhe karrierën e vet; për të përballuar pasigurinë dhe kompleksitetin; për të mësuar si të mësojë; për të ndihmuar mirëqenien fizike dhe emocionale të dikujt dhe për të menaxhuar konfliktin.

RN-të në përfundimin e arsimit fillor

NIVELI 5 <i>“Demonstrim shumë i mirë i rezultatit të nxënies”</i> <i>Pa kërkuar përpikëri absolute në zotërimin e përbërësve të kompetencës, presim që:</i>	
Nxënësi, pasi përfundon klasën III: - njeh dhe i shpreh rregullat themelore të higjienës personale dhe të mjedisit ku jeton dhe vepron; - merr pjesë në veprimtari fizike dhe lojëra sportive dhe respekton rregullat e caktuara;	Nxënësi, pasi përfundon klasën V: ▪ shpreh mendimin duke kërkuar leje nga grupi, respekton mendimin e shokëve, i dëgjon dhe vendos me ta për mënyrat e kryerjes së veprimtarisë;

- liston ushqimet që i konsumon dhe masat për t'u mbrojtur nga sëmundjet; - përdor kohën e lirë në të mirën e shëndetit dhe të mirëqenies së tij; - kujdeset për një mjedis të shëndetshëm gjatë një aktiviteti; - zgjedh materialet/mjetet, si letrën, plastelinën, shkopinjët, ngjyrat etj., për kryerjen e një detyre dhe tregon si e zgjidhi; - pyet dhe përgjigjet për detyrën që kryen me një nga format e shprehjes; - grumbullon dhe klasifikon materialet e detyrës për përgatitjen apo për pasurimin e portofolit të tij; - kërkon këshilla e informacion për kapërcimin e vështirësive që ndesh kur kryen një detyrë apo porosi.	▪ prezanton rregullat themelore të higjienës personale dhe të mjedisit ku jeton dhe vepron; ▪ merr pjesë në veprimtari fizike dhe lojëra sportive, luan dhe menaxhon emocionet kur fiton apo humbet; ▪ bën një listë me ushqimet që i konsumon dhe merr masa për t'u mbrojtur nga sëmundjet; ▪ shfrytëzon kohën e lirë në të mirën e shëndetit dhe të mirëqenies së tij; ▪ bashkëpunon me shokët pavarësisht prejardhjes, aftësive dhe nevojave të veçanta për arritjen e një qëllimi të përbashkët në klasë, shkollë apo jashtë saj; ▪ tregon mënyrat e zgjidhjes së një konflikti dhe ndan mendimet dhe ndjenjat e veta me të tjerët; ▪ kujdeset për një mjedis të shëndetshëm gjatë një veprimtarie, duke u kujdesur për ajrosjen, ndriçimin, shfrytëzimin e hapësirës, pastërtinë; ▪ përzgjedh materialet/mjetet, si letrën, plastelinën, shkopinjët, ngjyrat etj., për kryerjen e një detyre dhe arsyeton zgjedhjen; ▪ ndjek udhëzimet që jepen në libër apo në material për të realizuar një veprim/aktivitet/detyrë; ▪ parashtro pyetje dhe përgjigjet për temën / problemin me një nga format e shprehjes; ▪ mbikëqyr vetë përparimin kur kryen një detyrë ose veprimtari, gjen gabimet dhe i korrigjon ato; ▪ grumbullon dhe klasifikon materialet e detyrës për përgatitjen apo për pasurimin e portofolit personal; ▪ identifikon njohuritë që e ndihmojnë të kryejë një detyrë apo veprimtari të caktuar, kërkon këshilla e informacion për kapërcimin e vështirësive.
---	--

Përbërësit e kompetencës që duhen ndërtuar dhe zbatuar nga nxënësit

Njohuri	Aftësi	Qëndrime
<i>Nxënësi ndihmohet të trajtojë situata që të fitojë njohuri për:</i> ▪ veten; ▪ menaxhimin si duhet të kohës dhe të informacionit; ▪ punën me të tjerët në mënyrë konstruktive; ▪ menaxhimin e të nxënës; ▪ mësimin se si të mësojë; ▪ ndihmën për mirëqenien fizike dhe emocionale të tjetrit; ▪ ruajtjen e shëndetit fizik dhe mendor; ▪ menaxhimin e konfliktit në një kontekst kompleks dhe mbështetës; ▪ përdorimin me përgjegjësi dhe me siguri të mjeteve digjitale për të mësuar dhe për të komunikuar; ▪ vlerësimin e burimeve të informacionit dhe dallimin mes burimeve të besueshme dhe atyre të pasakta.	<i>Nxënësi ndihmohet të trajtojë situata që e aftësojnë:</i> • të shoqërizohet; • të mendojë në mënyrë kritike; • të krijojë; • të përshtatet; • të marrë nisma dhe përgjegjësi; • të mësojë si të mësojë.	<i>Nxënësi ndihmohet të trajtojë situata që të zhvillojë:</i> - mendjen e hapur; - vetëmotivimin; - respektin për vete dhe të tjerë; - empatinë; - përgjegjësinë për veprimet; - bashkëpunimin; - reflektimin.

8.6. Kompetenca e qytetarisë

Kuptohet si kapaciteti/zotësia e nxënësit për të aktivizuar tërësinë e integruar të njohurive, të aftësive dhe të qëndrimeve që i ndërton në shkollë ose jashtë saj, për të vepruar si qytetar i përgjegjshëm dhe për të marrë pjesë plotësisht në jetën qytetare dhe shoqërore bazuar në kuptimin e koncepteve dhe të strukturave sociale, ekonomike e politike, dhe në kuptimin e koncepteve globale dhe të qëndrueshmërisë.

RN-të në përfundimin e arsimit fillor

NIVELI 5 <i>“Demonstrim shumë i mirë i rezultatit të nxënies”</i> <i>Pa kërkuar përpikëri absolute në zotërimin e përbërësve të kompetencës, presim që:</i>	
<i>Nxënësi, pasi përfundon klasën III:</i> • prezanton rolet dhe detyrat e anëtarëve të familjes së vet apo të ndonjë grupi ku është pjesëmarrës (grup loje, veprimtari); • diskuton me shokët dhe vendosin rregullat për realizimin e veprimtarisë, mirësjelljes, pastërtisë etj.; • njeh dhe identifikon vlerat që kultivohen në klasë, shkollë apo familje; • shpreh mendimin dhe respekton mendimin e shokëve gjatë kryerjes së veprimtarie; • vlerëson elemente të pjesëmarrjes në veprimtari dhe përgjegjësinë vetjake; • përshkruan si mund të silllet në një situatë konflikti.	<i>Nxënësi, pasi përfundon klasën V:</i> • paraqet në forma të ndryshme të drejtat dhe përgjegjësitë e pjesëtarëve të familjes dhe i diskuton me grupin, duke i krahasuar ato me të drejtat dhe përgjegjësitë e nxënësve, mësuesve dhe të stafit; • shpreh, dëgjon dhe respekton mendimin e secilit anëtar dhe vendos për përfundimin e një veprimtarie; • propozon vlera shoqërore të rëndësishme që të respektohen në klasë, në shkollë apo në familje me anë të shembujve konkretë; • manifeston veprime që shprehin mirësjellje në situata të ndryshme dhe tregon përdorimin e tyre përmes shembujve konkretë. • propozon dhe ndan mendimin me shokët/shoqet e klasës për procedurën e zgjedhjes së anëtarëve të grupeve, përbërjen dhe rolin e tyre në veprimtari mësimore, këshilla të klasës/shkollës etj. • merr pjesë në hartimin e rregullores së klasës dhe argumenton rëndësinë e respektimit të rregullave të propozuara me forma të ndryshme shprehëse; • identifikon dy ose më shumë organizime shoqërore dhe përshkruan mënyrat se si njerëz me përvoja të ndryshme organizojnë diçka të përbashkët. • identifikon ndryshimet në familje apo komunitet si dhe disa nga ngjarjet kryesore të popullit, duke dalluar ndryshimet dhe ngjashmërinë ndërmjet të tashmes dhe së shkuarës. • paraqet me shembuj konkretë sjelljet që duhen manifestuar në rast rreziku nga fatkeqësitë natyrore apo të krijuara nga njeriu, si: zjarri, vërshimi, tërmeti, komunikimit me njerëz të panjohur etj. • shpreh kuptimin e tij për vlerat demokratike dhe respektin për diversitetin; • vlerëson pjesëmarrjen aktive, përgjegjësinë vetjake dhe zgjidhjen e konflikteve.

Përbërësit e kompetencës që duhen ndërtuar dhe zbatuar nga nxënësit

Njohuri	Aftësi	Qëndrime
<i>Nxënësi ndihmohet të trajtojë situata që të fitojë njohuri për:</i> • dukuritë që lidhen me individët, grupet, organizatat, shoqërinë, ekonominë dhe kulturën; • vlerat e përbashkëta europiane; • ngjarjet bashkëkohore; • zhvillimet kryesore në historinë kombëtare, europiane dhe botërore; • synimet dhe vlerat e lëvizjeve shoqërore dhe politike; • vetëdijen për larminë dhe identitetet kulturore në Europë dhe në botë; • kulturat, shoqëritë dhe ekonomitë e shteteve europiane; • mënyrën se si identitetet kulturore kombëtare kontribuojnë në identitetin evropian etj.	<i>Nxënësi ndihmohet të trajtojë situata që e aftësojnë:</i> • të angazhohet me të tjerët në sferën publike; • të tregojë solidaritet dhe interes për zgjidhjen e problemeve që prekin shokët dhe më gjerë; • të reflektojë në mënyrë kritike dhe krijuese për veprimtaritë e klasës/shkollës; • të marrë pjesë në mënyrë konstruktive në veprimtaritë e klasës/shkollës; • të kuptojë dhe të ndërveprojë me format tradicionale dhe të reja të medias.	<i>Nxënësi ndihmohet të trajtojë situata që të zhvillojë:</i> - respektin për të drejtat e njeriut; - kontributin për kulturën e paqes; - respektin për institucionet dhe proceset demokratike; - respektin dhe tolerancën; - angazhimin qytetar; - përgjegjësinë dhe ndjenjën e detyrës; - mirëkuptimin dhe solidaritetin ndaj shokëve.

8.7. Kompetenca e sipërmarrjes

Kuptohet si kapaciteti/zotësia e nxënësit për të aktivizuar tërësinë e njohurive, të aftësive dhe të qëndrimeve që i ndërton në shkollë ose jashtë saj, me të cilat vepron sipas mundësive dhe ideve dhe i shndërron ato në vlera për vete dhe të tjerët. Kompetenca e ndërtuar mundëson krijimtarinë, mendimin kritik, zgjidhjen e problemeve, vetëveprimin dhe këmbënguljen për të punuar në bashkëpunim, si dhe për të planifikuar e menaxhuar projekte që kanë vlerë kulturore, sociale ose tregtare.

Duhet mbajtur parasysh ndërkaq se nxënësit 7-11 vjeç nuk arrijnë shumë në ndërtimin e kësaj kompetence. Megjithatë, edhe në AF, veprimtaritë ofrojnë mundësi që nxënësit të fitojnë njohuri, aftësi dhe qëndrime që të dalin me ide dhe zgjidhje të reja, p.sh., duke

luajtur me role, ata mund të mësojnë të punojnë me të tjerët, të ndajnë ide dhe të gjejnë qëllime të përbashkëta; ata mund të mësojnë të veprojnë të pavarur, të kërkojnë mundësi të reja dhe të marrin përgjegjësi për veprimet.

RN-të në përfundimin e arsimit fillor

NIVELI 5 "Demonstrim shumë i mirë i rezultatit të nxënies" <i>Pa kërkuar përpikëri absolute në zotërimin e përbërësve të kompetencës, presim që:</i>	
<i>Nxënësi, pasi përfundon klasën III:</i> • përgatit një plan pune të thjeshtë javor dhe cakton veprimtaritë që do të realizojë; • mund të punojë me të tjerët dhe të ndajë ide me ta; • mund të veprojë i pavarur dhe të tregojë përgjegjësi për veprimet e tij; • përgatit një projekt të vogël; • llogarit shpenzimet personale ose familjare për një ditë; • lexon etiketën, udhëzuesin e produkteve të ndryshme (rrobave, ushqimeve, ilaçeve) dhe sqaron rreziqet nga mospërdorimi në mënyrën e duhur; • paraqet në formë vizatimi apo në një formë tjetër përkujdesjen për kafshën që parapëlqen.	<i>Nxënësi, pasi përfundon klasën V:</i> ▪ mund të japë ide dhe zgjidhje të reja, p.sh., trajton një detyrë që kërkon krijimtari; ▪ mund të punojë me të tjerët, të ndajë ide dhe të gjejë qëllime të përbashkëta me ata; ▪ mund të veprojë i pavarur, të kërkojë mundësi të reja dhe të marrë përgjegjësi për veprimet e tij; ▪ përgatit një plan pune njëjavor dhe specifikon veprimtaritë kryesore, duke argumentuar zgjedhjen; ▪ përgatit një projekt të vogël, duke theksuar veprimtaritë kryesore për një çështje, që e shqetëson në shkollë ose komunitet, dhe përcakton kohën, vendin, materialet, mjetet e nevojshme për zbatimin e tij; ▪ identifikon dhe llogarit shpenzimet personale ose familjare përgjatë një jave dhe i paraqet ato në formë tabele/grafike apo në një formë tjetër; ▪ lexon etiketën, udhëzuesin e produkteve të ndryshme (rrobave, ushqimeve, ilaçeve) dhe sqaron përmbajtjen, përdorimin, mënyrën e mirëmbajtjes si dhe rreziqet nga mospërdorimi në mënyrën e duhur; ▪ paraqet në formë tabele, grafike apo formë tjetër përkujdesjen për qeniet e gjalla, të cilat mundësojnë zhvillimin, rritjen apo ruajtjen e shëndetit të tij.

Përbërësit e kompetencës që duhen ndërtuar dhe zbatuar nga nxënësit

Njohuri	Aftësi	Qëndrime
<i>Nxënësi ndihmohet të trajtojë situata që të fitojë njohuri për:</i> ▪ qasjet e planifikimit dhe të menaxhimit të	<i>Nxënësi ndihmohet të trajtojë situata që e aftësojnë:</i> • të zhvillojë krijimtarinë, çka ndërton imagjinatën, të menduarit strategjik,	<i>Nxënësi ndihmohet të trajtojë situata që të zhvillojë:</i> - krijimtarinë dhe zgjidhen e problemeve; - pavarësinë dhe iniciativën;

projekteve, përfshirë proceset dhe burimet; ▪ mundësitë dhe sfidat sociale dhe ekonomike me të cilat përballet një punëdhënësi; ▪ parimet etike dhe sfidat e zhvillimit të qëndrueshëm.	zgjidhjen e problemit, reflektimin kritik dhe konstruktiv; • të punojë duke mobilizuar burimet si individ dhe si grup; • të komunikojë për të negociuar me të tjerët.	- bashkëpunimin dhe komunikimin; - përgjegjësinë etike dhe sociale.
---	---	--

8.8. Kompetenca për vetëdijen dhe shprehjen kulturore

Kuptohet si kapaciteti/zotësia e nxënësit për të aktivizuar tërësinë e njohurive, të aftësive dhe të qëndrimeve që i ndërton në shkollë ose jashtë saj, të cilat e lejojnë të kuptojë dhe të respektojë mënyrën sesi idetë dhe kuptimet shprehen e komunikohen në mënyrë krijuese në kultura të ndryshme, me mjete dhe forma të tjera kulturore. Kjo kompetencë mundëson kuptimin, zhvillimin dhe shprehjen e ideve, të ndjenjës së përkatësisë ose të rolit të nxënësit në shoqëri, në mënyra dhe kontekste të ndryshme.

RN-të në përfundimin e arsimit fillor

NIVELI 5 <i>“Demonstrim shumë i mirë i rezultatit të nxënies”</i> <i>Pa kërkuar përpikëri absolute në zotërimin e përbërësve të kompetencës, presim që:</i>	
<i>Nxënësi, pasi përfundon klasën III:</i> • njeh tradita, vlera, zakone dhe shprehje artistike të zonës së tij e më gjerë; • njeh elemente të trashëgimisë sonë kulturore dhe i respekton ato; • shprehet me gojë dhe me shkrim nëpërmjet tregimeve të shkurtra, vizatimeve, pikturave ose interpretimit të vjershave; • është i informuar për kulturat e tjera dhe për diversitetin e tyre; • performon këngë, ritme dhe hapa të thjeshtë kërcimi nga kultura të ndryshme; • njeh histori dhe përralla të ndryshme dhe i ndan ato me të tjerët.	<i>Nxënësi, pasi përfundon klasën V:</i> ▪ merr pjesë në veprimtari kulturore brenda shkollës; ▪ komenton aspekte të ndryshme të kulturës, përfshirë traditat, vlerat, zakonet dhe shprehjet artistike; ▪ është i vetëdijshëm për trashëgiminë tonë kulturore dhe e vlerëson/respekton atë; ▪ shprehet qartë me gojë dhe shkrim nëpërmjet tregimeve të shkurtra, vizatimeve, pikturave ose interpretimit të poezive për festat, zakonet dhe ritet tona; ▪ eksploron histori dhe përralla dhe i ndan ato me të tjerët;

	▪ njeh artefakte kulturore, si: arti, muzika, letërsia dhe zanatet tradicionale nga kultura të ndryshme; ▪ komunikon me fjali të thjeshta me njerëz në gjuhë të huaj; ▪ respekton kulturat e tjera dhe diversitetin e tyre; ▪ performon këngë, ritme dhe hapa të thjeshtë kërcimi nga kultura të ndryshme; ▪ ka mësuar të vlerësojë dhe të pëlqejë të veçantat, në vend që të diskriminojë bazuar në dallimet kulturore.
--	--

Përbërësit e kompetencës që duhen ndërtuar dhe zbatuar nga nxënësit

Njohuri	Aftësi	Qëndrime
<i>Nxënësi ndihmohet të trajtojë situata të fitojë njohuri për:</i> ▪ mësimin në mënyrë efektive dhe të pavarur, motivimin, vendimin dhe arritjen e qëllimeve; ▪ kuptimin e kulturave, traditave dhe vlerave të ndryshme vendore, kombëtare, rajonale, europiane dhe globale; ▪ qenien i hapur dhe empatik ndaj diversitetit të botës; ▪ shprehjen qartë dhe bindshëm me gojë dhe me shkrim; ▪ kuptimin e artit dhe të muzikës; ▪ pjesëmarrjen në komunikimin ndërkulturor, përfshirë njerëz nga kultura të ndryshme.	<i>Nxënësi ndihmohet të trajtojë situata që të aftësohet:</i> • të komunikojë në gjuhën amtare dhe në një gjuhë të huaj; • të shprehet përmes formave të ndryshme të artit, si: vizatimi, piktura, muzika, kërcimi apo teatri; • të vlerësojë dhe të ruajë traditat, vendet historike dhe vlerat kulturore; • të tregojë ndjeshmëri ndaj njerëzve dhe kulturave të tjera; • të komunikojë dhe të bashkëpunojë me njerëz të ndryshëm; • të krijojë dhe të jetë i hapur ndaj ideve të reja.	<i>Nxënësi ndihmohet të trajtojë situata që të zhvillojë:</i> - kureshtjen dhe çiltërsinë ndaj kulturave, traditave dhe formave të artit; - krijimtarinë dhe shprehjen e vetes me mënyra të ndryshme që përfshijnë artin, muzikën, shkrimin ose ndonjë veprimtari tjetër krijuese; - hapjen ndaj shikimeve të ndryshme dhe ndjeshmërinë për kulturat dhe njerëzit e tjerë; - komunikimin me përfaqësues të kulturave të ndryshme dhe gatishmërinë për bashkëpunim që të kuptojë origjina të ndryshme kulturore; - mendimin kritik dhe hapjen ndaj ideve dhe qasjeve të reja, që të kuptojë dhe të analizojë shprehje të ndryshme në botën e sotme shumëkulturore.

9. FUSHAT KURRIKULARE DHE LËNDËT PËRKATËSE

Nëse kompetenca është **kapacitet/zotësi vetjake** për të aktivizuar njohuri, aftësi dhe qëndrime të caktuara që nxënësi i ndërton dhe i përdor gjatë procesit mësimor ose jashtë tij, fusha kurrikulare është “**mjeti pedagogjik**” ku organizohen përmbajtjet e lëndëve të ndryshme që mësuesit përdorin për të ndihmuar nxënësit të arrijnë rezultate e nxënies; ndryshe, të demonstrojnë zotërimin e përbërësve të kompetencave me të cilat trajtojnë me efikasitet situata mësimore ose jetësore, pasi përfundojnë arsimin bazë.

Funksioni i **fushës kurrikulare** në AF është i dyfishtë. Fusha kurrikulare përshkruan **përmbajtjet** për t’u përdorur nga mësuesit dhe nxënësit në lëndë të caktuara për ndërtimin e kompetencave specifike; **përbërësit e tyre** (njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet) dhe **rezultatet e nxënies**.

Fusha kurrikulare ofron gjithashtu mundësi që përbërësit e kompetencave të ndërtuar prej nxënësve të mund të shërbejnë edhe për trajtimin e situatave mësimore që ofrojnë përmbajtjet e lëndëve të tjera. Konkretizimi i kësaj marrëdhënieje i ndihmon nxënësit të përvetësojnë gradualisht dhe sistematikisht përbërësit e **kompetencave kyç**.

Çdo fushë krijon kushte që nxënësit të arrijnë rezultatet e nxënies. **Rezultatet që presim të arrijnë nxënësit pasi përfundojnë arsimin fillor**, orientojnë përzgjedhjet e **situatave mësimore** që paraqiten në programet lëndore dhe zhvillohen në procesin mësimor nga mësuesi dhe nxënësi. Fushat kurrikulare përfshijnë një ose më shumë lëndë, planifikimi dhe zhvillimi i të cilave në **renditje** dhe në **kohë** orientohet nga programet lëndore përkatëse, duke u lënë mësuesve **të drejtën** për të bërë rregullime dhe përshtatje që i vlerësojnë të arsyeshme për nxënësit e tyre.

Kurrikula e arsimit tonë parauniversitar ka përcaktuar këto **fusha kurrikulare**:

1. Gjuhët dhe komunikimi
2. Matematikë
3. Shkencat e natyrës
4. Shkencat shoqërore
5. Teknologji dhe TIK
6. Arte
7. Edukimi fizik, sporti dhe shëndeti.

Procesi mësimor në AF duhet t'u ofrojë nxënësve mjete dhe mundësi që të ndërtojnë dhe të zbatojnë përbërësit e kompetencave, për çka është e rëndësishme që mësuesi t'i ndihmojë dhe t'i nxitë nxënësit t'i ndërtojnë dhe t'i zhvillojnë vetë përbërësit, në vend që të përpiqet t'ua mësojë atyre. Pikërisht, në këtë këndvështrim duhen kuptuar kompetencat, roli i tyre në zhvillimin e kurrikulës dhe lidhja logjike midis tri elementeve për çdo lëndë të fushave:

- ÷ **Kompetencave** (kyç dhe lëndore).
- ÷ **RN-ve** që informojnë se cilat situata mësimore mund të trajtohen.
- ÷ **Njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet** që duhen përvetësuar nëpërmjet trajtimit të situatave.

9.1. Fusha kurrikulare “Gjuhët dhe komunikimi”

Fusha “Gjuhët dhe komunikimi” u mundëson nxënësve të zhvillojnë dhe t'i përdorin gjuhët si mjete komunikimi në jetën e përditshme, në veprimtaritë e tyre profesionale dhe shoqërore. Në arsimin fillor, në fushën “Gjuhët dhe komunikimi” përfshihen lëndët “Gjuha shqipe” dhe “Gjuha angleze”. Në këtë fushë përfshihen edhe lënda e gjuhës së shenjave shqipe për nxënësit që nuk dëgjojnë dhe lënda e gjuhës amtare për pakicat kombëtare.

RN-të e lëndës janë orientuese për mësuesit e gjuhës së shenjave shqipe dhe mësuesit e gjuhës amtare në shkollat e pakicave kombëtare. Përbërësit e kompetencave që nxënësi ndërton dhe përdor në fushën “Gjuhët dhe komunikimi” janë bazë për arritjet e nxënësve në fusha të tjera kurrikulare dhe, më pas, në jetë.

Qëllimet e fushës

Qëllimet janë:

- zhvillimi i kompetencave të komunikimit;
- dallimi i llojeve të ndryshme të teksteve letrare dhe joletrare;
- kuptimi, analiza dhe vlerësimi i teksteve letrare dhe joletrare;
- vlerësimi i letërsisë nëpërmjet studimit të veprave të shkrimtarëve, përfaqësues të periudhave të ndryshme të letërsisë shqiptare dhe botërore;
- formimi estetik i nxënësve;
- zhvillimi i njohurive, aftësive dhe qëndrimeve rreth sistemit gjuhësor: sintaksë,

morfologji, fonetikë, drejtshkrim, leksikologji dhe semantikë.

9.2 Lënda “Gjuhë shqipe”

Kjo lëndë zë vend të rëndësishëm në arsimin fillor. Mësimi cilësor i gjuhës shqipe do t'i mësojë nxënësit të flasin dhe të shkruajnë rrjedhshëm, që të komunikojnë idetë dhe emocionet tek të tjerët, nëpërmjet leximit dhe dëgjimit të tyre. Aftësitë gjuhësore janë të rëndësishme për të marrë pjesë si anëtar i shoqërisë, prandaj nxënësit që nuk mësojnë të flasin, të lexojnë dhe të shkruajnë rrjedhshëm dhe me vetëbesim, në fakt, janë të privuar nga të qenët të pranueshëm dhe të suksesshëm. Përmes leximit, nxënësit kanë mundësi të zhvillohen në aspektet kulturore, intelektuale, shoqërore dhe shpirtërore.

Qëllimet e lëndës:

- Zhvillimi i aftësive të nxënësve për të folur, dëgjuar, lexuar dhe shkruar tekste letrare dhe joletrare, si dhe kultivimi i mendimit kritik e krijues nëpërmjet këtyre teksteve.
- Kërkimi, gjetja, gjykimi në mënyrë kritike dhe përdorimi i informacionit që merret nga mediat dhe interneti.
- Vlerësimi i trashëgimisë sonë letrare të pasur dhe të larmishme.
- Zotërimi dhe demonstrimi i njohurive, aftësive dhe qëndrimeve të duhura rreth sistemit gjuhësor të shqipes.
- Vlerësimi i gjuhës si pjesë e identitetit kombëtar dhe si mjet komunikimi.

Përshkrimi i kompetencave specifike që ndërton dhe zbaton nxënësi

Kompetencat specifike	Përshkrimi i kompetencave <i>Kapaciteti/zotësia e nxënësit për të aktivizuar njohuri, aftësi dhe qëndrime me të cilat:</i>
Dëgjon dhe flet saktë për qëllime të ndryshme	▪ tregon brendinë, veçon idenë kryesore, dallon fjalët ose frazat kyç, parashikon, identifikon fakte dhe opinione, nxjerr përfundime, krahason ose klasifikon, si dhe vlerëson përmbajtjen dhe formën e teksteve që dëgjon. ▪ përdor drejt gjuhën standarde gjatë të folurit; ▪ kupton dhe zbaton në komunikim karakteristikat e gjuhës së folur; ▪ shqipton saktë, me intonacionin dhe theksin e duhur fjalët dhe fjalitë, me qëllim që të jetë i kuptueshëm dhe interesant për të tjerët; ▪ shoqëron të folurin edhe me elemente të komunikimit joverbal; ▪ diskuton dhe bashkëvepron me të tjerët gjatë punës në grup.
	▪ përdor njohuritë dhe aftësitë bazë për të kuptuar tekste të ndryshme, përfshirë tekste digjitale dhe mediatike nga shkrimtarë dhe autorë të periudhave dhe të

KURRIKULA BËRTHAMË E ARSIMIT FILLOR (E PËRDITËSUAR)

Lexon tekste të ndryshme	kulturave të ndryshme, si dhe analizon elemente të përmbajtjes, veçori dhe elemente të stilit që lidhen me forma dhe gjini të ndryshme teksti; ▪ zbaton strategjitë e të kuptuarit para, gjatë dhe pas leximit të teksteve të ndryshme, me qëllim që t'i kuptojë tekstet.
Shkruan tekste dhe shpreh ide, ndjenja dhe opinione	▪ planifikon, zhvillon ide, mbledh dhe organizon informacion për shkrimin e teksteve të ndryshme, duke përfshirë tekste digjitale dhe mediatike, me tematika të përshtatshme për moshën e tij; ▪ zbaton njohuritë rreth formave dhe gjinive të ndryshme të tekstit për të krijuar, rishikuar, redaktuar dhe korrigjuar tekstet e tij, si dhe reflekton në mënyrë kritike mbi tekstet e krijuara; ▪ zgjedh media, teknika dhe mjete të përshtatshme dhe efektive për të prezantuar tekstet dhe analizon në mënyrë kritike trajtimin e temave të ndryshme në tekste.
Përdor drejt gjuhën	▪ demonstroi njohuri, aftësi dhe qëndrime për gjymtyrët kryesore dhe të dyta, për llojet e fjalive sipas kumtimit, pohimit dhe mohimit dhe sipas gjymtyrëve kryesore, për përdorimin e ligjëratës së drejtë dhe të ligjëratës së zhdrejtë, për fjalët e ndryshueshme (kategoritë e tyre gramatikore) dhe fjalët e pandryshueshme, për përbërësit e fjalës dhe mënyrat e formimit të saj; ▪ njeh dhe zbaton rregullat drejtshkrimore, si dhe përdor drejt shenjat e pikësimit.

RN-të në përfundimin e arsimit fillor

NIVELI 5 “Demonstrim shumë i mirë i rezultatit të nxënies” <i>Pa kërkuar përpikëri absolute në zotërimin e përbërësve të kompetencës, presim që nxënësi:</i>	
1. Për kompetencat e të dëgjuarit dhe të folurit <u>Rezultati:</u> - Nxënësi do të jetë në gjendje të kuptojë dhe të komunikojë ide të ndërlikuara në mënyrë efektive në situata të ndryshme sociale dhe mësimore, duke përshtatur gjuhën në përputhje me kontekstin dhe audiencën. <u>Treguesit:</u> - Diskutime në grup, duke shprehur mendime të argumentuara dhe duke dëgjuar me vëmendje kontributet e të tjerëve. - Përdorimi i një gjuhe të pasur dhe të larmishme për të shprehur nuanca të ndryshme të kuptimit. - Përshtatja e stilit të fjalimit në përputhje me kontekstin formal ose informal.	
2. Për kompetencën e të lexuarit <u>Rezultati:</u> - Nxënësi do të jetë në gjendje të lexojë dhe të interpretojë një gamë të gjerë tekstesh, duke nxjerrë përfundime dhe duke lidhur informacionin me njohuritë e mëparshme. <u>Treguesit:</u> - Analizë e strukturës së tekstit, duke identifikuar idetë kryesore, detajet mbështetëse dhe lidhjet midis tyre.	

- Vlerësimi i besueshmërisë së informacionit dhe identifikim i paragjykimeve të mundshme.
- Krijimi i pyetjeve të nivelit të lartë dhe përgjigje të argumentuara mbi bazën e tekstit.

3. Për kompetencën e të shkruarit

Rezultati:

- Nxënësi do të jetë në gjendje të shkruajë tekste të qarta, koherente dhe efektive për një gamë të gjerë qëllimesh, duke përdorur një stil të përshtatshëm.

Treguesit:

- Organizimi i qartë i ideve, duke përfshirë një hyrje, një trup dhe një përfundim.
- Zgjedhje e fjalëve dhe e shprehjeve të përshtatshme, për të krijuar një efekt të caktuar.
- Redaktimi dhe korrigjimi i tekstit për të përmirësuar qartësinë, koherencën dhe saktësinë gramatikore.

4. Për përdorimin e gjuhës

Rezultati:

- Nxënësi do të demonstrojë zotërim të lartë të gjuhës shqipe, duke e përdorur atë me fleksibilitet dhe në përshtatshmëri me situata të ndryshme.

Treguesit:

- Përdorimi i një fjalori të pasur dhe të larmishëm, duke përfshirë fjalë të specializuara dhe idioma.
- Njohja dhe zbatim i rregullave të gramatikës, drejtshkrimit dhe stilistikës.
- Përdorimi i gjuhës për të shprehur nuanca të ndryshme të kuptimit, siç janë: ironia, sarkazmi dhe humori.

Përbërësit e kompetencave specifike që ndërton dhe zbaton nxënësi

Njohuri	Aftësi	Qëndrime
<i>Nxënësi ndihmohet të trajtojë situata që të fitojë njohuri për:</i> Të folurin dhe dëgjimin: • përdorimi korrekt i rregullave të dëgjimit dhe të të folurit; • identifikimi i mesazheve dhe i detajeve të tekstit të dëgjuar; • pasurimi i fjalorit; • përdorimi i sinonimeve/antonimeve; • zhvillimi i rrëfimeve, diskutimeve dhe bisedave. Të lexuarin dhe shkrimin: • lidhja e tingullit me shkronjën; • ndërtimi dhe kuptimi i fjalisë dhe i teksteve të thjeshta;	<i>Nxënësi ndihmohet të trajtojë situata për ta aftësuar që:</i> Të dëgjojë dhe të kuptojë: • të përqendrohet në biseda; • të respektojë të tjerët gjatë dëgjimit dhe prezantimit. Të shprehet qartë: • të flasë rrjedhshëm dhe të përdorë një fjalor të pasur me struktura të sakta gramatikore. Të lexojë dhe interpretojë: • të lexojë rrjedhshëm dhe të analizojë përmbajtjen e teksteve, duke zbuluar tema,	<i>Nxënësi ndihmohet të trajtojë situata që të zhvillojë:</i> Vetëbesim dhe vetëvlerësim: • besim në vetvete për të komunikuar dhe për të reflektuar për rezultatin. Përgjegjësi dhe ndjeshmëri: • përdorim i matur i gjuhës, hapje ndaj mendimeve të ndryshme dhe respekt ndaj bashkëbiseduesve. Respekt për kulturën: • vlerësim për gjuhën dhe kulturën vetjake, duke nxitur përgjegjshmëri dhe reflektim mbi përdorimin e gjuhës në situata të

• analiza e elementeve të teksteve letrare dhe joletrare; • përvetësimi i tipareve kryesore të llojeve të ndryshme të teksteve (përralla, fabula, poezi, ese, tekste digjitale). Përdorimin e drejtë të gjuhës: • njohuri mbi sintaksën (rendi i fjalëve, llojet e fjalive; kallëzuesi/kryefjala); • morfologjia (emrat, mbiemrat, përemrat, foljet, ndajfoljet); • leksikologjia (kuptimet, sinonimet dhe antonimet); • fjalëformimi (fjalët e parme, rrënjët dhe parashtesat).	mesazhe dhe elemente figurative. Të shkruajë saktë: • të analizojë dhe të krahasojë burime të informacionit; • të ndërtojë argumente dhe të mbështetë idetë personale. Të bashkëpunojë e të prezantojë • të përdorë gjuhën për projekte dhe komunikim pamor dhe gojor.	ndryshme.
--	--	-----------

9.3. Lënda “Gjuhë angleze”

Lënda synon ndërtimin dhe përdorimin nga nxënësi të kompetencës së komunikimit në gjuhë të huaj. Për të realizuar qëllimet komunikuese, nxënësi mobilizon kapacitetet e tij dhe i kombinon ato me kompetencën e komunikimit në gjuhë të huaj, e cila sintetizon parimet bazë gramatikore, njohuritë dhe aftësitë se si përdoret gjuha në mjedise shoqërore për të komunikuar dhe e ndihmon nxënësin të shfaqë qëndrimet e duhura, njëherazi, njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet me të cilat dëshmon kombinimin e funksioneve komunikuese me parimet e ligjërimit.

Përshkrimi i kompetencave specifike që ndërton dhe zbaton nxënësi

Kompetencat specifike	Përshkrimi i kompetencave <i>Kapaciteti/zotësia e nxënësit për të aktivizuar njohuri, aftësi dhe qëndrime me të cilat:</i>
Kompetenca gjuhësore	• Përvetëson rregullat gramatikore, semantike, fonetike, drejtshkrimore, si dhe pasuron fjalorin.
Kompetenca socio-gjuhësore	• Mëson akte të ndryshme të ligjërimit dhe të komunikimit në kontekste të ndryshme shoqërore që kanë të bëjnë me statusin shoqëror, gjininë, moshën e nxënësit si dhe me faktorë të tjerë që ndikojnë stilin dhe regjistrat e gjuhës. • Përdor, në situata të ndryshme, lloje të ndryshme shprehjesh, mban qëndrime, besime dhe pikëpamje të ndryshme.

Kompetenca pragmatike	Njeh dhe përdor rregullat dhe parimet sipas të cilave mesazhi komunikues organizohet, strukturohet (zhvillimi i temës, lidhja logjike e ideve, koherenca e mendimeve) dhe realizon funksionet komunikuese (kërkimi i informacionit, dhënia e këshillës, kërkimi për ndihmë, rënia dakord, përshëndetjet etj.).
------------------------------	--

RN-të në përfundimin e arsimit fillor

NIVELI 5 <i>“Demonstrim shumë i mirë i rezultatit të nxënies”</i> <i>Pa kërkuar përpikëri absolute në zotërimin e përbërësve të kompetencës, presim që nxënësi:</i>	
Për kompetencën gjuhësore: <u>Rezultati:</u> - Nxënësi do të demonstrojë një zotërim të fortë të gjuhës angleze, duke përfshirë gramatikën, leksikun dhe drejtshkrimin. <u>Treguesit:</u> - Ndërton fjali të plota dhe të ndërlidhura, duke respektuar rregullat gramatikore. - Përdor një fjalor të pasur, duke zgjedhur fjalët më të përshtatshme për çdo situatë. - Zbaton rregullat e fonetikës dhe të drejtshkrimit në mënyrë konsistente. - Lexon dhe shkruan tekste të ndryshme me rrjedhshmëri dhe saktësi.	
Për kompetencën socio-gjuhësore: <u>Rezultati:</u> - Nxënësi do të jetë në gjendje të komunikojë në mënyrë efektive në situata të ndryshme sociale, duke përshtatur gjuhën dhe stilin e komunikimit në përputhje me kontekstin. <u>Treguesit:</u> - Përdor një gjuhë e një stil të përshtatshëm për të komunikuar me persona të ndryshëm dhe në situata të ndryshme. - Demonstron ndërgjegjësim për normat sociale dhe kulturore të komunikimit. - Merr pjesë në biseda dhe diskutime në mënyrë aktive dhe konstruktive. - Shpreh mendimet dhe ndjenjat e tij në mënyrë qartë dhe të kuptueshme.	
Për kompetencën pragmatike: <u>Rezultati:</u> - Nxënësi do të jetë në gjendje të përdorë gjuhën në mënyrë efektive për të arritur qëllime të ndryshme komunikative. <u>Treguesit:</u> - Strukturon mesazhet e tij në mënyrë logjike dhe koherente. - Përdor strategji të ndryshme komunikative për të kërkuar dhe për të dhënë informacion, për të shprehur mendime dhe për të ndërtuar marrëdhënie. - Përshtat stilin e komunikimit në përputhje me situatën dhe audiencën. - Demonstron aftësi të mira të dëgjimit aktiv dhe të interpretimit të mesazheve të tjerëve.	

Përbërësit e kompetencave specifike që ndërton dhe zbaton nxënësi

Njohuri	Aftësi	Qëndrime
<i>Nxënësi ndihmohet të trajtojë situata që të fitojë njohuri për:</i> Gjuhën dhe gramatikën: - përvetësimi i rregullave gramatikore, fonetike, semantike dhe drejtshkrimore: - kuptimi dhe përdorimi saktë i fjalëve; - zbatimi i rregullave fonetike në shqiptim dhe lexim; - shkrimi saktë dhe përdorimi i shenjave të pikësimit. Komunikimin në kontekste të ndryshme, duke përshtatur gjuhën dhe ligjërimin në: jetën e përditshme: fjalor i lidhur me trupin, ushqimet, lodrat etj.; jetën shkollore: termat lidhur me klasën, lëndët shkollore etj.; jetën personale dhe sociale: familja, shtëpia, pushimet etj.; botën rreth nesh: kafshët, natyra, qytetet, mjetet e transportit etj. botën e komunikimit: mesazhe të shkurtra, kartolina, media sociale, etj. Rregullat e komunikimit: - organizimi dhe strukturimi i mesazheve në mënyrë logjike dhe koherente, duke përfshirë: - komunikimin e folur dhe të shkruar; - kërkimin e informacionit dhe ofrimin e këshillave;	<i>Nxënësi ndihmohet të trajtojë situata që e aftësojnë:</i> Të dëgjojë: - dëgjim aktiv për të kuptuar përmbajtjen e bisedave, instruksioneve dhe materialeve audio; - identifikim i detajeve dhe i mesazheve kryesore. Të flasë: - shprehje e mendimeve dhe e ndjenjave me qartësi dhe koherencë; - përdorim i një fjalori të pasuruar dhe shqiptim i saktë. Të lexojë: - lexim i saktë dhe i rrjedhshëm i teksteve të ndryshme; - kuptim dhe interpretim i përmbajtjeve kryesore; - zhvillim i strategjive, si skanimi, për lexim më efektiv. Të shkruajë: - hartim i teksteve të strukturuar dhe të kuptueshme; - përdorim i rregullave të gramatikës dhe të shkrimit krijues. Të komunikojë: - ndërgjegjësim kulturor për të respektuar diversitetin dhe traditat; - ndërtim i empatisë në ndërveprimet gjuhësore.	<i>Nxënësi ndihmohet të trajtojë situata që të zhvillojë:</i> - vëmendjen dhe respektin në komunikim; - empatinë dhe motivimin për lexim për kënaqësi dhe informim; - respektimin e etikës dhe tolerancën për kulturën dhe gjuhën e tjetrit; - vetëbesimin, vetëvlerësimin dhe vullnetin për të përmbytur detyrat; - përdorimin me etikë të burimeve gjuhësore dhe intelektuale.

- ruajtjen e koherencës dhe përshtatjen e tonit sipas qëllimeve.	Të mendojë në mënyrë kritike, të bashkëpunojë dhe të ndërveprojë: • analiza dhe vlerësimi i informacionit; • bashkëpunimi në projekte grupore dhe ndihma reciproke për zhvillimin e gjuhës.	
--	--	--

9.4. Fusha kurrikulare “Matematikë”

Matematika shtjellohet si fushë dhe si lëndë. Si lëndë, ajo është burim kryesor për zhvillimin intelektual dhe suksesin arsimor të nxënësve. Në AF, fusha ndihmon nxënësin të ndërtojë konceptet e numrave, figurave gjeometrike, trupave gjeometrikë, matjeve dhe të llogaritë e të zgjidhë probleme.

Matematika kërkon **të abstragohet**. Është në dorë e mësuesit t’u referohet objekteve dhe situatave të botës reale, që të orientojë dhe të nxitë nxënësit të shqyrtojnë në mënyrë abstrakte marrëdhëniet midis objekteve ose elementeve të një situate të caktuar.

Veprimtaritë matematike përfshijnë **identifikimin** dhe **zgjidhjen e problemeve**. Procesi i zgjidhjes së situatës problemore është mjet udhëzues që përdoret në shumicën e proceseve të nxënies së matematikës.

Në arsimin fillor, nxënësit zhvillojnë aftësinë për **arsyetim induktiv**. Ata njihen me këtë lloj arsjetimi, kur u kërkohet të nxjerrin rregulla ose ligje në bazë të vëzhgimeve. Ndërkaq, komunikimi me gjuhën matematike ndihmon nxënësit të zbulojnë dhe të përdorin fjalë dhe kuptime të reja për fjalët e njohura. Njëherazi, ata mësojnë të shpjegojnë saktë një procedurë ose një linjë arsjetimi.

Edhe përfshirja e një **përmase historike** në programin e matematikës është mënyrë e shkëlqyer për të përditësuar ndikimin e saj kulturor. Kjo u jep nxënësve mundësinë për të kuptuar evolucionin, kuptimin, dobinë e matematikës, dhe për të zbuluar se shpikja dhe zhvillimi i instrumenteve të caktuara, si vizorja, numërori, raportori dhe kalkulatori, lidheshin drejtpërdrejt ose tërthorazi me nevojat praktike që u shfaqën në shoqëri të ndryshme.

Së fundi, teknologjia mund të jetë një mjet i vlefshëm që t'i ndihmojë nxënësit të kuptojnë dhe të zbatojnë **konceptet** dhe **proceset**, si dhe të kryejnë saktë **detyrat** etj.

Qëllimet

Synimet kryesore të fushës në AF janë:

Rrjedhshmëria në matematikë: Zotërimi i mirë i koncepteve të numrave, llogaritjeve dhe procedurave matematikore.

Arsyetimi matematik: Nxitja e të menduarit logjik, aftësia për të ndjekur linjat e argumentimit dhe për justifikimin e zgjidhjeve.

Zgjidhja e problemeve: Ndërtimi dhe zbatimi i koncepteve matematikore për një sërë problemesh, duke përfshirë kontekste të panjohura dhe të jetës reale.

Përshkrimi i kompetencave specifike që ndërton dhe zbaton nxënësi

Kompetencat specifike	Përshkrimi i kompetencave <i>Kapaciteti/zotësia e nxënësit për të aktivizuar njohuri, aftësi dhe qëndrime me të cilat:</i>
Zgjidh situatën problemore	❖ Identifikon dhe kupton problemin: Njohja e problemit. Të kuptuarit e kontekstit. Interpretimi i informacionit matematik. ❖ Planifikon dhe zhvillon strategji: Formulimi i një plani. Zgjedhja e metodave të përshtatshme. ❖ Zbaton njohuritë matematike: Përdorimi i veprimeve ose i procedurave matematike. Puna me konceptet matematike. Përdorimi i të dhënave. ❖ Arsyeton me logjikë: Analiza e problemit. Zgjidhjet justifikuese. Kontrolli i gabimeve. ❖ Ekzekuton zgjidhjen: Kryerja e llogaritjeve. Përdorimi i mjeteve matematike. ❖ Interpreton/vlerëson zgjidhjen: Interpretimi i rezultateve. Vlerësimi i zgjidhjes. ❖ Komunikon zgjidhjen: Paraqitja dhe reflektimi për procesin e zgjidhjes.
Arsyeton në mënyrë matematike	❖ Kupton/zbaton konceptet matematike: Kuptimi koncepteve. Krijimi i lidhjeve. ❖ Mendon dhe arsyeton në mënyrë induktive: Nxjerrja e përfundimeve logjike. Formulimi i hipotezave. Përdorimi i arsyetimit me kusht. ❖ Arsyeton dhe shpjegon arsyetimin matematik: Sigurimi i provave matematike. Arsyetimi i zgjedhjeve dhe i vendimeve. ❖ Përdor modele dhe paraqitje matematike: Puna me modele. Zgjedhja e paraqitjeve të përshtatshme. ❖ Vlerëson në mënyrë kritike: Vlerësimi i vlefshmërisë së argumenteve. Identifikimi dhe korrigjimi i gabimeve.

Komunikon zgjidhjen e situatës me mjetet e matematikës	❖ Strukturon logjikisht dhe me qartësi: Paraqitja e informacionit në një rend logjik. Qartësia e shpjegimit. ❖ Shpreh marrëdhënie dhe procese: Përshkrimi i marrëdhënieve matematike (p.sh., marrëdhëniet shkallë-pasojë, marrëdhëniet proporcionale etj.). Shpjegimi i zgjidhjes së problemeve. ❖ Komunikon me mjetet e matematikës: Shkrimi i zgjidhjeve matematike. Dokumentimi i procesit të zgjidhjes së problemeve. ❖ Komunikon me gojë dhe me shkrim: Shpjegimi i zgjidhjeve me fjalë. Pjesëmarrja në diskutime matematike. ❖ Përshtat komunikimin me audiencën: Rregullimi i nivelit të vështirësisë dhe të thellësisë së shpjegimeve matematike në varësi të audiencës.
Lidh saktë konceptet matematike	❖ Njih marrëdhëniet ndërmjet koncepteve: Identifikimi i lidhjeve të fushave të ndryshme të matematikës (p.sh.: aritmetika, algjebra, gjeometria, statistikat dhe llogaritja). Kuptimi i strukturave matematike. ❖ Zbaton konceptet matematike: Transferimi i njohurive nga një fushë matematike (p.sh., algjebër) në një tjetër (p.sh., gjeometri) gjatë zgjidhjes së problemeve ose vërtetimit të teoremave. Përdorimi i paraqitjeve të shumfishta (p.sh.: grafike, numerike, algjebrike dhe verbale). ❖ Integron konceptet për zgjidhjen e problemeve: Kombinimi i metodave ose i mjeteve matematike nga fusha të ndryshme (p.sh., kombinimi i ekuacioneve algjebrike me arsyetimin gjeometrik) për zgjidhjen e problemeve komplekse. Ndërtimi i zgjidhjeve që integrojnë ide të shumta matematike. ❖ Lidh koncepte me situatat e botës reale: Lidhja e matematikës me jetën e përditshme (p.sh., si përdoren gjeometria dhe algjebra në arkitekturë ose inxhinieri). Zbatimi i koncepteve në kontekst të botës reale. ❖ Njih modele dhe struktura: Identifikimi i modeleve matematike për të bërë përgjithësime. Njohja e vetive kryesore (p.sh., simetria, raporti) që zbatohen në tema të ndryshme matematike. ❖ Përgjithëson dhe abstragon: Përgjithësimi i koncepteve. Abstraksioni (veçimi i parimeve ose i ideve të përbashkëta nga kontekste të ndryshme matematike dhe lidhja e tyre në një nivel më abstrakt (p.sh., të kuptuarit e konceptit të funksionit si në algjebër, ashtu dhe në llogaritje). ❖ Ndërton mbi njohuritë e mëparshme matematikore: Lidhja e koncepteve të reja me mësimin e mëparshëm. Përdorimi i njohurive të fituara më parë si bazë për të eksploruar dhe për të kuptuar koncepte më komplekse ose të avancuara (p.sh., lidhja e aritmetikës me shprehjet algjebrike). ❖ Komunikon lidhjet: Shpjegimi i marrëdhënieve. Përdorimi i gjuhës matematike.
	❖ Kupto ❖ n kontekstin e problemit: Analiza e situatës. Zgjedhja e informacionit.

Përdor modele për të parashikuar dhe marrë vendime	❖ Formulon modelin matematik: Përcaktimi i ndryshoreve dhe caktimi i simboleve të duhura. Vendosja e marrëdhënieve. Zgjedhja e mjeteve të përshtatshme matematike. ❖ Thjeshton supozimet: Bërja e supozimeve thjeshtuese për situatën e botës reale. Kuptimi i kufizimeve. ❖ Zgjedh modelin matematik: Kryerja e llogaritjeve. Gjetja e zgjidhjeve. ❖ Interpreton rezultate matematike: Përkthimi i rezultateve në kontekstin e botës reale. Vlerësimi i modelit. ❖ Rregullon modelin: Rishikimi i modelit. Përsëritja e procesit. ❖ Përdor grafikë dhe paraqitje vizuale: Krijimi i modeleve vizuale. Interpretimi i grafikëve. ❖ Vlerëson efektivitetin e modelit: Testimi i saktësisë së modelit. Vlerësimi i zbatimit të modelit. ❖ Shpjegon modelin: Paraqitja e rezultateve: Komunikimi i rezultateve. ❖ Vlerëson realizimin praktik: Vlerësimi nëse parashikimet e modelit janë të realizueshme, veçanërisht kur kemi të bëjmë me zbatime të botës reale.
Përdor teknologjinë për të mësuar matematikën	❖ Përzgjedh mjete të përshtatshme teknologjike: Identifikimi i mjeteve përkatëse. Eksplorimi i platformave të ndryshme. ❖ Përdor teknologji për zgjidhjen e problemeve: Kryerja e llogaritjeve. Automatizimi i proceseve. ❖ Vizualizon konceptet matematike: Përdorimi i kalkulatorëve grafikë ose softuerëve për të vizualizuar funksionet, ekuacionet dhe figurat gjeometrike. ❖ Mëson dhe eksploron: Angazhimi me mjete ndërvepruese. Pjesëmarrja në mjediset virtuale të matematikës. ❖ Eksploron zgjidhje të shumta: Eksplorimi i qasjeve duke përdorur mjete të ndryshme teknologjike, duke ndihmuar arsyetimin më të thellë matematikor. ❖ Mëson përmes burimeve në internet: Përdorimi i materialeve mësimore digjitale. Bashkëpunimi në komunitetet e të mësuarit në internet. ❖ Përfshihet dhe motivohet: Përdorimi i lojërave edukative. Përdorimi i platformave që përmbajnë elemente të nxënies së bazuar në lojë (p.sh., shpërblimet, nivelet) për të ndihmuar interesin për të mësuar matematikën. ❖ Zhvillon të menduarin kompjuterik: Përdorimi i gjuhëve të programimit ose i platformave të kodimit për të shkruar algoritme ose programe të thjeshta. ❖ Punon me softuerin matematik.

RN-të në përfundimin e arsimit fillor

NIVELI 5 <i>“Demonstrim shumë i mirë i rezultatit të nxënies”</i> <i>Pa kërkuar përpikëri absolute në zotërimin e përbërësve të kompetencës, presim që nxënësi:</i>
--

Zgjidhja e problemeve matematike:

Rezultati:

- Nxënësi do të jetë në gjendje të identifikojë, të analizojë dhe të zgjidhë probleme matematike të paraqitura në kontekste të ndryshme (reale ose abstrakte).

Treguesit:

- Zbatimi i strategjive të ndryshme (vizatime, modelime, ekuacione) për të gjetur zgjidhje të problemeve.
- Verifikimi në mënyrë sistematike i saktësisë së zgjidhjeve të tij.
- Arsyetimi i hapave të zgjidhjes në mënyrë logjike dhe të qartë.

Arsyetimi matematik:

Rezultati:

- Nxënësi do të jetë në gjendje të shpjegojë dhe të justifikojë zgjidhjet e tij duke përdorur koncept matematike.

Treguesit:

- Lidhja e koncepteve matematike me situata të jetës së përditshme.
- Përdorimi i një gjuhe matematike të saktë dhe të qartë për të shpjeguar idetë e tij.
- Justifikimi i zgjidhjeve të bëra duke argumentuar në bazë të provave.

Komunikimi matematik:

Rezultati:

- Nxënësi do të jetë në gjendje të komunikojë ide matematike në mënyrë efektive, duke përdorur një gjuhë dhe simbole të përshtatshme.

Treguesit:

- Shkrimi dhe leximi me kuptim i teksteve matematike.
- Përdorimi i një terminologjie matematike të saktë.
- Përdorimi i vizatimeve, diagrameve dhe modeleve për të përfaqësuar ide matematike.

Lidhjet midis koncepteve matematike:

Rezultati:

- Nxënësi do të jetë në gjendje të lidhë koncepte matematike dhe të shprehet për lidhjet midis tyre.

Treguesit:

- Identifikimi i modeleve dhe i marrëdhënieve midis koncepteve.
- Zbatimi i njohurive të fituara në një fushë të matematikës për të zgjidhur probleme në fusha të tjera.
- Përdorimi i strategjive të ndryshme për të zgjidhur probleme komplekse.

Modelimi matematik:

Rezultati:

- Nxënësi do të jetë në gjendje të krijojë modele matematike për të përfaqësuar situata reale.

Treguesit:

- Përkthimi i situatave reale në modele matematike.
- Interpretimi i rezultateve të modeleve në kontekstin e problemit origjinal.
- Përdorimi i modeleve për të parashikuar dhe për të marrë vendime.

Përdorimi i teknologjisë:

Rezultati:

- Nxënësi do të jetë në gjendje të përdorë teknologjinë për të mbështetur të mësuarit dhe zgjidhjen e problemeve matematike.

Treguesit:

- Zgjedhja dhe përdorimi i mjeteve teknologjike të përshtatshme për të zgjidhur probleme.
- Interpretimi i rezultateve të dhëna nga teknologjia.
- Vlerësimi i efektivitetit të përdorimit të teknologjisë në zgjidhjen e problemeve.

Përbërësit e kompetencave specifike që ndërton dhe zbaton nxënësi

Njohuri	Aftësi	Qëndrime
<i>Nxënësi ndihmohet të trajtojë situata që të fitojë njohuri për:</i> Numra dhe operacione • Vlera e shifrave në një numër. • Mbledhje dhe zbritje me shkrim dhe me mend. • Numrat deri në 10,000,000. • Zbatimi i katër operacioneve në probleme komplekse. Thyesat, numrat dhjetorë dhe përqindjet • Njohja e thyesave si pjesë e tërësisë. • Thyesat e barasvlershme për emërues të thjeshtë. • Konvertimi midis thyesave, decimalëve dhe përqindjeve. • Përdorimi i përqindjeve në kontekste reale. Matja • Përdorimi i njësive të zakonshme për gjatësinë, masën dhe kapacitetin. • Matja e perimetrit. Algjebra • Përdorimi i shprehjeve algjebrike për të zgjidhur ekuacione të thjeshta.	<i>Nxënësi ndihmohet të trajtojë situata që e aftësojnë për:</i> • Kryerjen e operacioneve bazë me saktësi dhe shpejtësi. • Zgjidhjen e problemeve matematike në situata të ndryshme, duke përdorur strategji të ndryshme dhe duke kontrolluar saktësinë e rezultateve. • Përdorimin e logjikës në analizën dhe zgjidhjen e problemeve. • Interpretimin e tabelave, diagrameve dhe grafikëve për përfaqësimin e të dhënave. • Përdorimin e koncepteve të gjeometrisë për figura dhe objekte në hapësirë. • Matjet: gjatësia, perimetri, sipërfaqja dhe vëllimi me njësitë përkatëse. • Zgjidhjen e ekuacioneve dhe të shprehjeve algjebrike, si dhe punën me ndryshore dhe konstante. • Analizën dhe interpretimin e të dhënave statistikore dhe aplikimin e probabilitetit në	<i>Nxënësi ndihmohet të trajtojë situata që të zhvillojë:</i> • Kuriozitet dhe motivim për të studiuar matematikën. • Vetëvlerësim dhe besim në aftësitë e tij. • Saktësi dhe respekt për përpjekjet vetjake dhe grupore. • Besim në përdorimin e teknologjisë dhe vlerësimin e rolit të matematikës në jetën personale dhe shoqërore. • Konstruktivitet në kritikë dhe qasje pozitive ndaj mësimit dhe bashkëpunimit.

- Identifikimi i rregullave dhe i modeleve numerike. Gjeometria - Njohja e formave 2D dhe 3D dhe projektimi i tyre në 2D. - Përdorimi i koordinatave në të katër kuadratet. Statistika - Mesatarja aritmetike. - Interpretimi i të dhënave nga tabela dhe diagrame.	parashikimin e ngjarjeve. Komunikimin e ideve dhe të zgjidhjeve matematike qartë e saktë dhe diskutimin për to.	
---	---	--

9.5. Fusha kurrikulare “Shkencat e natyrës”

Në AF-në, fusha përfshin lëndën “Dituri e natyrës”.

Qëllimet e fushës / lëndës

Disa nga qëllimet kryesore janë:

1. Zhvillimi i mendimit kritik dhe analitik

Zgjidhja e problemeve: Dituri natyre ndihmon nxënësit të zhvillojnë aftësitë e mendimit kritik dhe analitik, duke u mësuar atyre të identifikojnë dhe të zgjidhin probleme të ndryshme natyrore dhe shkencore.

Eksperimentimi dhe hulumtimi: Nxënësit mësojnë të kryejnë eksperimente të thjeshta dhe të hulumtojnë për pyetje dhe dukuri shkencore, duke zhvilluar kështu aftësitë e tyre të kërkimit dhe të mendimit të pavarur.

2. Kuptimi i botës natyrore

Njohuritë për natyrën: Lënda ndihmon nxënësit të fitojnë njohuri të thelluara për botën natyrore, duke përfshirë konceptet bazë të biologjisë, kimisë, dhe fizikës.

Ndërlidhja e koncepteve: Përmes lëndës, nxënësit kuptojnë lidhjet midis dukurive natyrore dhe ndërveprimet midis mjedisit dhe organizmave të gjallë.

3. Edukimi për mjedisin

Ndërgjegjësimi mjedisor: Dituri natyre luan rol kyç në ndërgjegjësimin e nxënësve për çështjet mjedisore, duke i mësuar ata të vlerësojnë dhe të mbrojnë mjedisin.

Përfshirja në veprimtaritë mjedisore: Nxënësit nxiten të marrin pjesë në veprimtari praktike që lidhen me mbrojtjen e mjedisit, si mbjellja e pemëve ose pastrimi i zonave të gjelbra.

4. Zhvillimi i aftësive sociale dhe bashkëpunuese

Punët në grup: Lënda shpesh përfshin veprimtari bashkëpunuese, ku nxënësit punojnë së bashku për të realizuar projekte të ndryshme shkencore.

Komunikimi efektiv: Përmes diskutimeve dhe prezantimeve, nxënësit zhvillojnë aftësitë e tyre të komunikimit dhe mësojnë të punojnë në mënyrë efektive me të tjerët.

5. Nxitja e kuriozitetit dhe krijimtarisë

Eksplorimi dhe eksperimentimi: Nxënësit nxiten të eksplorojnë botën rreth tyre dhe të zhvillojnë teoritë e tyre për dukuritë natyrore.

Krijimtaria shkencore: Lënda ndihmon në zhvillimin e krijimtarisë së nxënësve duke i nxitur të mendojnë dhe të gjejnë zgjidhje të reja për problemet shkencore.

6. Vendosja e bazës për edukimin e mëtijshëm

Bazat shkencore: Lënda "Dituri natyre" siguron bazat e nevojshme shkencore për edukimin e mëtijshëm në nivele më të larta të arsimit.

Interesi për shkencën: Nxënësit që zhvillojnë interes për shkencën dhe teknologjinë në klasat fillore, priren të ndjekin karriera shkencore në të ardhmen.

Kompetencat specifike që zhvillon nxënësi në "Dituri natyre"

I gjithë procesi i të nxënësve në fushën e shkencave në APU ka në fokus zhvillimin e njohurive dhe të aftësive për kërkimin shkencor, çka mundësohet kur nxënësit ndihmohen të ndërtojnë dhe të përdorin tri kompetenca specifike, të njëjta në të gjitha nivelet arsimore:

- Identifikimi i problemeve dhe zgjidhja e tyre.
- Përdorimi i mjeteve, objekteve dhe procedurave shkencore.
- Komunikimi në gjuhën dhe terminologjinë e shkencës.

Përshkrimi i kompetencave specifike që ndërton dhe zbaton nxënësi

Kompetencat specifike	Përshkrimi i kompetencave <i>Kapaciteti/zotësia e nxënësit për të aktivizuar njohuri, aftësi dhe qëndrime me të cilat:</i>
-----------------------	---

KURRIKULA BËRTHAMË E ARSIMIT FILLOR (E PËRDITËSUAR)

Identifikon dhe zgjidh probleme	• njeh dhe përcakton problemin; • mbledh dhe analizon informacion; • formulon hipoteza; • analizon dhe interpreton rezultatet; • zhvillon zgjidhje; • komunikon gjetje dhe zgjidhje; • vlerëson procesin dhe rezultatet; • njeh implikimet etike dhe mjedisore; • bashkëpunon në zgjidhjen e problemeve.
Përdor mjete, objekte dhe procedura shkencore	- identifikon, zgjedh dhe përdor mjete të përshtatshme; - trajton objekte dhe materiale shkencore; - kupton dhe zbaton procedurat shkencore; - kupton hipotezën dhe eksperimentin; - kupton terminologjinë dhe simbole shkencore; - planifikon dhe kryen eksperimente; - përdor saktë instrumentet matëse; - mbledh, regjistron dhe analizon të dhënat; - vëzhgon dhe dokumenton vëzhgimin; - shkuan dhe prezanton raporte; - bashkëpunon në përdorimin e mjeteve dhe të procedurave; - integron teknologjinë digjitale.
Komunikon me gjuhën dhe terminologjinë e shkencave natyrore	▪ kupton gjuhën dhe terminologjinë shkencore; ▪ përdor simbole dhe shënime shkencore; ▪ komunikon vëzhgimet dhe gjetjet; ▪ ndërton dhe analizon argumentet shkencore; ▪ përdor paraqitje vizuale; ▪ përfshihet në diskursin shkencor; ▪ shkruan tekste shkencore; ▪ përdor teknologjinë për komunikim; ▪ përçon konceptet për audienca të ndryshme; ▪ reflekton mbi komunikimin; ▪ demonstroi komunikim etik.

RN-të në përfundimin e arsimit fillor

NIVELI 5 <i>“Demonstrim shumë i mirë i rezultatit të nxënies”</i> <i>Pa kërkuar përpikëri absolute në zotërimin e përbërësve të kompetencës, presim që nxënësi:</i>
--

1. Identifikon dhe zgjidh probleme:

Rezultati:

- Nxënësi do të demonstrojë aftësi në zgjidhjen e problemeve, duke përdorur një proces sistematik dhe duke komunikuar me efektivitet zgjidhjet e tij.

Treguesit:

Formulimi i problemit:

- Identifikon qartë problemet nga situata të ndryshme.
- Formulon pyetje të hollësishme për të eksploruar shkaqet e problemit.

Planifikimi i zgjidhjes:

- Mbledh informacion të përshtatshëm për të kuptuar problemin më mirë.
- Zhvillon hipoteza të mundshme për zgjidhje.
- Krijon një plan të hollësishëm për të testuar këto hipoteza.

Ekzekutimi i planit:

- Zbaton planin e veprimit në mënyrë sistematike.
- Regjistron të dhënat në mënyrë të organizuar.
- Modifikon planin, nëse është e nevojshme.

Analiza e rezultateve:

- Krahason rezultatet me hipotezat fillestare.
- Identifikon modele dhe tendenca në të dhëna.
- Vlerëson efektivitetin e zgjidhjes së propozuar.

Komunikimi i zgjidhjes:

- Prezanton zgjidhjen në mënyrë të qartë dhe bindëse.
- Përdor një gjuhë të përshtatshme për audiencën.
- Mbron zgjidhjen e tij, duke përdorur prova.

2. Përdor mjete, pajisje dhe procedura shkencore:

Rezultati:

- Nxënësi do të demonstrojë aftësi të forta në përdorimin e mjeteve dhe të procedurave shkencore për të kryer eksperimente, për të mbledhur dhe për të analizuar të dhëna, dhe për të komunikuar rezultatet në mënyrë efektive.

Treguesit:

Planifikimi dhe ekzekutimi i eksperimenteve:

- Krijon një plan eksperimental të hollësishëm, duke përfshirë hipotezën, ndryshoret dhe procedurat.
- Përdor mjete dhe pajisje shkencore në mënyrë të sigurt dhe efektive për të mbledhur të dhëna.
- Dokumenton me kujdes të gjitha vëzhgimet dhe rezultatet.

Analiza e të dhënave:

- Organizon të dhënat në tabela, grafikë ose forma të tjera pamore.
- Analizon të dhënat për të identifikuar modelet dhe tendencat.
- Krahason rezultatet me hipotezën fillestare.

Komunikimi i rezultateve:

- Shkruan raporte shkencore të qarta dhe të organizuara, duke përdorur gjuhë shkencore të saktë.

- Krijon paraqitje vizuale (postera, prezantime) për të komunikuar gjetjet në mënyrë efektive.
- Përdor softuerë për të analizuar dhe për të paraqitur të dhënat në mënyrë profesionale.

Siguria në laborator:

- Zbaton rregullat e sigurisë në laborator në çdo kohë.
- Menaxhon në mënyrë të sigurt materialet dhe pajisjet e laboratorit.

3. Komunikon me gjuhën dhe terminologjinë e shkencës:

Rezultati:

- Nxënësi do të demonstrojë aftësi të shkëlqyera në komunikimin shkencor, duke përdorur një gjuhë të saktë dhe terminologji të përshtatshme për të shpjeguar koncepte, rezultate dhe ide shkencore.

Treguesit:

Përdorimi i terminologjisë shkencore:

- Përdor terminologjinë shkencore në mënyrë konsistente dhe të saktë në të gjitha format e komunikimit shkencor (shkrim, fjalim, vizualizime).
- Përkufizon dhe shpjegon termat shkencorë në një mënyrë të qartë dhe të kuptueshme për të tjerët.

Komunikimi me shkrim:

- Shkruan raporte shkencore të strukturuar dhe të hollësishme, duke përfshirë një hyrje, metodë, rezultate, diskutim dhe përfundim.
- Përdor një stil të shkrimit të qartë, konciz dhe objektiv.
- Citon burimet e informacionit në mënyrë të përshtatshme.

Komunikimi me gojë:

- Prezanton gjetjet shkencore në mënyrë efektive dhe me besim në paraqitje orale dhe diskutime.
- Përgjigjet në mënyrë të qartë dhe të plotë për pyetjet në lidhje me punën e tij.
- Përdor mjete pamore për të përforcuar komunikimin.

Komunikimi me simbole:

- Krijon vizualizime të qarta dhe informuese (grafika, tabela, diagrame) për të përfaqësuar të dhënat.
- Përdor softuerë për të krijuar paraqitje të mira.

Bashkëpunimi dhe reagimi:

- Merr pjesë në diskutime shkencore, duke shkëmbyer ide dhe duke dhënë reagim konstruktiv.
- Punon mirë në grup për të komunikuar rezultatet e një projekti.
- Kërkon reagim nga të tjerët për të përmirësuar komunikimin e tij.

Përbërësit e kompetencave specifike që ndërton dhe zbaton nxënësi

Njohuri	Aftësi	Qëndrime
<i>Nxënësi ndihmohet të trajtojë situata që të fitojë njohuri për:</i> • Gjallesat: shumëllojshmërinë, klasifikimin, strukturën dhe funksionet e organizmave, ndërvaresinë mes tyre,	<i>Nxënësi ndihmohet të trajtojë situata që e aftësojnë:</i> • të formulojë hipoteza dhe të parashikojë rezultate; • të vëzhgojë dukuri dhe të përdorë aparatet e pajisjet;	<i>Nxënësi ndihmohet të trajtojë situata që të zhvillojë:</i> • Kuriozitetin për të eksploruar botën përreth. • Krijimtarinë në zgjidhjen e problemeve dhe

trashëgiminë dhe evolucionin. • Dukuritë fizike: forcat dhe lëvizjen, elektricitetin, magnetizmin, tingullin, dritën dhe përhapjen e saj. • Tokën dhe hapësirën: shkëmbinjtë, atmosferën dhe universin. • Materialet: llojet, vetitë dhe përdorimin e tyre.	• të krahasojë dhe të klasifikojë informacionin dhe objektet sipas karakteristikave; • të analizojë, të interpretojë dhe të shpjegojë të dhënat dhe dukuritë natyrore. • të vlerësojë dhe të komunikojë ide dhe zgjidhje në mënyrë të qartë.	eksperimentimin. • Objektivitetin dhe integritetin në analizën e rezultateve. • Mendje të hapur dhe këmbëngulje për të mësuar dhe për të përballuar sfidat. • Përgjegjshmëri ndaj mjedisit dhe shoqërisë.
---	---	---

9.6. Fusha kurrikulare “Shkencat shoqërore”

Fusha përfshin lëndët “Qytetari” dhe “Histori”.

Qëllimet e fushës

Fusha synon që nxënësit:

- ❖ të bëhen qytetarë aktivë dhe të përgjegjshëm në kontekstet lokal, kombëtar, rajonal, europian e global, duke ndërtuar identitetin individual dhe kolektiv përmes njohjes së trashëgimisë historike të përbashkët;
- ❖ të zhvillojnë vlerat themelore të qytetarisë, si: toleranca, mirëkuptimi, të drejtat e njeriut dhe demokracia;
- ❖ të kuptojnë ligjshmërinë, proceset politike, ekonomike, shoqërore, kulturore dhe çështjet që lidhen me to përmes studimit të përvojave njerëzore;
- ❖ të kuptojnë zhvillimin e personalitetit të tyre, mënyrën si ngjasojnë dhe si diferencohen nga të tjerët në raport me kohën dhe me hapësirën, të dallojnë diferencën midis supozimit dhe faktit, të kuptojnë kompleksitetin e çështjes historike, të mos besojnë në përgjigjen e paargumentuar dhe të respektojnë përpikërinë e burimeve historike;
- ❖ të zhvillojnë këndvështrimin hapësinor për botën, kompleksitetin dhe ndërvarësinë ndërmjet aspekteve fizike dhe humane të rajoneve e vendeve në botë;
- ❖ të përdorin TIK-un për të kërkuar informacion për të shkuarën në lidhje me datat, personazhet, objektet, ngjarjet dhe proceset historike, si dhe për të përzgjedhur, klasifikuar, organizuar dhe paraqitur gjetjet;
- ❖ të vlerësojnë pasojat e ndërveprimit të shoqërisë me mjedisin për të ndërmarrë veprime që mbështesin zhvillimin e qëndrueshëm;

- ❖ të zotërojnë aftësinë e kërimit, interpretimit, organizimit të njohurive dhe të komunikimit të tyre në mënyra të ndryshme.

9.6.1. Lënda “Qytetari”

Përmes lëndës “Qytetari”, nxënësit ndërtojnë njohuri, aftësi dhe qëndrime që i ndihmojnë të bëhen qytetarë të përgjegjshëm dhe aktivë në shoqëri. Ky formim përqendrohet në zhvillimin e kompetencave kyç që lidhen me shtetësinë, etikën dhe pjesëmarrjen sociale.

Përshkrimi i kompetencave specifike që ndërton nxënësi

Kompetencat specifike	Përshkrimi i kompetencave <i>Kapaciteti/zotësia e nxënësit për të aktivizuar njohuri, shkathtësi dhe qëndrime me të cilat:</i>
Kompetenca demokratike dhe qytetare	• kupton parimet demokratike; • merr pjesë aktivisht në jetën shoqërore; • diskuton dhe dialogon si qytetar; • përfshihet në komunitet; • promovon drejtësinë dhe përfshirjen sociale; • kupton qytetarinë globale; • promovon vlerat demokratike; • zhvillon shkathtësi drejtuese dhe praktika reflektuese; • përdor mjete digjitale për angazhim qytetar.
Kompetenca për zgjidhjen e konflikteve	- kupton konfliktin; - dëgjon me vëmendje; - njeh dhe menaxhon emocionet; - zgjidh probleme; - komunikon efektivisht; - negocion dhe ndërmjetëson; - ndërton marrëdhënie dhe demonstroi reflektim; - respekton konsideratat etike.
Kompetenca etike dhe morale	▪ kupton parimet etike; ▪ njeh çështjet etike; ▪ merr vendime etike; ▪ shfaq sjellje etike; ▪ tregon empati dhe dhembshuri; ▪ përfshihet në diskutime etike; ▪ zbaton standarde etike; ▪ reflekton për vlerat vetjake; ▪ avokon për drejtësi sociale; ▪ promovon praktika etike në teknologji;

KURRIKULA BËRTHAMË E ARSIMIT FILLOR (E PËRDITËSUAR)

	▪ përgjigjet ndaj komunitetit.
Kompetenca sociale dhe ndërpersonale	- komunikon efektivisht; - bashkëpunon dhe punon në grup; - zgjidh konfliktet dhe ndërton marrëdhënie; - përshtatet, është fleksibël dhe ndikon tek të tjerët; - ofron mbështetje dhe reagime; - sillet me etikë dhe vetërregullohet.
Kompetenca për të drejtat e njeriut dhe diversitetin	• njeh të drejtat e njeriut; • ndërgjegjësohet për diversitetin; • ndien dhe respekton veten dhe të tjerët; • mendon në mënyrë kritike; • avokon dhe vepron; • bashkëpunon dhe përfshihet në komunitetet; • kupton dhe respekton shtetësinë globale.
Kompetenca për zhvillim të qëndrueshëm	- njeh zhvillimin e qëndrueshëm; - shfaq ndërgjegjësim mjedisor; - demonstroi përgjegjësi sociale; - merr arsimim ekonomik; - mendon në mënyrë kritike dhe zgjidh probleme; - bashkëpunon dhe përfshihet; - është novator dhe krijues; - mëson gjatë gjithë jetës.

RN-të në përfundimin e arsimit fillor

NIVELI 5 “Demonstrim shumë i mirë i rezultatit të nxënies” <i>Pa kërkuar përpikëri absolute në zotërimin e përbërësve të kompetencës, presim që:</i>	
Për kompetencën demokratike dhe qytetare: Kupton parimet demokratike: - <u>Rezultati</u>: Nxënësi përshkruan parimet themelore të demokracisë, si: barazia, drejtësia dhe pjesëmarrja. - <u>Treguesi</u>: Prezantimi i shembujve të situatave të jetës reale që ilustrojnë këto parime. Merr pjesë aktivisht në jetën shoqërore: - <u>Rezultati</u>: Nxënësi përfshihet në veprimtari komunitare, si projekte shoqërore ose grupe diskutimi. - <u>Treguesi</u>: Pjesëmarrja në një veprimtari të komunitetit ose të shkollës. Për kompetencën e zgjidhjes së konflikteve: Kupton konfliktin: - <u>Rezultati</u>: Nxënësi përshkruan lloje të ndryshme të konflikteve dhe arsytet e tyre.	

- **Treguesi:** Ndërtimi i skenarëve të thjeshtë për të ilustruar shkaqet e konflikteve dhe mënyrat e zgjidhjes.

Komunikon efektivisht:

- **Rezultati:** Nxënësi demonstroi aftësi komunikimi në situata konflikti.
- **Treguesi:** Lojë me role me moshatarët për zgjidhjen e konflikteve.

Për kompetencën etike dhe morale:

Kupton parimet etike:

- **Rezultati:** Nxënësi njeh parimet etike bazë, si: ndershmëria, drejtësia dhe respekti.
- **Treguesi:** Përdorimi i etikës për të diskutuar situata reale ose hipotetike në klasë.

Shfaq sjellje etike:

- **Rezultati:** Nxënësi demonstroi sjellje etike në marrëdhëniet e përditshme.
- **Treguesi:** Reflektimi përmes ditarëve ose eseve për sjelljet vetjake dhe të tjerëve.

Për kompetencën sociale dhe ndërpersonale:

Komunikon efektivisht:

- **Rezultati:** Nxënësi përdor shkathtësi të qarta dhe të sakta komunikimi në biseda dhe diskutime.
- **Treguesi:** Diskutime grupore dhe prezantime.

Bashkëpunon dhe punon në grup:

- **Rezultati:** Nxënësi punon në mënyrë efektive me të tjerët në projekte grupore.
- **Treguesi:** Projekte grupore dhe vlerësim i kontributeve individuale.

Për kompetencën për të drejtat e njeriut dhe diversitetin:

Njeh të drejtat e njeriut:

- **Rezultati:** Nxënësi identifikon dhe përshkruan të drejtat themelore të njeriut.
- **Treguesi:** Prezantime ose postera që përshkruajnë të drejtat e njeriut.

Ndërgjegjësohet për diversitetin:

- **Rezultati:** Nxënësi demonstroi ndërgjegjësim dhe respekt për diversitetin kulturor dhe social.
- **Treguesi:** Pjesëmarrja në veprimtari që promovojnë ndërgjegjësimin për diversitetin.

Për kompetencën për zhvillim të qëndrueshëm:

Njeh zhvillimin e qëndrueshëm:

- **Rezultati:** Nxënësi përshkruan konceptet bazë të zhvillimit të qëndrueshëm.
- **Treguesi:** Projekte të vogla që synojnë ruajtjen e mjedisit.

Demonstroi përgjegjësi sociale:

- **Rezultati:** Nxënësi merr pjesë në veprimtari që promovojnë përgjegjësinë sociale dhe mjedisore.
- **Treguesi:** Organizimi dhe zbatimi i projekteve të vogla për mbrojtjen e mjedisit ose ndihmën komunitare.

Përbërësit e kompetencave specifike që ndërton dhe zbaton nxënësi

Kompetenca specifike	Njohuri	Shkathtësi	Qëndrime
----------------------	---------	------------	----------

KURRIKULA BËRTHAMË E ARSIMIT FILLOR (E PËRDITËSUAR)

Kompetenca demokratike dhe qytetare	<i>Nxënësi ndihmohet të trajtojë situata që të fitojë njohuri për:</i> • Parimet e demokracisë: barazia, drejtësia, pjesëmarrja. • Strukturat dhe funksionet e qeverisjes dhe të institucioneve shoqërore. • Të drejtat dhe detyrimet e qytetarëve.	<i>Nxënësi ndihmohet të trajtojë situata që e shkathtësojnë:</i> ❖ Ndërtimi dhe zbatimi i projekteve komunitare. ❖ Organizimi dhe pjesëmarrja aktive në diskutime dhe debate. ❖ Përdorimi i mjeteve digjitale për përfshirjen qytetare dhe komunikimin.	<i>Nxënësi ndihmohet të trajtojë situata që nxitin:</i> ▪ Angazhim për drejtësi dhe barazi. ▪ Ndërgjegjësim dhe përgjegjësi qytetare. ▪ Respekt për mendimet dhe pikëpamjet e të tjerëve.
Kompetenca për zgjidhjen e konflikteve	• Llojet e konflikteve dhe shkaqet e tyre. • Strategjitë dhe teknikat për zgjidhjen e konflikteve.	❖ Identifikimi dhe analiza e konflikteve. ❖ Komunikimi efektiv dhe dëgjimi aktiv. ❖ Ndërtimi i skenarëve dhe i roleve për zgjidhjen e konflikteve.	▪ Empati dhe mirëkuptim. ▪ Disiplinë dhe respekt për të tjerët. ▪ Ndërgjegjësim për ndikimin e emocioneve në konflikte.
Kompetenca etike dhe morale	• Parimet etike bazë: ndershmëria, drejtësia, respekti. • Çështjet etike dhe dilemat morale.	❖ Analiza dhe diskutimi i çështjeve etike. ❖ Reflektimi për sjelljet vetjake dhe të të tjerëve. ❖ Zbatimi i parimeve etike në situata reale.	▪ Ndërgjegjësim etik dhe moral. ▪ Respekt për standardet etike. ▪ Përfshirje për drejtësi sociale dhe sjellje etike.
Kompetenca sociale dhe ndërpersonale	• Rregullat e komunikimit efektiv dhe të bashkëpunimit. • Strategjitë për ndërtimin e marrëdhënieve të shëndetshme.	❖ Përdorimi i shkathtësive të komunikimit në situata të ndryshme. ❖ Puna në grup dhe bashkëpunimi në projekte. ❖ Ndërtimi dhe menaxhimi i marrëdhënieve ndërpersonale.	▪ Respekt për të tjerët dhe për mendimet e tyre. ▪ Ndërgjegjësim për rolin e bashkëpunimit në suksesin e grupit. ▪ Disiplinë personale dhe përgjegjësi shoqërore.
Kompetenca për të drejtat e njeriut dhe diversitetin	• Të drejtat themelore të njeriut. • Diversiteti kulturor dhe social.	❖ Identifikimi dhe përshkrimi i të drejtave të njeriut. ❖ Pjesëmarrja në veprimtari që promovojnë ndërgjegjësimin për diversitetin.	▪ Respekt për diversitetin kulturor dhe social. ▪ Ndërgjegjësim për rëndësinë e të drejtave të njeriut. ▪ Përkushtim për promovimin e diversitetit dhe të barazisë.

Kompetenca për zhvillim të qëndrueshëm	- Konceptet bazë të zhvillimit të qëndrueshëm. - Praktikat mjedisore dhe përgjegjësia sociale.	- Përshkrimi dhe zbatimi i praktikave të qëndrueshme. - Organizimi dhe zbatimi i projekteve mjedisore dhe sociale.	- Ndërgjegjësim për përgjegjësinë ndaj mjedisit. - Përfshirje për ruajtjen e mjedisit dhe për zhvillimin e qëndrueshëm.
---	---	---	--

9.6.2. Lënda “Histori”

Lënda e historisë në klasat IV dhe V ka në qendër historinë personale e familjare, historinë lokale, historinë e lindjes dhe të zhvillimit të shoqërive të para njerëzore, trajtimin e ngjarjeve dhe të figurave më të rëndësishme të historisë së shqiptarëve dhe më gjerë. Për më tepër, lënda e historisë krijon mundësi që nxënësit të nisin të ndërtojnë themelet për edukimin qytetar, duke i ndihmuar ata të kuptojnë të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre në shoqëri. Njohuritë dhe aftësitë që nxënësit i ndërtojnë nëpërmjet mësimave të kësaj lënde, i shërbejnë ndërtimit të kompetencave specifike dhe kompetencave kyç, me synim kultivimin e identitetit personal, kombëtar e kulturor.

Qëllimet e lëndës

Disa qëllime kryesore:

- Vetëdija historike:** Kuptimi i rëndësisë së ngjarjeve dhe të personazheve historike.
- Zhvillimi i kureshtjes dhe i aftësive për të menduar në mënyrë kritike** për të kaluarën dhe ndikimin e saj në të tashmen.
- Identiteti kulturor dhe kombëtar** duke njohur historinë dhe trashëgiminë.
- Komunikimi i njohurive historike:** Nxitja e nxënësve që të komunikojnë në mënyrë efektive të kuptuarit e ngjarjeve historike, me gojë dhe me shkrim, duke përdorur terminologjinë e duhur.

Përshkrimi i kompetencave specifike që ndërton nxënësi

Kompetenca specifike	Përshkrimi i kompetencave <i>Kapaciteti/zotësia e nxënësit për të aktivizuar njohuri, aftësi dhe qëndrime me të cilat:</i>
Kërkon të njohë historinë	- harton dhe përmirëson pyetjet e tij për të strukturuar hipotezat, për përzgjedhjen dhe dhënien e fakteve për të nxjerrë dhe për të justifikuar përfundimet që arrin; - sugjeron hipoteza bazuar në supozimet dhe në vlerat e tyre të cilat më pas i teston kundrejt provave.

KURRIKULA BËRTHAMË E ARSIMIT FILLOR (E PËRDITËSUAR)

Përdor burime	- vlerëson vlerën dhe besueshmërinë e dëshmive, duke studiuar prejardhjen e qëllimeve dhe gjuhën e burimeve.
Analizon lidhjet shkak-pasojë	- identifikon dhe vlerëson rëndësinë relative të faktorëve të ndryshëm, bën lidhje shpjeguese ndërmjet shkakut dhe pasojës, duke pasur parasysh marrëdhënien ndërmjet argumenteve shkakësore, dëshmive dhe interpretimeve.
Interpreton ngjarjet historike	- interpreton të kaluarën në mënyra të ndryshme, duke përfshirë fotografi, shfaqje, filma, tregime, muze etj.; - bën interpretime duke reflektuar rrethanat në të cilat ato bëhen, dëshmitë në dispozicion, si dhe synimet e atyre që i bëjnë këto interpretime (p.sh.: shkrimtarë, arkeologë, historianë dhe film krijues).
Shpjegon dhe komunikon për të shkuarën	- zhvillon dëgjimin, leximin dhe shkrimin si aftësi për të kujtuar, për të përzgjedhur, për të klasifikuar dhe për të organizuar informacionin historik; - përdor me saktësi terminologjinë historike për përshkrimin dhe për shpjegimin e ngjarjeve në të shkuarën.

RN-të në përfundimin e arsimit fillor

NIVELI 5 "Demonstrim shumë i mirë i rezultatit të nxënies" <i>Pa kërkuar përpikëri absolute në zotërimin e përbërësve të kompetencës, presim që nxënësi:</i>	
1. Kërkon të njohë historinë	Rezultati: - Nxënësi do të demonstrojë interes dhe kuriozitet për të mësuar për të kaluarën, duke formuluar pyetje, duke kryer kërkime të thjeshta dhe duke kuptuar koncepte themelore historike. Treguesit: - Formulimi i pyetjeve të thjeshta por të rëndësishme lidhur me ngjarje historike, persona dhe objekte. - Përdorimi i burimeve të ndryshme për të gjetur informacione historike (libra, internet, muze etj.). - Përshkrimi i ndryshimeve kryesore që kanë ndodhur në shoqëri gjatë historisë. - Shembuj të epokave të ndryshme dhe të karakteristikave të tyre.
2. Përdor burime:	Rezultati: - Nxënësi do të demonstrojë aftësinë për të gjetur, për të analizuar dhe për të përdorur burime të ndryshme historike për të ndërtuar një kuptim më të thellë të së kaluarës. Treguesit: - Identifikimi i burimeve historike (dokumente, fotografi, artefakte, dëshmi gojore). - Përdorimi i burimeve për të gjetur informacione të veçanta për një ngjarje historike. - Dallimi mes burimeve parësore dhe dytësore. - Përdorimi i hartave, grafikëve dhe tabelave për të ilustruar informacionin. - Përdorimi i teknologjisë për të kërkuar dhe për të paraqitur informacionin.

3. Analizon lidhjet shkak-pasojë:

Rezultati:

- Nxënësi do të demonstrojë aftësinë për të identifikuar lidhjet shkak-pasojë në ngjarjet historike dhe për të kuptuar si kanë formuar këto lidhje botën e sotme.

Treguesit:

- Kuptimi se ngjarjet historike nuk ndodhin rastësisht, por janë rezultat i faktorëve të ndryshëm.
- Kuptimi se shumë ngjarje historike kanë shkaqe të shumfishta dhe komplekse.
- Analizë e faktorëve (socialë, ekonomikë, politikë) që kanë ndikuar në një ngjarje.
- Kuptimi se ngjarjet e së kaluarës kanë një ndikim të vazhdueshëm në të tashmen.

4. Interpreton ngjarjet historike:

Rezultati:

- Nxënësi do të demonstrojë aftësinë për të interpretuar ngjarje historike duke marrë parasysh kontekstin historik, perspektivat e ndryshme dhe duke kuptuar se historia është një proces i ndërtimit të kuptimit.

Treguesit:

- Shembuj konkretë të ndikimit të lashtësisë në fusha të ndryshme (art, arkitekturë, filozofi).
- Krahësimi i versioneve të së njëjtës ngjarje historike.
- Interpretimet e veta të ngjarjeve historike, duke i mbështetur ato me prova.

5. Shpjegon dhe komunikon për të shkuarën:

- **Rezultati i të nxënit:** Nxënësi do të demonstrojë aftësinë për të komunikuar në mënyrë efektive njohuritë e tij historike duke përdorur një gjuhë të qartë dhe të organizuar, duke ndjekur një rend kronologjik dhe duke mbështetur argumentet e tij me prova.

Treguesit:

- Shpjegimi i ngjarjeve dhe i periudhave historike në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme.
- Paraqitja e ideve në mënyrë të organizuar dhe logjike.
- Përdorimi i një strukture të qartë për prezantimin (hyrje, trup, përfundim).
- Përdorimi i mjeteve pamore për të përforcuar prezantimin (harta, tabela, fotografi).

Përbërësit e kompetencave specifike që ndërton dhe zbaton nxënësi

Njohuri	Shkathtësi	Qëndrime
<i>Nxënësi ndihmohet të trajtojë situata që të fitojë njohuri për:</i> ▪ ndryshimin dhe vazhdimësinë në nivel personal, lokal dhe kombëtar; ▪ kohën dhe kronologjinë e ngjarjeve historike;	<i>Nxënësi ndihmohet të trajtojë situata që e aftësojnë:</i> • për të kërkuar dhe për të përdorur burimet, për të interpretuar dhe për të komunikuar për të shkuarën;	<i>Nxënësi ndihmohet të trajtojë situata që të zhvillojë:</i> - interesin dhe kuriozitetin për historinë; - objektivitetin dhe paanësisë; - përdorimin e mendimit kritik dhe kritikën konstruktive në situata të thjeshta;

KURRIKULA BËRTHAMË E ARSIMIT FILLOR (E PËRDITËSUAR)

▪ burimet historike dhe shumëllojshmërinë e tyre; ▪ aspektet e të shkuarës, të së tashmes dhe perspektivat e të ardhmes; ▪ njerëzit e parë në parahistori; ▪ mënyrat e jetesës së paraardhësve tanë; ▪ lindjen dhe zhvillimin e qytetërimeve të para botërore; ▪ lindjen dhe zhvillimin e qytetërimit ilir dhe vijimësinë e tij; ▪ qytetërimet antike si themeli i kulturës europiane.	• për të përdorur dhe për të interpretuar harta, fotografi, pamje, postera etj.; • për të përdorur burime historike; • për të ndërtuar linjën e kohës për të vendosur në periudhën e saktë datat ngjarjet, figurat dhe proceset historike; • për të përdorur saktë fjalorin historik; • për të kërkuar, përzgjedhur dhe përpunuar informacionin; • për të pyetur dhe për t'u përgjigjur për të tashmen, duke e lidhur atë me të shkuarën; • për të menduar në mënyrë kritike e krijuese; • për të zgjidhur problemet; • për të vlerësuar dhe për të përdorur mendimin kritik dhe kritikën konstruktive në situata të thjeshta; • për të kuptuar ndjenjat dhe qëndrimet e të tjerëve; • për të shprehur dhe për të pranuar këndvështrimet e ndryshme; • për të debatuar, për të negociuar dhe për të arritur kompromise.	- pavarësinë dhe besimin në vetvete; - krenarinë për vendin e tij; - rëndësinë e historisë në kuptimin e ngjarjeve të së shkuarës dhe në ndërtimin e të tashmes; - rëndësinë e burimeve historike në ndërtimin objektiv të ngjarjeve historike; - burimet historike dhe të informacionit; - trashëgiminë kulturore botërore; - pikëpamjet e të tjerëve; - origjinën historike dhe dobinë e larmisë etnike dhe kulturore të shoqërisë; - punën e kryer mirë dhe pranimin e opinioneve të tjera (madje edhe të kundërta) duke treguar tolerancë; - përpjekjet personale dhe ato në grup; - larminë në shoqëri, si dhe kontributin e kulturave dhe të grupeve të ndryshme fetare e shoqërore.
--	--	--

9.7. Fusha kurrikulare “Artet”

Fusha përfshin artin pamor, muzikën, kërcimin dhe teatrin si lëndë të detyrueshme dhe mundëson që nxënësit të njohin, të krijojnë, të performojnë apo të realizojnë në mënyrë sistematike në disiplina të ndryshme artistike, si dhe të vlerësojnë artet duke zhvilluar gjykime dhe qëndrime të qarta nëpërmjet njohjes së zhvillimit historik të arteve dhe të veprave artistike, duke fituar kompetenca në këto disiplina artistike.

Qëllimet e fushës

Fusha synon:

- zhvillimin e njohurive dhe të koncepteve bazë për formimin artistik;
- zbulimin e dukurive nga mjedisi nëpërmjet arteve të ndryshme;
- zhvillimin e aftësive artistike, të menduarit kritik dhe krijues;
- aftësimin e nxënësve për të njohur dhe për të vlerësuar vepra të artit shqiptar dhe botëror, nga periudha dhe kontekste kulturore dhe historike;
- përfshirjen në veprimtari artistike tradicionale, duke manifestuar vlerat e artit kombëtar si pjesë e vlerave të artit botëror;
- ndërveprimin me grupet të ndryshme kulturore apo etnike;
- zhvillimin nga nxënësit të kompetencave artistike për punë të ndryshme;
- pjesëmarrjen në jetën kulturore të klasës, shkollës, komunitetit, duke vënë aftësitë dhe talentin e vet në shërbim të mjedisit ku jeton;
- kontributin personal në zhvillimet artistike e kulturore në nivel lokal, kombëtar dhe më gjerë.

Përshkrimi i kompetencave specifike që ndërton dhe zbaton nxënësi

Kompetenca specifike	Përshkrimi i kompetencave <i>Kapaciteti/zotësia e nxënësit për të aktivizuar njohuri, aftësi dhe qëndrime me të cilat:</i>
Krijon punime artistike	• përdor elementet dhe parimet e gjuhës artistike; • përdor ide të ndryshme për të krijuar një vepër artistike (muzikore, pamore, koreografike apo dramatike); • eksperimenton duke zhvilluar më tej idetë e veta artistike; • organizon krijimin e vet artistik, sipas elementeve të gjuhës artistike; • ndan përvojat e veta krijuese me të tjerët.

KURRIKULA BËRTHAMË E ARSIMIT FILLOR (E PËRDITËSUAR)

Realizon/Performon/Interpreton në mënyrë artistike	- familjarizohet me përmbajtje të ndryshme të veprave artistike; - zbaton teknika dhe procese të ndryshme artistike; - respekton rregullat e performimit, interpretimit dhe realizimit artistik; - ndan përvojat performuese/realizuese të veprave artistike me të tjerë; - analizon punën e interpretuar/realizuar në mënyrë artistike.
Vlerëson veprat artistike	- analizon veprat artistike të performuara/të realizuara; - shpjegon kuptimin veprave artistike të realizuara/të performuara; - bën një gjykim kritik dhe estetik.

RN-të në përfundimin e arsimit fillor

NIVELI 5 “Demonstrim shumë i mirë i rezultatit të nxënies” <i>Pa kërkuar përpikëri absolute në zotërimin e përbërësve të kompetencës, presim që nxënësi:</i>	
1. Krijon punime artistike: Rezultati: - Nxënësi do të demonstrojë aftësinë për të shprehur idetë dhe ndjenjat e veta përmes arteve të ndryshme (art pamor, muzikë, kërcim dhe teatër), duke zhvilluar një stil personal dhe duke eksperimentuar me teknika dhe materiale të ndryshme. Treguesit: Shprehja artistike: - Përdor artin për të shprehur idetë, ndjenjat dhe përvojat e veta. - Krijon punime që pasqyrojnë një interpretim personal të botës. Aftësi teknike: - Zotëron teknikat bazë të vizatimit, pikturës, skulpturës ose të një forme tjetër artistike. - Aplikon konceptet artistike (ritmi, lëvizja, ngjyra, forma, hapësira, linjë, tekstura etj.,) në krijimet e veta. Eksperimentimi: - Eksperimenton me materiale dhe teknika të ndryshme artistike. Stili personal: - Zhvillon një stil të veçantë dhe të dallueshëm në krijimet e veta. Vlerësimi kritik: - Vlerëson punimet e veta dhe të të tjerëve.	
2. Performon/realizon role/punë artistike: Rezultati:	

- Nxënësi do të demonstrojë aftësinë për të interpretuar role artistike, do të bashkëpunojë në veprimtari grupore dhe do të shfaqë siguri në performancat e tij.

Treguesit:

Pjesëmarrja:

- Merr pjesë me entuziazëm në veprimtari artistike të ndryshme ((art pamor, muzikë, kërcim dhe teatër).

Bashkëpunimi në grup:

- Bashkëpunon me të tjerët për të realizuar një projekt artistik apo performancë artistike.
- Kupton rëndësinë e sinkronizimit dhe të bashkëveprimit e veprimeve artistike me të tjerët.

Siguria në performancë:

- Përdor instrumente muzikore, trupin ose zërin në mënyrë të efektshme.
- Nuk ndihet i turpëruar të shprehë veten artistikisht.

Vlerësimi kritik:

- Vlerëson performancat e veta dhe të të tjerëve.
- Merr parasysh komentet e të tjerëve për të përmirësuar performancat dhe punimet e ardhshme.

3. Vlerëson vepra artistike:

Rezultati:

- Nxënësi do të demonstrojë aftësinë për të analizuar dhe për të vlerësuar vepra artistike nga kultura dhe epoka të ndryshme, duke vlerësuar estetikën dhe duke ofruar mendime kritike për artin.

Treguesit:

Analiza e veprave artistike:

- Përshkruan me hollësi elementet kryesore të një veprë artistike (ngjyrën, formën, linjën, hapësirën, teksturën, ritmin, lëvizjen).
- Identifikon temën dhe mesazhin e një veprë artistike.

Vlerësimi kritik:

- Formulon mendime individuale dhe argumente të mbështetura për një vepër artistike.
- Kupton se interpretimet artistike janë individuale dhe se mund të ketë shumë mënyra për të interpretuar një vepër dramatike, koreografike, artistike apo muzikore.

Njohja e historisë së artit:

- Identifikon stilet e ndryshme të artit (realizëm, impresionizëm, abstraksionizëm etj.).
- Njihet me disa nga artistët më të rëndësishëm dhe me veprat e tyre.

Përbërësit e kompetencave specifike që ndërton dhe zbaton nxënësi

Njohuri	Aftësi	Qëndrime
<i>Nxënësi ndihmohet të trajtojë situata që të fitojë njohuri për:</i> Gjuhën dhe krijimin artistik ▪ konceptet artistike, - proceset artistike;	<i>Nxënësi ndihmohet të trajtojë situata që e aftësojnë:</i> • të përfetojë dukuri artistike; • të dëgjojë dhe të perceptojë; • të zhvillojë vëmendjen dhe	<i>Nxënësi ndihmohet të trajtojë situata që të zhvillojë:</i> - vetëbesimin; - komunikim e pavarur; - këmbënguljen;

▪ gjuhën artistike; ▪ vepra të ndryshme artistike; ▪ vlerësimin e veprave artistike; ▪ komunikim nëpërmjet gjuhës artistike. Teknikat dhe proceset artistike ▪ teknika dhe procese të ndryshme artistike; ▪ mjetet shprehëse të arteve; ▪ elementet artistike. Historinë, kulturën, shoqërinë ▪ ndikimin e arteve në shoqëri; ▪ vepra dhe autorë më të spikatur të krijimtarisë artistike, kontekste të ndryshme historike sociale dhe kulturore; ▪ vlerat e trashëgimisë kulturore; ▪ vepra shqiptare ose botërore.	kujtesën artistike; • të imagjinojë dhe të krijojë; • të dallojë ritmin dhe harmoninë (tingujt, ngjyrat, format, strukturat, karakteret, lëvizjet etj.); • të komunikojë dhe të shprehet artistikisht; • të mendojë në mënyrë kritike dhe krijuese etj.	- bashkëpunimin; - respektin për veten dhe të tjerët; - qëndrimin ndaj artit dhe të bukurës në art; - respektin ndaj trashëgimisë kulturore kombëtare dhe të kulturave të tjera.
--	---	---

9.8. Fusha kurrikulare “Edukimi fizik, sporti dhe shëndeti”

Fusha ndihmon nxënësit të zhvillojnë njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet e nevojshme, të cilat sigurojnë mirëqenien e shëndetit të tyre mendor, emocional, fizik dhe social, si dhe të përballin me sukses sfidat e jetës së tashme dhe të ardhme. Fusha do të integrojë edukimin fizik dhe sporte me edukatën shëndetësore e cila u ofron nxënësve njohuri dhe aftësi të nevojshme për të zhvilluar një stil jetese të shëndetshëm dhe aktiv.

Qëllimet e fushës

Fusha ka si qëllime:

- promovimin e aktivitetit fizik, edukimin e një stili jetese të shëndetshme e aktive dhe fitimin e kompetencave të vlefshme përgjatë gjithë jetës;
- përvetësimin e bazave fillestare të elementeve teknike e taktike që fitohen në disiplinat sportive; edukimin nëpërmjet veprimtarive fizike e sportive dhe njohjen me konceptet fillestare të rregulloreve të disiplinave sportive;
- njohjen dhe kuptimin e strukturës dhe të funksionimit të trupit;

KURRIKULA BËRTHAMË E ARSIMIT FILLOR (E PËRDITËSUAR)

- përvetësimin e bazave për kombinacione lëvizore, të aftësive lëvizore, të manipulimit lëvizor me ose pa mjete dhe elemente të thjeshta akrobatike;
- përvetësimin e rregullave të sigurisë gjatë aktivitetit fizik e sportiv;
- njohjen me parimet e olimpizmit, filozofisë olimpike dhe *Fair-Play*-t;
- kuptimin e rëndësisë së ushtrimit sistematik, edukimin e disiplinës, vullnetit, vetëvlerësimit dhe konkurrencës së ndershme.

Përshkrimi i kompetencave specifike që ndërton nxënësi

Kompetenca specifike	Përshkrimi i kompetencave <i>Kapaciteti/zotësia e nxënësit për të aktivizuar njohuri, aftësi dhe qëndrime me të cilat:</i>
Kompetenca motorike dhe lëvizore	- Kupton e zbaton teknikat e lëvizjes, si: vrapimi, kërcimi, hedhja, kapja dhe goditja. - Zhvillon koordinimin dhe kontrollin motorik në veprimtari të ndryshme. - Përmirëson qëndrimin dhe ekuilibrin përmes ushtrimeve të ndryshme. - Përdor strategji të ndryshme të lëvizjes në lojëra dhe sporte të ndryshme.
Kompetenca e kondicionimit fizik	- Kupton rëndësinë e kondicionit fizik dhe ndikimin e tij në shëndet. - Zhvillon forcën, shpejtësinë, qëndrueshmërinë dhe fleksibilitetin përmes stërvitjeve të rregullta. - Aplikon teknika të ngrohjes dhe të zgjatjes për të parandaluar lëndimet dhe për të përmirësuar performancën fizike. - Përdor teknika të ndryshme të relaksimit dhe të rikuperimit pas stërvitjeve dhe veprimtarive fizike.
Kompetenca për shëndetin dhe mirëqenien	- Kupton rëndësinë e një stili jetese të shëndetshëm dhe të balancuar. - Zbaton njohuritë për ushqimin dhe dietën për të mbajtur një peshë të shëndetshme dhe për të përmirësuar mirëqenien e përgjithshme. - Reflekton për përfitimet e aktivitetit fizik për shëndetin mendor dhe emocional. - Ndjek dhe mban një rutinë të rregullt ushtrimesh fizike për të përmirësuar shëndetin dhe mirëqenien e tij.
Kompetenca sociale dhe ndërpersonale	- Përdor aftësi të komunikimit efektiv dhe të bashkëpunimit në veprimtari grupore dhe lojëra sportive. - Zhvillon ndjenjën e përgjegjësisë dhe të disiplinës së tij dhe të ekipit gjatë veprimtarive sportive. - Ndërton dhe përmirëson marrëdhëniet ndërpersonale përmes sportit dhe veprimtarive fizike. - Demonstron respekt dhe ndershmëri gjatë konkurseve dhe lojërave sportive.

Kompetenca strategjike dhe taktike	- Zhvillon dhe përdor strategji dhe taktika në lojëra dhe sporte të ndryshme për të përmirësuar performancën dhe suksesin. - Kupton dhe analizon rregullat dhe strategjitë e ndryshme të sporteve për të marrë vendime të shpejta dhe efektive gjatë lojës. - Përdor mendimin kritik për të vlerësuar dhe për të përmirësuar strategjitë dhe taktikat e përdorura në sport. - Përmirëson aftësitë e planifikimit dhe të ekzekutimit të strategjive sportive për suksesin e ekipit dhe të vetes.
--	--

RN-të në përfundimin e arsimit fillor

NIVELI 5 <i>“Demonstrim shumë i mirë i rezultatit të nxënies”</i> <i>Pa kërkuar përpikëri absolute në zotërimin e përbërësve të kompetencës, presim që nxënësi:</i>
Për kompetencën motorike dhe lëvizëse Kupton dhe zbaton teknikat bazë të lëvizjes: <u>Rezultati:</u> Nxënësi demonstrohet i aftë të ekzekutojë saktë lëvizje bazë, si: vrapimi, kërcimi, hedhja, kapja dhe goditja. <u>Treguesi:</u> Kryerja e ushtrimeve dhe e lojërave që kërkojnë këto lëvizje. Zhvillon koordinimin dhe kontrollin motorik: <u>Rezultati:</u> Nxënësi tregon përmirësim në koordinimin dhe kontrollin e lëvizjeve trupore gjatë veprimtarive sportive dhe lojërave. <u>Treguesi:</u> Pjesëmarrja në veprimtari të ndryshme, si gjimnastikë, basketboll, ose lojëra të tjera që kërkojnë kontroll motorik. Për kompetenca fizike dhe kondicioni: Kupton rëndësinë e kondicionit fizik: <u>Rezultati:</u> Nxënësi përshkruan përfitimet e kondicionit fizik dhe ndikimin e tij në shëndet. <u>Treguesi:</u> Pjesëmarrja në veprimtari stërvitore që përfshijnë forcën, shpejtësinë, qëndrueshmërinë dhe fleksibilitetin. Aplikon teknika të ngrohjes dhe të zgjatjes: <u>Rezultati:</u> Nxënësi ndjek rutina të rregullta të ngrohjes dhe të zgjatjes për të përgatitur trupin për aktivitet fizik dhe për të parandaluar lëndimet. <u>Treguesi:</u> Pjesëmarrja në ushtrime ngrohjeje dhe zgjatjeje para dhe pas veprimtarive fizike. Për kompetenca për shëndetin dhe mirëqenien: Kupton rëndësinë e një stili jetese të shëndetshëm: <u>Rezultati:</u> Nxënësi përshkruan përfitimet e një stili jetese të shëndetshëm dhe mënyrën se si ushqimi ndikon në shëndetin e përgjithshëm. <u>Treguesi:</u> Ndjekja e një diete të balancuar dhe reflektimi mbi efektet pozitive të aktivitetit fizik për shëndetin mendor dhe emocional.

Ndjek dhe mban një rutinë të rregullt ushtrimesh fizike:

Rezultati: Nxënësi angazhohet në rutinë ushtrimesh fizike për të mbajtur shëndetin dhe mirëqenien.

Treguesi: Ushtrime të përditshme ose të rregullta dhe dokumentimi i përparimit në një ditar ose plan ushtrimesh.

Për kompetencat sociale dhe ndërpersonale:

Përdor aftësi të komunikimit efektiv:

Rezultati: Nxënësi tregon aftësi të komunikimit efektiv dhe të bashkëpunimit në veprimtari grupore dhe në lojëra sportive.

Treguesi: Merr pjesë në diskutime grupore dhe ndihmon në koordinimin e veprimtarive të grupit.

Zhvillon ndjenjën e përgjegjësisë dhe të disiplinës personale:

Rezultati: Nxënësi demonstroi përgjegjësi dhe disiplinë gjatë veprimtarive sportive, duke respektuar rregullat dhe udhëzimet.

Treguesi: Ndjeja e rregullave të lojërave dhe sjellja e përgjegjshme gjatë lojërave dhe veprimtarive.

Për kompetenca strategjike dhe taktike:

Zhvillon dhe përdor strategji dhe taktika:

Rezultati: Nxënësi demonstroi aftësi për të zhvilluar dhe për të përdorur strategji dhe taktika në lojëra dhe sporte të ndryshme.

Treguesi: Përdorimi i strategjive për të arritur qëllimet e ekipit dhe për të marrë vendime të shpejta dhe efektive gjatë lojës.

Përbërësit e kompetencave specifike që ndërton dhe zbaton nxënësi

Njohuri	Aftësi	Qëndrime
<i>Nxënësi ndihmohet të trajtojë situata që të fitojë njohuri për:</i> ÷ teknikat bazë të lëvizjes dhe sportit; ÷ rëndësinë e kondicionit fizik dhe shëndetit; ÷ stil jetese të shëndetshëm dhe ushqimi të balancuar; ÷ rregullat dhe strategjitë e sporteve.	<i>Nxënësi ndihmohet të trajtojë situata që i aftësojnë:</i> ▪ kontrollin motorik dhe koordinimin; ▪ zhvillimin e forcës, shpejtësisë dhe fleksibilitetit; ▪ planifikimin dhe ndjekjen e rutinave të ushtrimeve fizike; ▪ zbatimin e strategjive dhe të taktikave në lojëra.	<i>Nxënësi ndihmohet të trajtojë situata që të zhvillojë:</i> • përfshirje dhe motivim për aktivitet fizik; • respekt për veten dhe për të tjerët në veprimtari sportive; • disiplinë dhe përgjegjësi vetjake dhe të ekipit; • ndershmëri dhe lojë të drejtë në sport.

9.9. Fusha kurrikulare “Teknologji dhe TIK”

Qëllimet e fushës përqendrohen në ndërtimin e aftësive, nxitjen e krijimtarisë dhe në përdorimin e përgjegjshëm të teknologjisë, si:

- **Alfabetizimi teknologjik:** Zhvillimi i njohurive dhe i aftësive bazë lidhur me teknologjinë, duke përfshirë të kuptuarit e llojeve të ndryshme të teknologjive dhe aplikimet e tyre në jetën e përditshme dhe në fusha të ndryshme.
- **Kompetenca digjitale:** Ndërtimi i aftësive thelbësore, si përdorimi i kompjuterëve, tabletave dhe pajisjeve të tjera digjitale në mënyrë efektive për komunikim, gjetje të informacionit dhe shprehjen e krijimtarisë.
- **Zgjidhja e problemeve me teknologji:** Nxitja e nxënësve për të përdorur mjete dhe burime teknologjike për të zgjidhur problemet reale, për t'u angazhuar në projekte dhe për të zhvilluar të menduarit logjik dhe krijimtarinë.
- **Përdorimi i sigurt dhe i përgjegjshëm i TIK-ut:** Aftësimi i nxënësve për sigurinë në internet, qytetarinë digjitale dhe sjelljen etike gjatë përdorimit të teknologjisë, duke përfshirë kuptimin e privatësisë, sigurinë e të dhënave dhe ndarjen e përgjegjshme të informacionit.
- **Bashkëpunimi dhe komunikimi:** Promovimi i përdorimit të teknologjisë për të bashkëpunuar me kolegët, për të ndarë idetë dhe për të komunikuar në mënyrë efektive në mjediset digjitale, duke nxitur punën ekipore dhe ndërveprimin social.
- **Shprehja krijuese përmes teknologjisë:** Nxitja e nxënësve që të përdorin mjete TIK-u për të krijuar përmbajtje digjitale, si prezantime, projekte multimediale dhe programim të thjeshtë, duke u mundësuar të shprehin idetë në mënyrë krijuese.
- **Kuptimi i ndikimit teknologjik:** Zhvillimi i vetëdijes se si teknologjia ndikon në shoqëri, mjedis dhe ekonomi, si dhe nxitja e të menduarit kritik për rolin e teknologjisë në adresimin e sfidave globale.
- **Hyrje në programim dhe robotikë:** Prezantimi i koncepteve bazë të programimit dhe të robotikës së thjeshtë për të ndezur kuriozitetin se si funksionon teknologjia dhe për të frymëzuar interesin për studime të mëtejshme në fushat STEM.

9.9.1. Lënda “Aftësim teknologjik praktik”

Përshkrimi i kompetencave specifike që ndërton dhe zbaton nxënësi

Kompetenca specifike	Përshkrimi i kompetencave <i>Kapaciteti/zotësia e nxënësit për të aktivizuar njohuri, aftësi dhe qëndrime me të cilat:</i>
Komunikon grafikisht	- zhvillon aftësinë për të skicuar; - realizon objekte dhe veprimtari të ndryshme sipas një modeli; - identifikon problematika gjatë zbatimit të skicave, të recetave, ose të modeleve;

	- prezanton skica e modele duke përdorur media të ndryshme.
Përdor materiale dhe mjete teknologjike	- zbaton teknikat artizanale gjatë realizimit të veprimtarive të ndryshme; - përshkruan përdorimet dhe funksionimin e mekanizmave dhe të strukturave në mjedisin familjar; - diskuton për qëndrueshmërinë, efikasitetin dhe formën e objekteve të realizuara. - vlerëson ndikimin e punimit, për vete dhe për mjedisin përreth; - klasifikon strukturat/mekanizmat dhe tregon përdorimet e tyre në teknologji;
Demonstron ndikimin e teknologjisë	- kryen llogaritje të thjeshta të kostos së materialeve të produktit përfundimtar; - klasifikon materiale ricikluese bazë nga ekonomia familjare duke i dalluar, krahasuar dhe renditur për përdorime të tjera; - organizon mjedisin dhe mjetet e punës, duke pasur parasysh kufizimet e burimeve; - mbron idetë, materialet, procedurat dhe teknikat e përdorura dhe tregon përmirësime të mundshme; - vlerëson veprimtarinë dhe produktin përfundimtar, duke iu referuar planit të veprimit, skicës, recetës ose modelit; - analizon ndikimin e teknologjisë në veprimtaritë ekonomike; - planifikon dhe realizon produkte dhe shërbime të thjeshta nëpërmjet përdorimit të materialeve, veglave dhe proceseve të thjeshta teknologjike.
Zbaton kushtet e sigurisë dhe etikën	- identifikon veprimtaritë që realizohen në shtëpi, komunitet dhe shkollë në kushte të sigurta; - zbaton udhëzimet gjatë veprimtarive të matjes, të shënimit, të prerjes së sigurt dhe të formësimit të materialeve të ndryshme.

RN-të në përfundimin e arsimit fillor

NIVELI 5 <i>“Demonstrim shumë i mirë i rezultatit të nxënies”</i> <i>Pa kërkuar përpikëri absolute në zotërimin e përbërësve të kompetencës, presim që nxënësi:</i>
1. Komunikon me mjete grafike: <u>Rezultati:</u> - Nxënësi do të demonstrojë aftësi për të krijuar dhe për të interpretuar vizatime dhe diagrame të thjeshta, duke kuptuar rëndësinë e komunikimit grafik në kontekstet teknologjike/inxhinierike. <u>Treguesit:</u> Krijimi i vizatimeve dhe i diagrameve: - Krijon vizatime të thjeshta të objekteve ose ideve duke përdorur mjete të ndryshme (vizore, busull, letër rrjeti). - Zgjedh mjetet dhe format e përshtatshme për të komunikuar idetë e veta në mënyrë efektive. Interpretimi i vizatimeve dhe diagrameve:

- Lexon dhe interpreton plane të thjeshta, harta dhe vizatime teknike.
- Identifikon elementet kryesore të një vizatimi ose diagrami (p.sh.: dimensionet, shkalla, simbolet).

Zgjidhja e problemeve:

- Vizualizon një problem ose një ide duke krijuar një vizatim.

Kuptimi i rëndësisë së komunikimit grafik:

- Vlerëson rëndësinë e precizitetit dhe të qartësisë në komunikimin grafik.

2. Kupton dhe përdor strukturat dhe materiale teknologjike:

Rezultati:

- Nxënësi do të demonstrojë një kuptim themelor të materialeve dhe strukturave, duke qenë në gjendje të identifikojë vetitë e materialeve dhe të krijojë modele të thjeshta.

Treguesit:

Njohuria e materialeve:

- Identifikon dhe përshkruan materialet e ndryshme (dru, metal, plastikë etj.).
- Kupton vetitë themelore të materialeve (fortësi, fleksibiliteti, pesha etj.).

Njohuria e strukturave:

- Identifikon struktura të thjeshta në mjedis (ura, ndërtesa, makina).
- Kupton se si materialet e ndryshme përdoren për të ndërtuar struktura të ndryshme.

Krijimi i modeleve:

- Krijon modele të thjeshta të strukturave duke përdorur materiale të ndryshme (p.sh.: kube, ura, kullë).

Zgjidhja e problemeve:

- Zgjidh materialet e duhura për të ndërtuar një strukturë specifike.

3. Njeh dhe lidh teknologjinë me veprimtarinë ekonomike:

Rezultati:

- Nxënësi do të demonstrojë një kuptim të lidhjes midis teknologjisë dhe ekonomisë, duke kuptuar se si teknologjia ndikon në prodhimin, transportin, komunikimin dhe inovacionin.

Treguesit:

Lidhja teknologji-ekonomi:

- Identifikon shembuj të teknologjive të përdorura në sektorë të ndryshëm ekonomikë (bujqësi, industri, shërbime).

Teknologjia në sektorët ekonomikë:

- Përshkruan se si teknologjia përdoret në bujqësi (makineri bujqësore, sisteme ujitjeje, bioteknologji).
- Përshkruan se si teknologjia përdoret në industri (automatizimi, robotika, linjat e prodhimit).

Inovacion dhe teknologji:

- Identifikon shembuj të kompanive që kanë pasur sukses falë inovacionit.

Efekti i teknologjisë në ekonomi:

- Diskuton për epërsitë dhe pasojat e teknologjisë në ekonomi (p.sh., automatizimi dhe humbja e vendeve të punës).

4. Zbaton etikën dhe kushtet e sigurta brenda dhe jashtë shkollës:

Rezultati:

- Nxënësi do të demonstrojë një kuptim të etikës dhe të sigurisë në përdorimin e teknologjisë, duke zbatuar praktika të sigurta në mjedis të ndryshëm.

Treguesit:

Etika në përdorimin e teknologjisë:

- Kupton rëndësinë e respektimit të të drejtave të autorit dhe të pronësisë intelektuale.
- Kupton rëndësinë e privatësisë dhe të mbrojtjes së të dhënave personale.

Siguria në përdorimin e mjeteve dhe të materialeve:

- Përdor në mënyrë të sigurt veglat dhe materialet e ndryshme (gërshërë, ngjites, pajisje elektronike).
- Ndjek udhëzimet e mësuesit dhe rregullat e shkollës për sigurinë.
- Identifikon rreziqet e mundshme në mjedis dhe merr masa për t'i shmangur ato.

Siguria në Internet:

- Përdor internetin në mënyrë të përgjegjshme dhe të sigurt.
- Njeh rreziqet e mundshme në internet (p.sh., viruset, spam-et, mashtrimet) dhe mund t'i shmangë.

Përbërësit e kompetencave specifike që ndërton dhe zbaton nxënësi

Njohuri	Aftësi	Qëndrime
<i>Nxënësi ndihmohet të trajtojë situata që të fitojë njohuri për:</i> ▪ paraqitjet grafike; ▪ materialet teknologjike; ▪ strukturat teknologjike; ▪ sistemin teknologjik; ▪ prodhimin industrial; ▪ prodhimin artizanal; ▪ prodhimin bujqësor; ▪ teknologjinë ekologjike.	<i>Nxënësi ndihmohet të trajtojë situata që e aftësojnë:</i> • të konsumojë ushqime të shëndetshme; • të vlerësojë vlerat ushqyese dhe koston e gatimeve të ndryshme; • të kujdeset për ruajtjen e ushqimeve në shtëpi; • të përzgjedhë mjetet e punës dhe lëndët e para për gatime sipas recetave të caktuara; • të ndërtojë objekte të përdorimit shtëpiak dhe të kopshtit.	<i>Nxënësi ndihmohet të trajtojë situata që të zhvillojë:</i> - rregullat e sigurisë dhe mbrojtjen e mjedisit gjatë përdorimit të pajisjeve elektroshtëpiake; - vlerësimin për materialet e përdorura, kohën për realizimin e objektit dhe kostot përkatëse për realizimin e tij; - vlerësimin për materialet e përdorura, kohën e shpenzuar për realizimin e vaktit dhe kostot përkatëse për një ushqyerje të shëndetshme.

9.9. 2 Lënda “Teknologjia e informacionit dhe e komunikimit (TIK)”

Lënda krijon kushte dhe mundësi që nxënësit të ndërtojnë dhe të përdorin njohuri dhe aftësi thelbësore digjitale, të zhvillojnë krijimtarinë dhe të përdorin të përgjegjshëm teknologjinë. Ajo synon që nxënësit të përgatiten për botën digjitale, duke rritur aftësinë për të përdorur mjetet e TIK-ut në procesin e të mësuarit dhe në jetën e përditshme.

Qëllime specifike janë:

- **Alfabetizimi digjital (digjital literacy):** Nxënësit të fitojnë aftësi bazë për të kuptuar dhe përdorur kompjuterët, softuerin dhe pajisjet e tjera digjitale në mënyrë efektive, duke përfshirë të shkruarit, lundrimin në internet dhe përdorimin e softuerit arsimor.
- **Përmirësimi i të nxënit:** Nxitja e përdorimit të mjeteve të TIK-ut për të ndihmuar të nxënit në të gjitha lëndët, si kërkimi, prezantimet dhe zgjidhja e problemeve, duke i ndihmuar nxënësit të përfshihen në mënyrë më ndërvepruese.
- **Nxitja e krijimtarisë dhe e inovacionit:** Promovimi i përdorimit të mjeteve digjitale për shprehje krijuese, të tilla si krijimi i projekteve multimediale, arti digjital ose detyra të thjeshta programimi, duke nxitur inovacionin dhe zgjidhjen e problemeve.
- **Ndërtimi i të menduarit kritik:** Zhvillimi i aftësisë së nxënësve për të analizuar informacionin, për të vlerësuar besueshmërinë e burimeve në internet dhe për të menduar në mënyrë kritike kur përdorin mediat digjitale.
- **Nxitja e bashkëpunimit:** Promovimi i punës në grup dhe i komunikimit përmes platformave digjitale, duke u mundësuar nxënësve të bashkëpunojnë në projekte dhe të ndajnë idetë me moshatarët dhe mësuesit në kohë reale.
- **Përdorimi i përgjegjshëm dhe etik i teknologjisë:** Futja e vlerave të qytetarisë digjitale, duke përfshirë sigurinë në internet, respektimin e pronës intelektuale dhe të kuptuarit e përdorimit etik të teknologjisë dhe të internetit.
- **Vendosja e bazave për kompetencën digjitale gjatë jetës:** Nxënësit të përgatiten për rolin e teknologjisë në arsimimin, punësimin dhe shoqërinë e ardhshme.

Përshkrimi i kompetencave specifike që ndërton dhe zbaton nxënësi

Kompetenca specifike	Përshkrimi i kompetencave <i>Kapaciteti/zotësia e nxënësit për të aktivizuar njohuri, aftësi dhe qëndrime me të cilat:</i>
----------------------	---

KURRIKULA BËRTHAMË E ARSIMIT FILLOR (E PËRDITËSUAR)

Përdor dhe informohet me TIK	- përdor në mënyrë efektive teknologjinë e informacionit dhe komunikimit për të kërkuar, vlerësuar, analizuar dhe menaxhuar informacionin; - zhvillon njohuritë për përdorimin e pajisjeve kompjuterike, të programeve softuerike, aplikacioneve të ndryshme, si dhe aftësinë për të identifikuar e përdorur burime harduerike dhe softuerike në mënyrë efikase dhe etike.
Krijon përmbajtje digjitale	- krijon, modifikon dhe ndan përmbajtje digjitale; - zotëron njohuri për përdorimin e mjeteve dhe të platformave të ndryshme për krijimin e tekstit, të grafikëve, videove, audiove dhe formave të tjera të përmbajtjes digjitale; - zotëron njohuri për menaxhimin e të drejtave të autorit dhe të licencave digjitale.
Komunikon dhe bashkëpunon në mjedisin digjital	- përdor mjetet dhe platformat digjitale për të komunikuar dhe për të bashkëpunuar me të tjerët; - zhvillon aftësinë për të ndarë informacionin, për të punuar në projekte të përbashkëta, për të marrë pjesë në diskutime online, për të përdorur mediat sociale dhe për të menaxhuar komunikimet në mjedise të ndryshme virtuale; - zhvillon aftësinë për të ndërtuar dhe për të mbajtur marrëdhënie efektive në internet.
Mendon, kodon dhe zgjidh probleme me teknologji	- zbaton mendimin logjik dhe algoritmik për të analizuar dhe për të zgjidhur probleme nëpërmjet mjeteve digjitale; - rrit aftësitë për të dizajnuar dhe për zhvilluar algoritme, për të koduar, për të analizuar të dhëna, për të modeluar probleme dhe për të gjetur zgjidhje optimale ndërmjet përdorimit të mjeteve digjitale dhe aplikimeve të të menduarit kompjuterik.
Respekton sigurinë dhe mbrojtjen brenda dhe jashtë shkollës	- zhvillon aftësinë për të mbrojtur veten dhe informacionin nga rreziqet dhe kërcënimet në mjedisin digjital; - zotëron njohuritë dhe praktikën për sigurinë kibernetike, përdorimin e fjalëkalimeve të sigurt dhe mbrojtjen kundër viruseve; - menaxhon privatësinë dhe mbrojtjen e të dhënave personale, si dhe aftësinë për të njohur dhe për të reaguar në mënyrë të sigurt, duke respektuar parimet e qytetarisë digjitale (përdorimi i teknologjisë në mënyrë të përgjegjshme, etike dhe të sigurt).

RN-të në përfundimin e arsimit fillor

NIVELI 5 <i>“Demonstrim shumë i mirë i rezultatit të nxënies”</i> <i>Pa kërkuar përpikëri absolute në zotërimin e përbërësve të kompetencës, presim që nxënësi:</i>
1. Përdor dhe informohet me TIK: <u>Rezultati:</u>

- Nxënësi do të demonstrojë aftësinë për të përdorur softuerin bazë kompjuterik për të krijuar paraqitje vizuale dhe për të komunikuar idetë në mënyrë efektive.

Treguesit:

Përdorimi i softuerit bazë:

- Përdor me siguri softuerin bazë për vizatim, prezantim dhe dizajn.
- Zgjedh mjetet dhe format e duhura për të krijuar lloje të ndryshme të vizatimeve dhe të grafikëve.

Krijimi i paraqitjeve vizuale:

- Krijon diagrame, grafikë dhe ilustrime të thjeshta për të përfaqësuar të dhëna ose ide.

Komunikimi digjital:

- Përdor grafikët për të komunikuar idetë në mënyrë efektive në prezantime dhe dokumente.

Manipulimi i pamjeve digjitale:

- Ndërton dhe modifikon pamje digjitale duke përdorur veçori të ndryshme të softuerit (p.sh.: rrotullim, prerje, ndryshim i madhësisë).

2. Krijon përmbajtje digjitale:

Rezultati

- Nxënësit do të demonstrojnë aftësinë për të përdorur TIK-un për të krijuar modele digjitale të strukturave, duke simuluar dhe eksperimentuar me materiale dhe struktura të ndryshme.

Treguesit:

Modelim digjital:

- Përdor softuer të thjeshtë për të krijuar modele 2D ose 3D të strukturave (shtëpi, ura etj.).

Simulim dhe eksperimentim:

- Simulon ndryshime në materialet dhe strukturën e modeleve digjitale.

Kuptimi i teknologjisë:

- Lidh konceptet e mësuara në klasë me përdorimin e softuerit për modelim.

3. Komunikon dhe bashkëpunon:

Rezultati:

- Nxënësit do të demonstrojnë aftësinë e komunikimit efektiv dhe të bashkëpunimit me të tjerët duke përdorur një gamë të gjerë mjeteve dhe platformash digjitale.

Treguesit:

Përdorimi i mjeteve digjitale:

- Përdor mjete komunikimi (p.sh., *e-mail*, mesazhe, video konferenca) në situata të ndryshme dhe platforma bashkëpunuese (p.sh., *Google Drive*, *Padlet*) për të punuar në projekte të përbashkëta.

Ndarja e informacionit:

- Prezanton ide dhe informacion në mënyrë qartë dhe të organizuar duke përdorur mjete digjitale.
- Kërkon dhe mbledh informacion nga burime të ndryshme online.

Puna në grup:

- Bashkëpunon me të tjerët në projekte online, duke ndarë detyrat dhe duke arritur një qëllim të përbashkët.

Marrëdhëniet online:

- Demonstron etikë të mirë në komunikimet online (p.sh., respekton privatësinë e të tjerëve, shmang fjalët ofenduese).

4. Mendon dhe zgjidh probleme me teknologji:

Rezultati:

- Nxënësit do të demonstrojnë një kuptim të thellë të rolit të TIK-ut në ekonomi, duke identifikuar mjetet digjitale të përdorura në sektorë të ndryshëm dhe duke shpjeguar se si teknologjia kontribuon në rritjen e produktivitetit dhe të efikasitetit ekonomik.

Treguesit:

Kuptimi i rolit të TIK-ut në ekonomi:

- Shpjegon se si TIK-i ndikon në veprimtari ekonomike, si: tregjet digjitale, tregtia elektronike dhe komunikimi.

Konceptet bazë të ekonomisë digjitale:

- Shpjegon se si teknologjia rrit produktivitetin dhe efikasitetin ekonomik.

Mjetet digjitale në industri:

- Identifikon mjetet digjitale të zakonshme të përdorura në industri të ndryshme (p.sh., software për projektim, platforma për marketing digjital).

Zgjidhja e problemeve me teknologji:

- Propozon ide për përdorimin e teknologjisë për të zgjidhur probleme të caktuara në një biznes ose në një sektor ekonomik.

5. Respekton sigurinë dhe mbrojtjen brenda dhe jashtë shkollës:

Rezultati:

- Nxënësit do të demonstrojnë përgjegjësi ndaj sigurisë kibernetike, duke kuptuar rëndësinë e mbrojtjes së informacionit personal, duke identifikuar rreziqet online dhe duke praktikuar sjellje të sigurt në internet.

Treguesit:

Etika në përdorimin e TIK-ut:

- Respekton të drejtën e autorit dhe shmang plagjiaturën.
- Mbron privatësinë e të tjerëve dhe nuk ndan informacion personal pa leje.

Siguria e informacionit personal:

- Kupton rreziqet e ndarjes së informacionit personal me të huaj në internet.
- Vendos *password*-e të forta dhe unike për llogaritë e tij online.

Identifikimi i situatave të pasigurta:

- Njihet me taktikat e përdorura nga hakerat (p.sh., *phishing*, *malware*).
- Shmang klikimin në lidhje ose shkarkimin e skedarëve nga burime të panjohura.

Protokollet e sigorisë:

- Praktikon pozicion të mirë të trupit kur përdor pajisjet për të shmangur problemet shëndetësore.
- Kupton rëndësinë e bërjes së kopjeve rezervë të të dhënave të rëndësishme.

Përbërësit e kompetencave specifike që ndërton dhe zbaton nxënësi

Njohuri	Aftësi	Qëndrime
<i>Nxënësi ndihmohet të trajtojë situata që të fitojë njohuri për:</i> - pajisje kompjuterike; - teknologjinë <i>hardware</i> dhe <i>software</i>; - ndërveprimin në laboratorin e TIK-ut; - modelimin <i>input/output</i>; - programe editimi të përmbajtjes digjitale; - instruksione kompjuterike; - kodimin dhe të menduarit kompjuterik; - algoritme dhe bllok skema; - mbrojtjen e të dhënave personale; - parimet e qytetarisë digjitale dhe llojet e informacioneve; - sigurinë në internet.	<i>Nxënësi ndihmohet të trajtojë situata që e aftësojnë:</i> - të përdorë TIK me të cilin mbledh të dhëna për të arritur në një përfundim të bazuar në prova; - të hetojë natyrën përmes teknologjive; - të komunikojë zgjidhjet dhe arsyetimin që çuan në vendimin ose përfundimin e bazuar në provat që mbledh përmes TIK-ut; - të modifikojë krijimin ose përmbajtjen me mënyra të thjeshta; - të shkarkojë/të ngarkojë informacionin dhe përmbajtjen e klasifikuar.	<i>Nxënësi ndihmohet të trajtojë situata që të zhvillojë:</i> - kuriozitetin dhe entuziazmin për teknologjinë; - ndjenjën e përgjegjësisë për mbrojtjen e informacionit; - fleksibilitetin ndaj ndryshimeve në teknologji; - kuriozitetin për të dhënë zgjidhje inovative; - ndjeshmërinë për çështjet e shëndetit dhe të sigurisë; - rëndësinë e punës në grup dhe bashkëpunimit me nxënësit e tjerë; - zhvillimin e aftësive për të mësuar gjatë gjithë jetës; - integritetin në aksesin dhe përdorimin etik të informacionit.

10. METODOLOGJITË E TË MËSUARIT DHE TË NXËNIES⁽⁵⁾

Metodat e të mësuarit në AF i përfshijnë nxënësit në mënyrë aktive në procesin e të nxënës, duke nxitur pjesëmarrjen, bashkëpunimin dhe përvojat vetjake. Pavarësisht nga specifikat e lëndëve, organizimi i mësimit ka karakteristika të përbashkëta në rrafshin metodologjik. Mësuesit i ndihmojnë nxënësit të ndërtojnë/të përdorin njohuri të reja dhe kompetenca nëpërmjet një larmie “shtigjesh” pedagogjike. Njëherazi, ata përditësojnë kompetencat profesionale, që nxënësit të zhvillojnë dëshirën për dijen, virtytet njerëzore dhe ambicien për sukses në jetë. Në vijim, përshkruhen disa metoda efektive.

Të nxënit në bashkëpunim

⁽⁵⁾ Përdorimi i metodologjive efektive në kontekste konkrete mësimore kushtëzohet nga niveli që arrin zhvillimi i nxënësve, nga përmbajtja e temave mësimore, nga kushtet specifike të mjediseve shkollore etj. Për këto arsye, karakteristikat e përdorimit të metodologjive përshkruhen më hollësisht në programet lëndore dhe në udhëzuesit përkatës.

Punë në grup: Nxënësit punojnë së bashku në grupe të vogla për të përfunduar detyrat, për të zgjidhur probleme ose për të krijuar projekte. Kjo metodë nxit punën në grup, komunikimin dhe aftësitë e të menduarit kritik.

Mësimi me bashkëmoshatarët: Nxënësit i mësojnë njëri-tjetrit për një temë, duke përforcuar të kuptuarit, ndërkohë që ndihmojnë bashkëmoshatarët të mësojnë.

Metoda KVA (konkrete, vizuale, abstrakte)

Faza e veprimeve konkrete – nxënësit përdorin objekte fizike për të shqyrtuar dhe për të kuptuar konceptet shkencore dhe matematike.

Faza e përdorimit të vizualizimeve – përdoren diagrame, skica, grafikë ose vizatime për të ndihmuar lidhjen e mjeteve konkrete me kuptime më të përgjithshme.

Faza e abstragimit – nxënësit përdorin simbolet matematike dhe numrat për të zgjidhur problemet, pa pasur nevojë për objekte fizike ose vizualizime.

Të mësuarit që bazohet në kërkim

Të pyeturit: Nxitja e nxënësve që të bëjnë pyetje rreth temës dhe të eksplorojnë përgjigjet përmes kërkimit dhe hetimit.

Të nxënit e bazuar në problem: Prezantimi i nxënësve me probleme reale dhe udhëzimi për të gjetur zgjidhje mes kërkimit, eksperimentimit dhe të menduarit kritik.

Të mësuarit nga përvoja

Veprimtari praktike: Nxënësit angazhohen në veprimtari që përfshijnë manipulimin fizik të materialeve për të mësuar konceptet (p.sh., eksperimente, projekte artistike).

Udhëtime në terren: Marrja e nxënësve në udhëtime edukative në vende, si muzetë, fermat ose vendet historike, për të ofruar mundësi mësimi me përvojë.

Të mësuarit nëpërmjet lojës

Lojëra edukative: Përfshirja e lojërave në mësim për ta bërë mësimin argëtues dhe tërheqës. Këto mund të jenë lojëra digjitale, lojëra tavoline ose gara në klasë.

Simulimet dhe lojërat me role: Nxënësit marrin role dhe interpretojnë skenarë për të kuptuar ngjarjet historike, konceptet shkencore ose ndërveprimet shoqërore.

Integrimi i teknologjisë

Softuerë dhe aplikacione interaktive: Përdorimi i softuerit dhe i aplikacioneve edukative që ofrojnë përvoja mësimore interaktive dhe të personalizuar.

Projekte digjitale: Nxitja e nxënësve për të krijuar prezantime digjitale, video ose blogje për të demonstruar të kuptuarit e tyre për temat.

Të nxënit nëpërmjet qasjes STEM

STEM (Shkencë, Teknologji, Inxhinieri dhe Matematikë) synon zhvillimin e kompetencave eksperimentale, të menduarit kritik, zgjidhjen e problemeve dhe inovacionin përmes një qasjeje praktike dhe ndërdisiplinore. Karakteristikat kryesore të qasjes STEM:

Integrimi ndërdisiplinor: Lidhja e shkencës, teknologjisë, inxhinierisë dhe matematikës në kuadrin e një mësimi të bashkërenduar.

Përqendrim te zgjidhja e problemeve reale: Nxitja e aftësive përmes projekteve reale, si përcaktimi i kostove për ndërtimin e një sere.

Të nxënit përmes kërkimit dhe eksperimentimit: Stimulimi i motivimit dhe i kuriozitetit përmes hulumtimit aktiv dhe përvojave praktike.

Mësim në kontekst dhe me qasje ndërdisiplinore: Për shembull, krijimi i një roboti që kërkon aplikimin e njohurive nga disa fusha shkencore.

Zhvillimi i aftësive bashkëkohore: Aftësitë për kodim, analizë dhe dizajn trajtohen si thelbësore në epokën digjitale.

Promovimi i punës në grup dhe i krijimtarisë: Nxënësit përfshihen në ekipe për të bashkëpunuar në zgjidhjen e sfidave inovative.

Mësimi i diferencuar

Veprimtari të përshtatura: Projektimi i veprimtarive që plotësojnë nevojat dhe stilet e ndryshme të nxënies së nxënësve. Kjo mund të përfshijë ofrimin e niveleve të ndryshme të vështirësisë ose të mënyrave të ndryshme të përfshirjes.

Grupim fleksibël: Grupimi i nxënësve bazuar në nevojat e tyre mësimore dhe lejimi i tyre për të lëvizur ndërmjet grupeve ndërsa përparojnë.

Mësimi i bazuar në projekte

Projekte afatgjata: Nxënësit punojnë në projekte për një periudhë të gjatë, duke zbatuar atë që kanë mësuar për të krijuar diçka kuptimplote.

Projektet ndërdisiplinore: Përdorimi i njohurive që nxënësi ka ndërtuar në lëndë të ndryshme në një projekt të vetëm, për të ofruar një përvojë të mësuarit gjithëpërfshirës.

Zhvillimi i veprimtarive jashtëkurrikulare

Veprimtaritë jashtëkurrikulare janë veprimtari të strukturuar mësimore që ndodhin jashtë kontekstit të fushave dhe të lëndëve mësimore formale, por që ndihmojnë arritjen e kompetencave për shkallët e kurrikulës dhe nivelet e arsimit. Për secilën nga veprimtaritë e mundshme, shkolla duhet të përgatisë një plan dhe program të qëllimshëm, të orientuar e jo veprimtari të rastit. Mësimi në të gjitha lëndët e arsimit fillor do të mbështetet me anë të veprimtarive jashtëkurrikulare të organizuara, si:

- vizita në muze, parqe, vende historike, institucione, galeri, teatër etj.;
- veprimtari me raste festash të ndryshme;
- pjesëmarrje në grupet mësimore, në veprimtari të lira dhe në shoqata;
- diskutime me të ftuar (p.sh.: me drejtues të bashkisë, prindër, përfaqësues të bizneseve lokale, politikanë, njerëz të medias etj.);
- punë me projekte për tema dhe çështje specifike të karakterit me shumë dimensionë që përkojnë me moshën e nxënësve;
- organizime ekspozitash (p.sh., artet e bukura, fotografia);
- lojëra sportive, veprimtari artistike, revista ose gazeta e shkollës etj.

11. MATERIALE DHE BURIME MËSIMORE

Në AF, materialet dhe burimet mësimore janë thelbësore për mbështetjen e nxënies. Këto materiale krijohen për të angazhuar nxënësit, për të përmirësuar të kuptuarit e tyre dhe për të mësuar praktikisht. Më poshtë, paraqitet një grup i materialeve dhe i burimeve mësimore të përdorura në arsimin fillor.

Tekste shkollore

Tekste mësimore: Këto janë burime thelbësore që ofrojnë përmbajtje të strukturuar për lëndë, të tilla si: matematika, artet gjuhësore, shkenca, studimet sociale dhe historia.

Fletore pune: Shoqëroni tekstet shkollore dhe ofroni ushtrime dhe veprimtari që nxënësit të praktikojnë konceptet.

Ndihmësit pamorë

Grafikët, diagramet dhe posterat: Këto përdoren për të ilustruar konceptet kryesore, të tilla si: veprimet matematikore, proceset shkencore, afatet kohore historike ose rregullat e gramatikës së gjuhës.

Flashcards: Këto janë të dobishme për ndërtimin e fjalorit, faktet e matematikës dhe mësimin e gjuhës, duke i lejuar nxënësit të përputhin termat me përkufizimet ose të zgjidhin probleme të shpejta.

Infografika: Ndhmon në thjeshtimin e informacionit kompleks (p.sh. proceset, sekuencat) në formate vizuale.

Burimet digjitale

Uebfaqet dhe aplikacionet arsimore: Uebfaqet, si *Khan Academy*, *Google Classroom* ose aplikacionet interaktive të të mësuarit, ofrojnë video, ushtrime dhe lojëra që përforcojnë mësimet.

Burimet multimediale: Librat elektronikë interaktivë, kanalet arsimore në *YouTube* dhe udhëtimet virtuale në terren mund të sjellin mësim në jetë.

Tabelat e bardha digjitale (p.sh., tabelat SMART): Këto lejojnë mësim ndëreveprues ku nxënësit mund të përfshihen me përmbajtjen në një mënyrë dinamike dhe praktike.

Manipulime dhe materiale praktike

Manipulimet matematikore: Mjetet, si numërimi i blloqeve, blloqet me bazë 10, format gjeometrike dhe vijat numerike, i ndihmojnë nxënësit të kuptojnë konceptet matematike në një mënyrë të prekshme.

Komplete shkencore: Siguroni materiale për eksperimente, të tilla si syze zmadhuese, mikroskopë, komplete për rritjen e bimëve ose modele në shkallë të vogël të ekosistemeve ose të trupit të njeriut.

Furnizime arti: Materialet për vizatim, pikturë dhe punime, të tilla si shënjesht, lapsat me ngjyra, gërsërë, ngjitësi dhe letra, përdoren për të promovuar kuriozitetin në lëndë si arti dhe historia.

Bibliotekat e klasave

Libra me histori të imagjinuara (fiction) dhe me tregime reale (jofiction): Një gamë e literaturës së përshtatshme për moshën që nxit leximin dhe mbështet të kuptuarit dhe zhvillimin e fjalorit në lëndë, si: artet gjuhësore, studimet sociale dhe shkenca.

Librat burimorë: Jepni informacion shtesë për tema të ndryshme, të përdorura shpesh për kërkime ose për thellimin e njohurive në lëndë, si: historia, gjeografia dhe kultura.

Mjetet e të mësuarit ndëreveprues

Lojëra dhe enigma: Lojërat e tavolinës, lojërat me letra ose lojërat edukative kompjuterike mund të mësojnë matematikën, leximin dhe studimet sociale në një mënyrë argëtuese dhe tërheqëse.

Materiale për lojë me role dhe simulim: Lërin nxënësit të interpretojnë ngjarje historike, eksperimente shkencore ose situata sociale, duke nxitur përfshirjen dhe mirëkuptimin.

Fletët e veprimtarive: Fletët e punës për përforcimin e koncepteve në artet gjuhësore, matematikë, shkencë dhe lëndë të tjera.

Materiale të përgatitura nga mësuesi

Planet dhe njësitë mësimore: Materiale mësuesi të hartuara me kujdes, shpesh me veprimtari, vlerësime dhe projekte shoqëruese.

Mjetet e vlerësimit: Kuize, rubrika dhe modele vlerësimi formues për të matur të kuptuarit e nxënësve dhe për të udhëhequr udhëzimin.

Burimet audio

Këngët dhe vjershat: Veçanërisht për nxënësit më të vegjël, këngët dhe vjershat janë efektive për të mësuar përmendsh fjalorin, për të mësuar fakte matematike ose për të kuptuar ngjarjet historike.

Audiobooks dhe podcaste: Ndiemoni në zhvillimin e aftësive të të dëgjuarit dhe ofroni mënyra alternative për t'u përfshirë me tekste, veçanërisht për nxënësit që mund të kenë vështirësi me leximin.

Udhëtimet në terren dhe burimet e botës reale

Udhëtime në terren: Vizitat në muze, kopshte zoologjike, vende historike ose rezervate natyrore ofrojnë të mësuarit me përvojë.

Folësit e ftuar: Ftesat e ekspertëve, si historianët, shkencëtarët ose anëtarët e komunitetit lokal, pasurojnë përvojën e të mësuarit dhe sjellin kontekstin e botës reale në mësim.

Stacionet/këndet mësimore

Qendrat e mësimi të palëvizshëm dhe ndërveprues: Zonat në klasë të ngritura për aftësi të veçanta, të tilla si këndi i leximit, stacioni i matematikës ose stacioni i eksplorimit të shkencës, ku nxënësit mund të punojnë individualisht ose në grupe të vogla.

Përdorimi i një shumëllojshmërie të këtyre materialeve dhe të burimeve siguron që nxënësit të kenë mundësi të shumta për t'u përfshirë me përmbajtje në formate të

ndryshme, duke u kujdesur për stile të ndryshme të të mësuarit (pamor, dëgjimor, kineestetik) dhe duke rritur përvojën e tyre të përgjithshme të nxënies.

12. TEMAT NDËRKURRIKULARE

Temat ndërkurrikulare në AF janë identiteti kombëtar, qytetaria aktive dhe sipërmarrja, siguria dhe shëndeti mendor e fizik, identiteti kulturor dhe njohja e kulturave, zhvillimi i qëndrueshëm, teknologjia, media dhe shoqëria, pjesëmarrja në komunitet, edukimi global etj. Temat i nxitin nxënësit të lidhin fusha kurrikulare, që të ndërtojnë dhe të zhvillojnë njohuri, aftësi dhe qëndrime e t'i zbatojnë tej situatave në lëndë të veçanta.

- **Identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave.** Arsimi duhet t'u krijojë nxënësve mundësitë për të formuar identitetin e tyre kombëtar e kulturor, çka u jep mundësi atyre të kuptojnë zhvillimin e trashëgimisë kulturore kombëtare dhe të krijojnë një këndvështrim pranues të përvojave, kulturave dhe mënyrave të jetesës së minoriteteve etnike, kulturore dhe grupeve shoqërore.
- **Qytetaria aktive dhe sipërmarrja.** Kultivimi i tyre i përgatit nxënësit si qytetarë të shoqërisë së sotme dhe të nesërme që respektojnë të drejtat e tyre dhe të të tjerëve, të aftë për të menduar dhe për të vepruar në mënyrë konstruktive për mirëqenien vetjake, shoqërore dhe ekonomike, brenda komunitetit ndërkombëtar.
- **Shëndeti mendor e fizik dhe siguria.** Në këtë kontekst, çdo veprimtari kurrikulare duhet t'i shërbejë aftësisë së nxënësve për të ndërtuar e për të demonstruar sjellje shëndetësore për të parandaluar sëmundjet dhe rreziqet, për të vlerësuar shëndetin, për të ndihmuar të tjerët në situata të jashtëzakonshme etj.
- **Zhvillimi i qëndrueshëm dhe qëndrueshmëria mjedisore.** Kurrikula mundëson që nxënësit të zbulojnë sfidat e zhvillimit të qëndrueshëm në këndvështrime të ndryshme, të cilat kanë të bëjnë me ndikimet e veprimtarisë së njeriut mbi mjedisin, me ndryshimet klimatike dhe sfidat që i shoqërojnë, me problemet që lidhen me rritjen e popullsisë, varfërinë dhe urinë; burimet e ripërtërishme të energjisë dhe kursimin e saj etj.
- **Teknologjia, shoqëria dhe media.** Zhvillimi i teknologjisë bazohet në nevojën e njerëzve për të përditësuar cilësinë e jetës së tyre. Kurrikula e përditësuar duhet të zhvillojë te nxënësit aftësitë e përdorimit të TIK-ut, aftësitë e përdorimit të gjuhës shqipe dhe të gjuhëve të huaja. Vend kryesor në sigurimin e kulturës së komunikimit te nxënësit ka aftësimi i tyre për të përdorur median për përftimin e informacionit

dhe të shprehjes së tij. Gjithashtu, edukimi për përdorimin e mediave kërkon zhvillimin e aftësive verbale, pamore, dëgjuese, teknike dhe sociale të nxënësve etj.

13. KURRIKULA NË BAZË SHKOLLE

Kurrikula në bazë shkolle është pjesë e kurrikulës së arsimit parauniversitar që zgjidhet nga shkolla dhe zhvillohet brenda kohës së përcaktuar në planin mësimor, në përputhje me interesat, potencialet, njohuritë paraprake të nxënësve, mundësitë e shkollës, specifikat rajonale, kërkesat e aktualitetit.

Kurrikula në bazë shkolle ka si qëllim:

- të ofrojë lëndë/module të cilat nuk trajtohen në kurrikulën bërthamë;
- të ofrojë module me bazë temash ndërkurrikulare që kanë lidhje me problematikat shoqërore, kulturore dhe natyrore;
- të krijojë mundësi për zhvillimin e kurrikulës në nivel lokal;
- të nxitë të mësuarin me projekte.

Organizimi i kurrikulës në bazë shkolle

Kurrikula në bazë shkolle mund të planifikohet, të zhvillohet dhe të realizohet përmes një lënde të veçantë/moduli apo projekti kurrikular, të lidhur me fushat e nxënies/lëndët mësimore dhe temat ndërkurrikulare; mund të përfshijë veprimtari shtesë që ndihmojnë në zhvillimin e kompetencave, si: projekte, veprimtari sportive, artistike, klube etj. Kurrikula në bazë shkolle mund të organizohet në lëndë, modul kurrikular dhe projekt kurrikular.

Lënda mësimore i referohet organizimit didaktik të njohurive, aftësive, qëndrimeve dhe vlerave në një fushë të caktuar të kurrikulës që është me interes për nxënësit, komunitetin dhe shoqërinë.

Moduli kurrikular i referohet organizimit didaktik të njohurive, aftësive, qëndrimeve dhe vlerave për një tematikë të caktuar që është me interes për nxënësit, komunitetin dhe shoqërinë. Modulet kurrikulare mund të përfshijnë çështje të ndërlidhura me temat ndërkurrikulare, të tilla si: edukimi për të drejtat e njeriut; barazia gjinore; parandalimi dhe trajtimi i rasteve të dhunës përfshirë bullizmin etj.

Projekti kurrikular i referohet zhvillimit të njohurive, aftësive, qëndrimeve dhe vlerave në një fushë apo në disa fusha që janë me interes për nxënësit, komunitetin dhe

shoqërinë, përmes mësimi dhe nxënies hulumtuese, krijuese dhe zgjidhjes së problemeve të caktuara. Të tilla mund të jenë projektet kurrikulare që nxisin zbatimin e qasjes STEM, projekte për shprehjen artistike përmes vizatimit, pikturës, dramatizimit dhe shfaqjeve artistike, projekte për zhvillimin e aftësive motorike, koordinimin dhe promovimin e aftësisë fizike përmes lojërave, sporteve dhe ushtrimeve, projekte për të njohur natyrën, ekologjinë dhe rëndësinë e ruajtjes së mjedisit etj.

Planifikimi dhe metodologjia e zhvillimit të kurrikulës në bazë shkolle

Vendimi për përcaktimin e kurrikulës në bazë shkolle del si rezultat i një procesi konsultativ që përfshin nxënësit, prindërit, shkollën dhe institucionin arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar. Partnerë të fuqishëm në zhvillimin e kurrikulës në bazë shkolle janë prindërit dhe përfaqësues të tjerë të komunitetit. Për të gjitha format e organizimit të kurrikulës në bazë shkolle, shkolla duhet të hartojë apo të përshtatë programe mësimore të sugjeruara nga ministria përgjegjëse për arsimin dhe ASCAP-i.

Një modul kurrikular ose një projekt kurrikular mund të planifikohen jo më pak se 10 orë në vit. Në rastet kur në kurrikulën në bazë shkolle planifikohen të zhvillohen module kurrikulare, këto module mund të përzgjidhen nga lista e ofruar nga ministria përgjegjëse për arsimin dhe ASCAP-i, ose module të hartuara nga shkolla dhe të miratuara nga institucioni arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar. Nëse në kurrikulën në bazë shkolle përzgjidhet të zhvillohet një projekt kurrikular, duhet që ky projekt të jetë me karakter integruës detyrimisht. Përgjegjësinë për mbarrëvajtjen e projektit e ka shkolla, pikërisht mësuesi i klasës/ekipi i mësuesve që është ngarkuar për zhvillimin e projektit dhe drejtorja e shkollës e cila cakton dhe ngarkesën mësimore të secilit mësues të përfshirë në projekt.

Projekti kurrikular që mund të zhvillohet në kurrikulën në bazë shkolle nuk u mbivendoset dhe nuk i përjashton projektet kurrikulare që janë pjesë e detyrimit për t'u zhvilluar nga nxënësit në çdo lëndë. Disa ndër karakteristikat kryesore që duhen mbajtur parasysh në planifikimin dhe zhvillimin e kurrikulës në bazë shkolle përfshijnë:

- *Qëllimet/rezultatet e të nxënësve:* Përcaktohen rezultatet që duhet të arrijnë nxënësit gjatë zhvillimit të lëndës mësimore/modulit ose projektit kurrikular.
- *Struktura e veprimtarive:* Përshkruhen veprimtaritë që do të zhvillohen gjatë lëndës mësimore/modulit ose projektit kurrikular.

KURRIKULA BËRTHAMË E ARSIMIT FILLOR (E PËRDITËSUAR)

- *Materialet dhe burimet:* Specifikohen burimet dhe materialet mësimore (libra, video, softuerë etj.) që do të përdoren për të ndihmuar veprimtaritë.
- *Metodologjitë mësimore:* Identifikohen metodat/strategjitë mësimore (praktikat mësimore, proceset, procedurat, diskutimet etj.) që do të përdoren për të ndihmuar nxënësit në arritjen e qëllimeve.
- *Vlerësimi:* Specifikohen mënyrat e vlerësimit të rezultatit të nxënies, përfshirë detyrat dhe vlerësimin e përgjithshëm të performancës së nxënësve.

Lëndët/modulet ose projektet kurrikulare që zhvillohen në kurrikulën në bazë shkolle, nuk vlerësohen me notë. Në përfundim të tyre shënohet simboli për realizimin.

Për realizimin e kurrikulës në bazë shkolle duhet të përdoren metodologji që burojnë nga parimet e kurrikulës. Orët e kurrikulës në bazë shkolle janë të planifikuara për t'u zhvilluar në mjedise mësimore, nën drejtimin e mësuesit ose të mësuesve dhe shënohen në regjistrë sikundër orët e tjera mësimore.

14. LËNDËT MËSIMORE QË INTEGROJNË FUSHAT KURRIKULARE

Në arsimin fillor, lëndët mësimore sipas fushave kurrikulare janë:

FUSHA KURRIKULARE	LËNDA MËSIMORE
GJUHËT DHE KOMUNIKIMI	Gjuhë shqipe
	Gjuhë angleze
MATEMATIKA	Matematikë
SHKENCAT E NATYRËS	Dituri natyre
SHKENCAT SHOQËRORE	Qytetari
	Histori
ARTE	Muzikë
	Art pamor
	Kërcim
	Teatër
EDUKIMI FIZIK, SPORTI DHE SHËNDETI	Edukim fizike, sporti dhe shëndeti
TEKNOLOGJIA DHE TIK-u	TIK

15. PROGRAMI LËNDOR

Për çdo lëndë mësimore përgatitet **programi lëndor**. Në kontekstin e kurrikulës së përditësuar, programi lëndor përbëhet nga **seksione** të konceptuara që procesi mësimor të ketë në qendër njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet të cilat nxënësit duhet të ndërtojnë e të përdorin për të qenë të suksesshëm në mjediset që kërkojnë zgjidhje të problemeve dhe bashkëpunim, njëkohësisht dhe një sistem vlerësimi që mat arritjet e nxënësve në funksion të kompetencave.

Në vijim, paraqitet një strukturë e programit lëndor që mund të përdoret për hartimin e programeve të lëndëve mësimore. Kjo strukturë synon të jetë gjithëpërfshirëse dhe e dobishme për hartuesit e teksteve shkollore dhe për mësuesit në organizimin e procesit mësimor.

Programi i lëndës _____

1. Hyrja dhe konteksti

Prezantimi i kontekstit arsimor: Qasja e përgjithshme dhe rëndësia e lëndës në kurrikulën e përgjithshme.

Synimet kryesore të programit lëndor: Objektivat kyç që pritet të arrihen.

Shpjegimi i qasjes që bazohet në kompetenca: Përkufizimi dhe shtjellimi i kompetencave që duhet të zhvillojnë nxënësit.

Parimet themelore pedagogjike: Orientime pedagogjike për zbatimin praktik të qasjes pedagogjike që bazohet në kompetenca.

2. Kompetencat e synuara dhe rezultatet e të nxënit

Përshkrimi i kompetencave kyç dhe specifike: Kompetencat që nxënësit duhet të ndërtojnë dhe të përdorin.

Deklarata e pritshmërive nga nxënia: Rezultatet e nxënies që priten.

3. Përshkrimi i përmbajtjeve

Temat: Përshkrimi i temave që do të shtjellohen në lëndë.

Struktura dhe ndërthurja e kapitujve/moduleve: Si janë strukturuar kapitujt / modulet dhe si ndërthuren me njëri-tjetrin.

4. Strategjitë mësimore

Qasjet dhe metodat e rekomanduara: Metodatat që ndihmojnë nxënësit të ndërtojnë njohuri, aftësi dhe qëndrime.

Strategjitë ndërvepruese dhe praktike: Sugjerohen strategji që vendosin nxënësit në qendër për të bërë mësimin më efektiv.

5. Veprimtari dhe projekte mësimore

Veprimtari dhe ushtrime praktike: Përshkrimi i veprimtarive konkrete që do të realizohen gjatë orëve mësimore.

Shembuj të veprimtarive: Veprimtari që lejojnë nxënësit të zbatojnë kompetencat në kontekste reale ose të stimuluar.

6. Kriteret dhe metodat e vlerësimit

Kriteret e vlerësimit: Përcaktimi i kriterëve për të vlerësuar përparimin e nxënësve.

Metodat e vlerësimit formues dhe përmbledhës: Vlerësimi i vazhdueshëm dhe përfundimtar i arritjeve të nxënësve, duke konsideruar me përparësi projektet.

7. Lidhja ndërdisiplinore

Qasjet ndërlëndore: Mënyra se si lënda mund të integrohet me lëndë të tjera përmes situatave mësimore dhe projekteve.

Sugjerime të pajisjeve dhe të platformave: Mbështetje teknologjike për ndërtimin e kompetencave.

8. Përshtatja me nevojat specifike të nxënësve

Përshtatja e mësimi: Qasjet për të përshtatur mësimin me nevojat e nxënësve.

Metodat e diferencimit: Rekomandohen metoda për të ndihmuar nxënësit me stile të ndryshme të nxënies.

9. Burimet dhe pajisjet didaktike

Burimet për të mësuar: Libra, kompjuterë, tableta, projektorë që përdoren në mësim.

Aplikacione dhe platforma edukative: Burime për eksperimente/simulime virtuale.

10. Plani i mësimeve

Kalendari mësimor: Planifikimi i temave që do të mbulohen gjatë periudhave të caktuara.

Udhëzime për orë mësimore: Rekomandime didaktike për organizimin e orëve të mësimi.

11. Ndërthurja me teknologjinë

Integrimi i teknologjisë: Udhëzime për përdorimin e teknologjisë në mësim.

Burimet digjitale: Lista e burimeve digjitale që mund të përdoren, si: inteligjenca artificiale, aplikacione të realitetit virtual (VR) ose të shtuar (AR).

16. PLANI MËSIMOR: KOHA MËSIMORE PËR FUSHAT KURRIKULARE DHE LËNDËT

Nr.	FUSHA KURRIKULARE	KLASA				
		I	II	III	IV	V
1	GJUHËT DHE KOMUNIKIMI	43.4	43	38	33	33
2	MATEMATIKË	17.4	17	17	16	16
3	SHKENCAT E NATYRËS	4.3	4	4	8.2	8.2
4	SHKENCAT SHOQËRORE	4.3	4	4	8.2	8.2
5	ARTE	9	11	11	10.2	10.2
6	EDUKIMI FIZIK, SPORTI DHE SHËNDETI	13	13	13	12.2	12.2
7	TEKNOLOGJI DHE TIK	4.3	4	9	8.2	8.2
8	KURRIKULA NË BAZË SHKOLLE	4.3	4	4	4	4
	TOTALI	100%	100%	100%	100%	100%

Nr.	FUSHA/LËNDËT	KLASAT				
		I	II	III	IV	V
1	GJUHËT DHE KOMUNIKIMI	10	10	9	8	8
1.1	Gjuhë shqipe	8	8	6	5	5
1.2	Gjuhë Angleze	2	2	3	3	3
2	MATEMATIKË	4	4	4	4	4
2.1	Matematikë	4	4	4	4	4

KURRIKULA BËRTHAMË E ARSIMIT FILLOR (E PËRDITËSUAR)

3	SHKENCAT E NATYRËS	1	1	1	2	2
3.1	Dituri natyre	1	1	1	2	2
4	SHKENCAT SHOQËRORE	1	1	1	2	2
4.1	Qytetari	1	1	1	1	1
4.2	Histori				1	1
5	ARTE	2	2.5	2.5	2.5	2.5
5.1	Muzikë	1	1	1	1	1
5.2	Art pamor	1	1	1	1	1
5.3	Kërcim		0.5	0.5	0.5	
5.4	Teatër					0.5
6	EDUKIMI FIZIK, SPORTI DHE SHËNDETI	3	3	3	3	3
6.1	Edukim Fizik, Sporti dhe Shëndeti	3	3	3	3	3
7	TEKNOLOGJI DHE TIK	1	1	2	2	2
7.1	TIK	1	1	1	1	1
7.2	Aftësimi teknologjik praktik			1	1	1
	KURRIKULA BËRTHAMË (FUSHAT 1 - 7)	22	22.5	22.5	23.5	23.5
8	KURRIKULA NË BAZË SHKOLLE	1	1	1	1	1
	TOTALI (ORË JAVORE)	23	23.5	23.5	24.5	24.5

Shkolla do t'u mundësojë nxënësve të kalojnë minimumin e kohës mësimore të përcaktuar në planin mësimor. Për nxënësit me vështirësi në të nxënë dhe ata që i tejkalojnë pritshmëritë e parashikuara në programet lëndore, shkolla të organizojë mësim plotësues mbi minimumin e përcaktuar me planin mësimor. Mbi këtë minimum, mund të përcaktojnë orë mësimore dhe për veprimtari jashtëkurrikulare. Për praktikën e shfrytëzimit të kohës mësimore mbi minimumin e kohës së përcaktuar me plan mësimor, shkollat mund të vendosin në bashkëpunim me prindërit, nxënësit, autoritetet lokale të arsimit dhe palët e tjera të interesit, që shfrytëzimi i kësaj kohe mësimore t'u shërbejë nxënësve për zotërimin e kompetencave.

17. VLERËSIMI I ARRITJEVE TË NXËNËSIT⁽⁶⁾

⁽⁶⁾ Qëllimet, mjetet, kriteret dhe instrumentet për vlerësimin e arritjeve të nxënies përshkruhen hollësisht në programet lëndore për klasat përkatëse.

Vlerësimi i arritjeve të nxënësve është proces sistematik që përfshin mbledhjen e të dhënave (matjen - assessment) dhe interpretimin e tyre për të gjykuar arritjen e RN-ve nga nxënësi.

Vlerësimi në AF-në realizohet nëpërmjet një procesi gjatë të cilit mësuesi dhe/ose drejtuesi i shkollës, bazuar në të dhënat e mbledhura nëpërmjet matjeve, gjykojnë bazuar në kritere të caktuara për arritjen e RN-ve të paraqitur në dokumentacionin kurrikular.

Qëllimi është përmirësimi i përparimit të nxënësve dhe i procesit mësimor, çka kërkon sigurimin e të dhënave për të analizuar dhe për të vlerësuar arritjet. **Praktikat e vlerësimit ndikojnë fuqishëm në procesin e të nxënësve.** Vlerësimi duhet të fillojë nga përditshmëria në klasë, duke vëzhguar, matur dhe vlerësuar përparimin e nxënësit. Vlerësimi, duke iu referuar kritereve të përbashkëta, i jep vlerë produktit të nxënësve.

Vlerësimi i rregullt i arritjeve të nxënësve është një akt edukativ. Ai mundëson rregullimin e mësimin dhe i lejon mësuesit të identifikojë:

- Rregullime që nxisin çdo nxënës të jetë i përfshirë dhe të përparojë në mësim.
- Ndhimën e duhur që përforcon arritjet fillestare të nxënësit.
- Situatat që ngjallin dëshirën për të mësuar më shumë.

Vlerësimi i nxënësve bazohet në dokumentet e përcaktuara më poshtë⁽⁷⁾:

DOKUMENTE KURRIKULARE	ARRITJET E TË NXËNI
KURRIKULA BËRTHAMË	Arritje që dëshmojnë se nxënësi i ka plotësuar RN-të e caktuara për çdo fushë kurrikulare.
PROGRAMET LËNDORE	Arritje që dëshmojnë se nxënësi i ka plotësuar RN-të e caktuara për çdo lëndë (nga klasa I - V).

Nxënësve u bëhen dy lloj vlerësimesh, nga klasa I deri në fundin e klasës V:

- **Vlerësimi i brendshëm** (vlerësimi i vazhduar, përshkrues dhe përfundimtar).
- **Vlerësimi i jashtëm** (në fund të klasës V me VANAF).

⁽⁷⁾ Karakteristikat e veçanta të çdo lloj vlerësimi dhe procedurat e realizimit të procesit paraqiten në programet e lëndëve të veçanta.

KURRIKULA BËRTHAMË E ARSIMIT FILLOR (E PËRDITËSUAR)

Në tabelë janë përmbledhur llojet e vlerësimit për të çmuar arritjet e nxënësve në lëndët e çdo fushe kurrikulare.

LLOJET	KOHA	REALIZUESI	QËLLIMI	DOKUMENTIMI
Vlerësimi diagnostikues	Në fillim të vitit shkollor	Mësuesi i AF dhe mësuesi i profilit	Ndihmon mësuesit të përshtatin udhëzimet për të përmbushur nevojat e çdo nxënësi	Planet individuale për çdo nxënë. Shënimet e mësuesit.
Vlerësimi formues	Gjatë vitit shkollor	Mësuesi i AF dhe mësuesi i profilit	Ndihma për nxënësit. Informimi dhe raportimi.	Shënimet e mësuesve në klasat I-III. Për klasat IV - V notat në SMIP.
Vlerësimi përshkrues	Në fundin e çdo periudhe mësimore	Mësuesi i AF dhe mësuesi i profilit	Informim dhe raportim. Vlerësim përshkrues (klasat I-III) dhe me notë (klasat IV-V) në fundin e periudhës.	Vlerësimit përshkrues (klasat I-III) dhe me notë (klasat IV-V) në SMIP.
Vlerësimi përmbledhës	Në fund të vitit shkollor	Mësuesi i AF dhe mësuesi i profilit	Vlerësim përmbledhës (klasat I-III) dhe me notë (klasat IV-V) në fund të vitit shkollor. Informimi dhe raportimi. Planifikimi për mbështetjen e nxënësve në vitin vijues.	Pasqyrimi i vlerësimit përshkrues (klasat I-III) Pasqyrimi i notave vjetore në SMIP (klasat IV-V). Vlerësimet në dëftesën elektronike të nxënësit.
Vlerësimi kombëtar (VANAF)	Në fund të klasës V	Ministria përgjegjëse për arsimin	Vlerësimi i kompetencave specifike dhe kyç. Informim dhe raport për prindërit dhe organet eprore.	Testet e nxënësve

Ja një përmbledhje e llojeve të vlerësimeve dhe e qëllimeve të tyre:

Vlerësimi diagnostikues:

Qëllimi: Mat njohuritë dhe aftësitë e nxënësve, në nisje të vitit shkollor.

Reagimi: Përgatit udhëzimet për të përmbushur nevojat e çdo nxënësi.

Vlerësimi formues:

Qëllimi: Monitorimi i vazhdueshëm i përparimit të nxënësve gjatë vitit shkollor.

Reagimi: Ofron reagime të menjëhershme për arritjet e nxënësve dhe ndihmon mësuesit të identifikojnë pikat e forta dhe ato që kanë nevojë për përmirësim.

Vlerësimi përshkrues:

Qëllimi: Ofron komente të hollësishme për performancën dhe përparimin e nxënësve pas çdo periudhe mësimore.

Reagimi: Përmbledh aftësitë, njohuritë dhe qëndrimet që janë zhvilluar dhe identifikon fushat që kanë nevojë për zhvillim të mëtejshëm.

Vlerësimi përmbledhës:

Qëllimi: Kryhet në fund të njësisë ose vitit shkollor për vlerësimin e përgjithshëm.

Reagimi: Jep një vlerësim përfundimtar, duke përmbledhur performancën e nxënësve, siç janë provimet përfundimtare ose testet gjithëpërfshirëse.

Vetëvlerësimi dhe vlerësimi i shokëve:

Qëllimi: Nxitet nxënësi të reflektojë mbi punën e tij dhe të komentojë për shokët.

Reagimi: Zhvillon aftësitë e mendimit kritik dhe vetëdijes, duke krijuar një mjedis bashkëpunues mësimor.

Vlerësimet kombëtare:

Qëllimi: Teste të standardizuara për të vlerësuar kompetencat në fusha kryesore, si: gjuha shqipe, matematika dhe shkencat.

Reagimi: Jep të dhëna për performancën e nxënësve kundrejt standardeve kombëtare.

Pasqyrimi i vlerësimeve: Në klasat I-III, arritjet vlerësohen me përshkrim dhe pasqyrohen në regjistrin elektronik me kodet 1-5. Në klasat IV-V, vlerësimi bëhet me notë dhe pasqyrohet në regjistrin elektronik. Tabela përshkruan lidhjet mes niveleve të arritjeve të nxënësit dhe vlerësimeve me notë.

NIVELI	PËRSHKRIMI I ARRITJES SË NXËNËSIT	NOTA
Niveli 5	<i>Demonstrim shumë i mirë:</i> Mendon në mënyrë kritike dhe zgjidh probleme me krijimtari dhe i pavarur.	Nota 10: Shkëlqyeshëm Nota 9: Shumë mirë
Niveli 4	<i>Demonstrim i mirë:</i> Siguron arritje të qëndrueshme nëpërmjet zbatimit të koncepteve dhe ideve.	Nota 8: Mirë Nota 7: Përgjithësisht mirë
Niveli 3	<i>Demonstrim i kënaqshëm:</i> Ka nevojë për ndihmë që të zbatojë saktë njohuritë dhe aftësitë e kërkuara.	Nota 6: Mjaftueshëm
Niveli 2	<i>Demonstrim i mjaftueshëm:</i> I duhet ofruar mbështetja për të zbatuar njohuritë dhe aftësitë e duhura.	Nota 5: Kalueshëm
Niveli 1	<i>Demonstrim i pamjaftueshëm:</i> Kërkoet ndërhyrje/ndihmë intensive për përmirësimin e arritjes.	Nota 4: Dobët

18. FJALORI TERMINOLOGJIK

TERMI SHQIP	TERMI ANGLISHT	KUPTIMI I TERMIT
Aftësi	<i>Ability</i>	Kapaciteti ose potenciali natyror për të kryer detyra të caktuara fizike, mendore ose artistike, jo medoemos të zhvilluara, por që mund të përmirësohet përmes trajnimit. Aftësitë, shpesh, janë të qenësishme dhe mund të jenë më të gjera, si: aftësia njohëse, zhdërvjelltësia fizike ose talenti muzikor.
Shkathtësi	<i>Skill</i>	Kapacitet që mund të mësohet dhe të zhvillohet përmes praktikës dhe trajnimit. Për shembull, kodimi, luajtja e pianos ose të folurit publik. Aftësitë shpesh janë specifike për detyrat dhe mund të përmirësohen me kalimin e kohës.
Alfabetizim digjital	<i>Digital literacy</i>	Alfabetizimi digjital i referohet aftësisë për të përdorur, për të vlerësuar dhe për të menaxhuar teknologjinë digjitale në mënyrë efektive dhe të përgjegjshme.
Arsim	<i>Education</i>	Procesi i përvetësimit të njohurive, aftësive, vlerave dhe qëndrimeve gjatë jetës, që zhvillohet në mjedise të ndryshme formale dhe/ose joformale.
Arsim bazë	<i>Basic education</i>	Nivelit themelor i arsimit që njerëzit marrin gjatë viteve të tyre të hershme. Ai përfshin njohuritë dhe aftësitë thelbësore të nevojshme për zhvillimin personal, pjesëmarrjen sociale dhe nxënien e mëtejshme.

KURRIKULA BËRTHAMË E ARSIMIT FILLOR (E PËRDITËSUAR)

Arsim dhe formim profesional	<i>Vocational education and training</i>	Arsimi që u mundëson njerëzve të fitojnë dhe të përdorin njohuri dhe kompetenca për punë dhe kualifikime profesionale për profesione të caktuara, krahas kompetencave kryesore të përcaktuara në kornizën Kurrikulare.
Arsim formal	<i>Formal education</i>	Arsim i institucionalizuar, i qëllimshëm, i planifikuar, i strukturuar në mënyrë hierarkike, nga niveli parashkollor deri në atë pasuniversitar. Rezultatet dhe kualifikimet në arsimin formal njihen me certifikata dhe diploma.
Arsim gjithëpërfshirës	<i>Comprehensive education</i>	Arsimi që ofrohet nga një sistem arsimor tek të gjithë nxënësit, në zbatim të parimit se arsimi është një e drejtë themelore e njeriut dhe themeli i një shoqërie më të drejtë dhe më të barabartë.
Arsimi parashkollor	<i>Preschool education</i>	Arsimi parashkollor i cili synon zhvillimin shoqëror, intelektual e fizik të çdo fëmije, ushtrimin e rregullave themelore të sjelljes e të higjienës, kultivimin e vlerave, si dhe përgatitjen për arsimin fillor. Përfshin moshën nga 3 deri në 6 vjeç.
Arsim fillor	<i>Primary education</i>	Arsim të cilin nxënësi e merr në klasën përgatitore dhe gjatë pesë viteve të para të shkollimit dhe që integron njohuri, aftësi dhe qëndrime themelore në lexim, shkrim dhe matematikë (p.sh., shkrim-lexim dhe numërim), si dhe vendos bazat për të mësuarit e mëtejshëm në arsimin e mesëm të ulët (AMU).
Arsim i mesëm i ulët	<i>Lower secondary education</i>	Arsim të cilin nxënësi e merr në klasat 6-9 me të cilin ai konsolidon bazën për të nxënë gjatë gjithë jetës dhe për t'u arsimuar në nivelet e tjera arsimore.
Arsim i mesëm i lartë	<i>Higher Secondary education</i>	Arsim të cilin nxënësi e merr në klasat 10-12 dhe i shërben për të ndërtuar një profesion ose për të vijuar arsimin e lartë. Programet mësimore u ofrojnë nxënësve përmbajtje më të larmishme dhe më të thelluara sesa programet në nivelin e arsimit të mesëm të ulët.
Arritja e nxënësit	<i>Student achievement</i>	Arritja e nxënësit njësohet me performancën reale të nxënësit dhe tregon nivelin e zotërimit të njohurive, të aftësive dhe të qëndrimeve të fituar dhe zbatuara prej tij.
Autonomi e shkollës	<i>School autonomy</i>	E drejtë e garantuar shkollës që të vendosë për hartimin dhe zbatimin e kurrikulës në bazë shkolle, për vlerësimin, menaxhimin e burimeve njerëzore, materiale dhe financiare në dispozicion, në kontekstin e kurrikulës zyrtare. Autonomia lidhet me llogaridhënien.
Burim për të nxënë	<i>Learning Resource</i>	Materialet e shtypura, jo të shtypura dhe online që mbështetin dhe përmirësojnë, drejtpërdrejt ose tërthorazi, nxënien dhe të mësuarit. Janë të jashtme (mësuesi, shokët, përmbajtjet e programeve apo tekstet, mjete didaktike etj., me të cilët nxënësi bashkëvepron, kur trajton situatat) dhe të brendshme (njohuri, aftësi, qëndrime etj.).
Burim konjitiv	<i>Cognitive resource</i>	Tërësi e njohurive që ka ndërtuar nxënësi (trashëgimia njohëse e tij); ndryshe, njohuri vetjake dhe/ose shoqërore që ai i aktivizon dhe i përdor për trajtimin e situatave.
Burim fizik	<i>Physical resource</i>	Kapacitet për të përdorur fizikun njerëzor (qëndrueshmëria kardiovaskulare/respiratore, forca,

KURRIKULA BËRTHAMË E ARSIMIT FILLOR (E PËRDITËSUAR)

		fleksibiliteti, fuqia, shpejtësia, koordinimi, aftësia, ekuilibri dhe saktësia) dhe mjetet fizike për të kryer operacione dhe funksione.
Dije	<i>Knowledge</i>	Njohuri e arsyetuar dhe e provuar si e vërtetë nga komuniteti i kërkuesve sipas kriterëve të përcaktuara, e kodifikuar në tekstet mësimore, shkollore apo në vepra të specializuara, si produkt i një ose disa shkencëtarëve. Dija është koncept shoqëror.
Nxënie elektronike	<i>E-Learning</i>	Të gjitha format e mëimit dhe të nxënies të bazuar në kompjuter dhe internet që përfshijnë përvetësimin dhe zbatimin e njohurive dhe të aftësive. Mund të zhvillohet brenda ose jashtë klasës. Shpesh është komponent thelbësor i arsimit në distancë duke përfshirë mjediset e të mësuarit virtual.
E-Portofoli	<i>E-Portfolio</i>	Mjet digjital që paraqet punën, arritjet dhe reflektimet e një nxënësi. Përdoret shpesh për vlerësimin dhe demonstrimin e kompetencave të ndërtuara.
Edukimi për sipërmarrje	<i>Entrepreneurship education</i>	Edukimi që synon zhvillimin e zotësisë për të shfrytëzuar idetë dhe mundësitë për t'i shndërruar ato në vlera për të tjerët.
Edukimi për zhvillim të qëndrueshëm	<i>Education for sustainable development</i>	Procesi i zhvillimit të njohurive, aftësive dhe qëndrimeve nga nxënësit, të nevojshme këto për të trajtuar sfidat globale, përfshirë ndryshimet klimatike, humbjen e biodiversitetit, përdorimin jo të qëndrueshëm të burimeve dhe pabarazinë.
Inteligjencë artificiale	<i>Artificial intelligence</i>	Simulimi i proceseve të inteligjencës njerëzore nga makinat, sidomos sistemet kompjuterike. Këto procese përfshijnë të mësuarit (fitimin e informacionit dhe të rregullave për përdorimin e tij), arsyetimin (përdorimin e rregullave për të arritur në përfundime të përafërta ose të sakta) dhe vetëkorrigjimin. Shembujt: <i>Google Assistant, Siri dhe Alexa</i> .
Fushë e nxënies/të nxënit	<i>Learning area</i>	Grup lëndësh të ndërlidhura që u ofrojnë nxënësve përmbajtje dhe situata mësimore që ata i trajtojnë për të ndërtuar/përdorur njohuri të reja dhe kompetenca.
Kodim kompjuterik	<i>Computer coding</i>	Procesi i dizajnit, shkrimit, testimit dhe mirëmbajtjes së kodit burimor ose udhëzimeve për kompjuterin, për të interpretuar gjuhët njerëzore.
Kompetencë	<i>Competency</i>	Kapacitet vetjak që kombinon njohuri, aftësi dhe qëndrime dhe i mundëson personit të trajtojë dhe të zgjidhë saktë situatat jetësore.
Kompetenca kyç	<i>Key competences</i>	Kapaciteti i personit për të zbatuar në mënyrë efektive njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet në fusha specifike.
Koncept	<i>Concept</i>	Strukturë mendore që personi e ndërton për të përfaqësuar në vetëdije tipare/veti/karakteristika të qenësishme dhe të përbashkëta të një kategorie objektivsh/dukurish/procesesh. Koncepti shprehet/paraqitet me simbole (fjalë, shenjë, grafikë etj.).

KURRIKULA BËRTHAMË E ARSIMIT FILLOR (E PËRDITËSUAR)

Kurrikul	<i>Curriculum</i>	Tërësia e parimeve, vlerave, qëllimeve të pranuar shprehërore mbi bazën e të cilave përcaktohen njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet që duhet të ndërtojnë nxënësit përmes arsimimit dhe mënyra e organizimit dhe e shtjellimit të përmbajtjeve mësimore.
Kurrikul bazuar në kompetenca	<i>Competency based curriculum</i>	Kurrikul që përqendrohet në zhvillimin e njohurive, aftësive dhe qëndrimeve nga nxënësit për të përballuar sfidat e jetës reale. Kjo lloj kurrikule u jep përparësi kompetencave të ndryshme në vend të njohurive teorike.
Kornizë kurrikulare	<i>Curriculum framework</i>	Dokumenti me të cilin paraqiten parimet e përgjithshme ku mbështetet kurrikula, synimet e përgjithshme arsimore, fushat kurrikulare dhe qëllimet e tyre të përgjithshme, temat ndërkurrikulare, parimet e mësimimit dhe të nxënimit efektiv, si dhe ato të vlerësimit.
Kurrikul bërthamë	<i>Core curriculum</i>	Tërësia e njohurive, aftësive dhe qëndrimeve që pritet të mësohen nga të gjithë nxënësit, të organizuara në fusha të nxëni dhe në lëndë mësimore si gjuhët, matematika, artet, edukimi fizik, shkenca e natyrës dhe shkencat sociale, që janë të detyrueshme për t'u zhvilluar me të gjithë nxënësit.
Kurrikul në bazë shkolle	<i>School based curriculum</i>	Grup i caktuar kursesh/projektesh që ndërton shkolla për të përmbushur nevojat arsimore të komunitetit të shkollës. Ajo planifikohet dhe realizohet si lëndë e veçantë, modul ose projekt mësimor që përmbajnë tema apo kapituj të lidhur me një fushë të nxëni/lëndë mësimore, temë ndërlëndore.
Kurrikul e përvetësuar	<i>Acquired curriculum</i>	Njohuritë e reja dhe kompetencat që nxënësit demonstrojnë në fund të një programi kurrikular ose një niveli arsimor.
Kurrikul me zgjedhje	<i>Elective curriculum</i>	Kurset ose lëndët nga të cilat nxënësit mund të zgjedhin sipas interesave dhe nevojave të tyre. Kjo kurrikul zakonisht ofrohet në arsimin e mesëm dhe të lartë dhe plotëson kurrikulën bazë që duhet të ndjekin të gjithë nxënësit. Zgjedhja e lëndëve në kuadrin e kurrikulës me zgjedhje mund të jetë e detyrueshme ose e lirë, në varësi të planit mësimor.
Lëndë mësimore	<i>Subject content</i>	U referohet materialit, temave, tematikave dhe informacionit të shtjelluar brenda një lëndë të caktuar ose një kursi studimi. Përfshin të gjitha njohuritë, aftësitë, konceptet dhe veprimtaritë që synohet të mësohen dhe të zhvillohen në atë lëndë.
Llogaridhënie në arsim	<i>Accountability in education</i>	Përgjegjëshmëria dhe llogaridhënia e institucioneve arsimore dhe e aktorëve të tjerë të interesuar në arsim ndaj cilësisë dhe rezultateve të pritshme e të shpallura të arsimimit në lidhje me nevojat e nxënësve dhe të shoqërisë.
Mendim kritik	<i>Critical thinking</i>	Kapacitet mendor (aftësi kryesisht) për të analizuar, për të vlerësuar dhe për të sintetizuar informacionin në mënyrë logjike dhe sistematike. Me ndihmën e tij, personi analizon, sintetizon, kupton dhe vlerëson në mënyrë aktive dhe me mjeshhtëri informacionin e mbledhur nga vëzhgimi, përvoja, reflektimi, arsyetimi ose komunikimi. Është aftësi thelbësore për zgjidhjen e problemeve, vendimmarrjen dhe

KURRIKULA BËRTHAMË E ARSIMIT FILLOR (E PËRDITËSUAR)

		komunikimin efektiv në kontekste të ndryshme, përfshirë arsimin, punën dhe jetën e përditshme.
Mendim krijues	<i>Creative thinking</i>	Kapacitet mendor për të gjeneruar zgjidhje të veçanta dhe origjinale të problemeve në fusha dhe projekte të ndryshme jetësore.
Metoda e vlerësimit	<i>Evaluation method</i>	Tërësi teknikash me të cilat gjykohet bazuar në kritere efektiviteti i çdo programi mësimor dhe orientohen veprimet për përmirësim.
Mësim i diferencuar	<i>Differentiated teaching</i>	Qasje pedagogjike që synon nevojat e ndryshme mësimore të nxënësve dhe kërkon nga mësuesit të përshtatin në mënyrë fleksibël mjedisin dhe kushtet e të nxënës, për të siguruar mundësi të barabarta për çdo nxënësi.
Mësimi i përzier	<i>Blended learning</i>	Një kombinim i mësimin tradicional (ballë për ballë) me mësimin digjital për t'i lejuar nxënësit të kenë kontroll më të madh ose të personalizuar në rrugën e tyre dhe ritmin individual të nxënies, duke përfutur dhe nga mbikëqyrja e mësuesit.
Mjedis të nxënës	<i>Learning environment</i>	Mjedis fizik i nxënies (klasa, shkolla), burimet e vëna në dispozicion për të ndihmuar procesin mësimor dhe llojet e marrëdhënieve shoqërore që funksionojnë brenda këtij konteksti dhe që kanë ndikim në të nxënës.
Mjedis miqësor për fëmijët	<i>Child friendly environment</i>	Mjedis arsimor dhe komunitet mbështetës që është gjithëpërfshirës, i shëndetshëm, miqësor, mbrojtës dhe i bazuar në të drejtat. Modeli i shkollës miqësore promovon gjithëpërfshirjen, ndjeshmërinë gjinore, tolerancën, dinjitetin dhe fuqizimin personal.
Njohuri	<i>Knowledge</i>	Konceptet, idetë dhe teoritë për botën natyrore dhe shoqërinë si dhe strukturat dhe modelet e tyre të ndërlidhura që personi i ka krijuar nëpërmjet të mësuarit dhe/ose përvojës. Njohuria është personale.
Nxënie/ Të nxënës	<i>Learning</i>	Proces psiko-social kompleks dhe afatgjatë me të cilin një person fiton ose modifikon njohuritë, aftësitë, qëndrimet, vlerat përmes përvojës, praktikës, studimit ose udhëzimit.
Nxënësi në qendër	<i>Student centered learning</i>	Qasja mësimore e bazuar në konstruktivizmin që thekson rolin e nxënësit në ndërtimin e kuptimit përmes harmonizimit të informacionit të ri dhe njohurive paraprake, duke zhvilluar autonominë, pavarësinë dhe përgjegjësinë e nxënësit në procesin e të nxënës.
Objektivi i të nxënës	<i>Learning objective</i>	Deklaratë/frazë që përshkruan njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet që duhet të përvetësojnë e të demonstrojnë nxënësit. Ai orienton hartuesit e programeve mësimore të identifikojnë dhe të përshkruajnë situatat që duhet të trajtojnë nxënësit dhe burimet që aktivizojnë ata. Si të tillë, RN-të përcaktohen për t'u arritur nga të gjithë nxënësit.
Orientimi për karrierën	<i>Career guidance</i>	Shërbime dhe veprimtari që synojnë të ndihmojnë personat në çdo moment gjatë jetës së tyre të marrin vendime të mirinformuara për të bërë zgjedhje arsimore, trajnimi dhe profesionale, si dhe të menaxhojnë karrierën e tyre. Ai përfshin ofrimin e ndihmës, të informacioneve dhe të burimeve për t'i ndihmuar personat të kuptojnë interesat,

KURRIKULA BËRTHAMË E ARSIMIT FILLOR (E PËRDITËSUAR)

		pikat e forta, dobësitë dhe vlerat e tyre, dhe më pas t'i bashkojnë ato me alternativa të ndryshme karriere në sektorin privat.
Përmbajtje mësimore	<i>Subject content</i>	Dijet e një fushe të caktuar shkencore që përzgjidhen, shndërrohen dhe organizohen me mjete pedagogjike për të plotësuar qëllime mësimore nëpërmjet lëndëve shkollore.
Platformë ndërvepruese	<i>Interactive platform</i>	Platformë digjitale që mundëson ndërveprime të personalizuar dhe të synuara, e aksesueshme online për informacion, produkte dhe oferta specifike.
Program mësimor	<i>Program of study</i>	Dokument që përshkruan qëllimet e të nxënës, renditjen e përmbajtjeve, qëllimin, organizimin, materialet, detyrat, projektet dhe skemat e vlerësimit për një njësi studimi ose lëndë.
Proces mësimor	<i>Teaching process</i>	Proces i planifikuar dhe i strukturuar nga mësuesi për të arritur nga nxënësi rezultatet e të nxënës përmes situatave të përmbajtjeve dhe vlerësimit.
Plani mësimor	<i>Course schedule</i>	Dokument që përcakton lëndët, nivelin e klasës dhe numrin e orëve mësimore për secilën lëndë, sipas vendimit të Ministrisë.
Qasja STEM	<i>The STEM approach</i>	STEM (Shkencë, Teknologji, Inxhinieri dhe Matematikë) është qasje arsimore që synon të integrojë katër fusha studimi për të zhvilluar njohuri dhe kompetenca të rëndësishme të nxënësit. Korniza thekson rëndësinë e mësimin aktiv dhe zbatimin e njohurive në situata reale.
Qëndrim	<i>Attitude</i>	Prirje për të menduar dhe për të reaguar ndaj ideve, personave ose situatave bazuar në vlera, bindje ose besime të zhvilluara me kalimin e kohës.
Rezultat i nxënies	<i>Learning outcome</i>	Rezultati i të nxënës (në vijim, RN) është një deklaratë që përshkruan atë që një nxënësi pritët të dijë, të kuptojë dhe të jetë në gjendje të bëjë, pas një periudhe mësimore të caktuar.
Situatë e të nxënës	<i>Learning situation</i>	Elemente specifike kontekstuale që nxënësit përballojnë gjatë të nxënës, që përmban një kontekst real, pyetje, qëllimi dhe kriteret vlerësimi, duke përfshirë mësuesin, përmbajtjen, mjetet dhe një mjedis të përshtatshëm për të nxënë.
SMIP	-	Platformë teknologjike që përdoret, sipas roleve të përcaktuara për subjektet dhe për përdoruesit e saj, për të mbledhur, menaxhuar dhe analizuar të dhënat arsimore, me qëllimin që të ndihmojë në përmirësimin e arritjeve të nxënësve dhe në zvogëlimin e rrezikut dhe të sfidave me të cilat mund të përballeni.
Strategji mësimore	<i>Teaching strategy</i>	Qasje e planifikuar për zgjedhjen dhe zbatimin e metodave, teknikave dhe përvojave mësimore për të lehtësuar të nxënës dhe për të përmbushur qëllimin e të nxënës.
Tekst mësimor digjital	<i>Digital educational text</i>	Përmbajtje edukative e krijuar në mënyrë digjitale për kompjuterë, tableta, lexues elektronikë ose telefona inteligjentë, si: tekste shkollore, materiale mësimore, udhëzues studimi ose burime të tjera.

KURRIKULA BËRTHAMË E ARSIMIT FILLOR (E PËRDITËSUAR)

Tema ndërkurrikulare	<i>Cross curricular themes</i>	Përmbajtje e rëndësishme kurrikulare që trajtohet në disa lëndë për shkak të rëndësisë së saj, si të drejtat e njeriut ose edukimi për mjedisin.
Teori konstruktiviste	<i>Constructivism</i>	Teori e të nxënësve që e sheh të nxënësin si një proces aktiv, ku nxënësi ndërton ide të reja bazuar në njohuritë dhe përvojat e mëparshme.
Teori biheviore	<i>Behaviorism</i>	Teori psikologjike që sugjeron se sjelljet fitohen përmes kushtëzimit nga ndërveprimet me mjedisin.
Të menduar kompjuterik	<i>Computational thinking</i>	Grupi i aftësive kompjuterike për zgjidhjen e problemeve komplekse, thelbësor për pjesëmarrje në një botë digjitale.
Të nxënësve gjatë gjithë jetës	<i>Lifelong learning</i>	Tërësia e veprimtarive mësimore gjatë jetës që përmirëson njohuritë, aftësitë dhe kualifikimet për arsye personale, sociale ose profesionale.
Teknologjia e informacionit dhe e komunikimit (TIK)	<i>Information and Communication Technology (ICT)</i>	Grup mjetesh dhe burimesh teknologjike për të transmetuar, ruajtur, krijuar, ndarë ose shkëmbyer informacion nëpërmjet kompjuterëve, internetit, teknologjive të transmetimit të drejtpërdrejtë (radio, televizion dhe transmetim në internet), teknologjive të transmetimit të regjistruar (<i>podcasting</i> , audio dhe video, dhe pajisje ruajtëse), telefonisë (fikse ose celulare), satelitit, konferencave me vizion/video etj.
Nxënie elektronike	<i>E-learning</i>	Të gjitha format e të nxënësve në mënyrë elektronike, veçanërisht përvetësimi dhe zbatimi i njohurive dhe i aftësive të bazuara në <i>web</i> dhe kompjuter. Mund të zhvillohet brenda ose jashtë klasës. Shpesh është një komponent thelbësor i arsimimit në distancë dhe mund të përfshijë mjedise virtuale të nxënësve.
Vlerësim	<i>Evaluation</i>	Procesi gjatë të cilit mblidhen të dhëna dhe gjykohet në bazë të një kriteri të caktuar për suksesin e një programi arsimor ose arritjen e një rezultati arsimor.
Vetëvlerësimi	<i>Self-evaluation</i>	Vlerësim ku nxënësi mbledh informacion dhe reflekton mbi të nxënësin e tij, gjykon shkallën në të cilën ai pasqyron qëllimet ose kriteret e shprehura në mënyrë të qartë, identifikon pikat e forta dhe të dobëta dhe rishikon sipas nevojës.
Vlerësim diagnostikues	<i>Diagnostic evaluation</i>	Proces që synon identifikimin e pikave të forta dhe të dobëta të nxënësit, për të ndërmarrë veprimet e nevojshme për të përditësuar të nxënësin. Përdoret për të diagnostikuar vështirësitë e një nxënësi dhe gatishmërinë ose nivelin e arritjeve të nxënësve, që të ndihmojë në planifikimin e programit dhe diferencimin ose mbështetjen e nevojshme.
Vlerësim (matje) i rezultatit të nxënësve	<i>Educational assessment</i>	Proces sistematik i mbledhjes dhe i analizës së informacionit për të vlerësuar progresin e nxënësve në arritjen e qëllimeve të mësimin.
Vlerësimi përmbljedhës	<i>Summative assessment</i>	Vlerësimi i rezultatit të nxënësve të nxënësit në fund të një periudhe, stadi, kursi ose programi që zakonisht përfshin testime ose provime formale. Shërben për renditjen, vlerësimin dhe/ose promovimin e nxënësve për qëllime certifikimi.

KURRIKULA BËRTHAMË E ARSIMIT FILLOR (E PËRDITËSUAR)

Vlerësim formues	<i>Formative assessment</i>	Vlerësimi gjatë procesit mësimor për të përditësuar të nxënësit e nxënësve. Përfshin: mbledhjen e provave për të mësuarit, mbylljen e hendekut midis performancës aktuale dhe asaj të dëshiruar, ofrimin e komenteve për nxënësit dhe përfshirjen e tyre në procesin e vlerësimit dhe të nxënies.
Vlerësim i jashtëm	<i>External evaluation</i>	Proces dhe metodë vlerësimi i kryer nga një agjenci apo organ vlerësues për të gjykuar cilësinë e arritur në shkollë.
Vlerësim i shokut nga shoku	<i>Peer-to-peer evaluation</i>	Vlerësimi i rezultatit të nxënies të një nxënësi nga një bashkëmoshatar i tij.

REFERENCA

ASCAP (2023). *Programi orientues “Vlerësimi i arritjeve të nxënësve të arsimit fillor”* (VANAF)

<https://www.ascap.edu.al/wp-content/uploads/2023/10/VANAF-Programi-orientues-2023-2024-1.pdf>

AGUERRONDO, I. (2009). *Complex knowledge and education competence*, UNESCO IBE, Geneva,

Switzerland.https://unesdoc.unesco.org/ark:/48223/pf0000182526_eng

BRASKAVSKY, C. & BENAVIDES, A. (2006). *School Knowledge in Comparative and Historical Perspective. Changing Curricula in Primary and Secondary Education*. Comparative Education Research Centre, The University of Hong Kong & Springer.
<file:///C:/Users/admin/Downloads/BenavotandBraslavsky.pdf>

- COUNCIL OF EUROPE (2020). *Kuadri i Përbashkët Evropian i Referencave për Gjuhët*.<https://rm.coe.int/common-european-framework-of-reference-for-languages-learning-teaching/16809ea0d4>
- DEPARTAMENTI I EDUKIMIT (2010). *Karta e Këshillit të Evropës për Edukimin për Qytetari Demokratike dhe për të Drejtat e Njeriut*.<https://rm.coe.int/1680487826>
- EUROPEAN COMMISSION (2018a). *Proposal for a council recommendation on key competences for lifelong learning*. Brussels.
<https://ec.europa.eu/education/sites/education/files/recommendation-key-competences-lifelonglearning.pdf>
- ESTONIAN MINISTRY OF EDUCATION AND RESEARCH (2024). *Estonian National Curriculum (2011, revised in 2020)*.
<https://www.riigiteataja.ee/en/eli/529042024002/consolide>
- EDUCATION SCOTLAND (2024). *Scotland's Curriculum Framework - Curriculum Improvement Cycle*
<https://blogs.glowscotland.org.uk/glowblogs/cices/>
- EURYDICE. COMPARATIVE REPORTS (2018). *Developing Key Competences at School in Europe: Challenges and Opportunities for Policy*.
<https://eurydice.eacea.ec.europa.eu/publications/developing-key-competences-school-europe-challenges-and-opportunities-policy>
- FINNISH NATIONAL AGENCY FOR EDUCATION (2024). *The national core curriculum for primary and lower secondary*
<https://www.oph.fi/en/education-and-qualifications/national-core-curriculum-primary-and-lower-secondary-basic-education>
- GOUVERNEMENT DU QUÉBEC (2024) *Québec Education Program - Elementary Education*
<https://www.quebec.ca/en/education/preschool-elementary-and-secondary-schools/quebec-education-program/elementary#c235016>
- GOUVERNEMENT DU QUÉBEC (2024) *Québec Education Program - Elementary Education- Art Education*.
<https://cdn-contenu.quebec.ca/cdn-contenu/education/pfeq/primaire/programmes/PFEQ-art-dramatique-primaire-AN.pdf>
- KEY COMPETENCES FOR LIFELONG LEARNING IN THE EUROPEAN SCHOOLS (2018)

- <https://www.eursc.eu/BasicTexts/2018-09-D-69-en-2.pdf>
- MAS (2024). *Korniza Kurrikulare e Arsimit Parauniversitar në Shqipëri*
<https://ascap.edu.al/wp-content/uploads/2017/03/Korniza-Kurrikulare.pdf>
- MAS (2014). *Kurrikula bërthamë për klasën përgatitore dhe arsimin fillor*
<https://www.ascap.edu.al/wp-content/uploads/2020/02/Kurrikula-Berthame-per-Klasen-Pergatitore-dhe-Arsimi-Fillor.pdf>
- MASHT (2017). *Kurrikula bërthamë për klasën përgatitore dhe arsimin fillor të Kosovës (Klasat 0, I, II, III, IV dhe V)*
<file:///C:/Users/admin/Downloads/kurrikula-berthame-1-finale-2-1.pdf>
- MINISTÈRE DE L'ÉDUCATION NATIONALE (2023). *Le socle commun de connaissances, de compétences et de culture*.
<https://eduscol.education.fr/139/le-socle-commun-de-connaissances-de-competences-et-de-culture>
- OECD (2024). *Programme for International Student Assessment (PISA) Publications Reports*.
<https://www.oecd.org/en/about/programmes/pisa.html>
- OECD (2016). *Global competency for an inclusive world*.
<http://www.oecd.org/pisa/pisa-2018-global-competence.htm>
- RIIGI TEATAJA, ESTONIA (2011). *National Core Curriculum for basic education*,
<https://www.riigiteataja.ee/en/eli/524092014014/consolide>
- SUBASHI, G. & DACI, J. (2004). *“Didaktika e edukimit fizik”, Shtëpia Botuese e Librit Universitar, Tiranë*.
<https://www.scribd.com/document/534203699/Didaktika-e-Edukimit-Fizik-Per-Word>
- UNIVERSITY OF LONDON (2009). *Core Competence Requirements in Early Childhood Education and Care: A study of European Commission Directorate-General for Education and Culture. London and Ghent*.
[file:///C:/Users/admin/Downloads/core%20competence%20requirements%20in%20early%20childhood%20education-gp_eudor WEB NC3213399ENC_002.pdf](file:///C:/Users/admin/Downloads/core%20competence%20requirements%20in%20early%20childhood%20education-gp_eudor_WEB_NC3213399ENC_002.pdf)

KONTRIBUUES NË PËRGATITJEN E DOKUMENTIT

- ❖ Kabineti i Ministrit të Arsimit dhe Sportit
- ❖ Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar
- ❖ Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar

GRUPI I EKSPERTËVE

- ❖ Prof. Asc. Dr. Pëllumb Karameta
- ❖ Dr. Aurela Zisi

FALËNDERIM PËR KONTRIBUTIN DHE MBËSHTETJEN GJATË KËTIJ PROCESI

- | | | |
|--------------------------------|----------------------|---------------------|
| ❖ Prof. Asc. Dr. Gerta Sula | ❖ Pashkë Zefi | ❖ Anita Koçi |
| ❖ Prof. Asc. Dr. Ardian Tana | ❖ Anila Bitraku | ❖ Marjana Zefi |
| ❖ Prof. Asc. Dr. Lindita Lutaj | ❖ Albina Gjini | ❖ Semela Bardhica |
| ❖ MSc. Teuta Karaj | ❖ Elira Smakaj | ❖ Marie Jakini |
| ❖ MSc. Shpresa Gorana | ❖ Arjana Mërtiri | ❖ Angeje Cali |
| ❖ MSc. Anila Ziu | ❖ Gjergji Vangjeli | ❖ Vjollca Fierza |
| ❖ MSc. Mirjeta Domi | ❖ Gentiana Dollia | ❖ Griselda Myzyri |
| ❖ MSc. Monika Suçi | ❖ Viktor Gjini | ❖ Elida Thaçi |
| ❖ MSc. Ana Kadriu | ❖ Teuta Cengu | ❖ Violeta Kuqi |
| ❖ MSc. Eglantina Çaçi | ❖ Bukurie Gjuta | ❖ Entela Jovani |
| ❖ MSc. Miranda Mete | ❖ Suela Rama | ❖ Shkëndi Bardhoshi |
| ❖ MSc. Drita Kolndreu | ❖ Lumturi Kopani | ❖ Drita Kolndreu |
| ❖ MSc. Alketa Bulku | ❖ Marie Gjini | ❖ Alketa Bulku |
| ❖ MSc. Alketa Karameta | ❖ Blerta Prenga | ❖ Amarilda Bitri |
| ❖ MSc. Irena Beqiraj | ❖ Misidije Rexhmataj | ❖ Sonil Zeka |
| ❖ MSc. Alva Nezha | ❖ Diana Suli | ❖ Monika Azisllari |
| ❖ MSc. Ilira Morina | ❖ Etleva Jonuzi | ❖ Arjana Laska |
| ❖ Albert Lamçe | ❖ Sandra Lemollari | ❖ Skënder Nuzi |
| ❖ Eglantina Dedja | ❖ Artin Gjermeni | |
| ❖ Liljana Cani | ❖ Alma Shehu | |